



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM

në Shqipëri 2021

Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rezizëve

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM në Shqipëri 2021

Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve

Tiranë, mars 2021

Ky studim u përgatit në kuadër të projektit “Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri – format dhe rreziqet e vazhdueshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe rruga drejt forcimit të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm”, me mbështetjen financiare të Zyrës së Çështjeve Publike të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Autorë:

Leonie Vrugtman, autori kryesor

Sara Kelmendi

Romario Shehu

Diori Angjeli

Dizajni dhe faqosja

Eduart Cani

Përmbajtja

1. Përmbledhje	9
2. Hyrje	11
3. Metodologjia	14
4. Profili i të anketuarve të sondazhit	18
5. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri	25
5.1. Nxitësit social-ekonomikë	25
5.2. Nxitësit politikë	45
5.3. Nxitësit kulturorë	71
6. Riintegrimi dhe parandalimi	84
7. Përfundime dhe rekomandime	99
8. Shtojcat	106
8.1. Shpërndarja e kampionit të sondazhit	106
8.2. Pyetësi i sondazhit	107

Lista e figurave

Figura 1: Përbërja gjinore e të anketuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	19
Figura 2: Moshë e të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	19
Figura 3: Figura 3. Niveli arsimor i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)	20
Figura 4: Statusi i punësimit i të intervistuarve të sondazhit (N=1600)	20
Figura 5: Përkatësia fetare e të anketuarve (N=1600) dhe e familjes së tyre (N=1595). Nuk janë përfshirë përgjigjet 'Nuk e di' dhe 'Refuzoj të përgjigjem'.	21
Figura 6: Praktikimi i riteve fetare tek të anketuarit (N=1600)	22
Figura 7: Praktikimi i lutjes/faljes tek të anketuarit (N=1448)	23
Figura 8: Mbështetja e të anketuarve për martesën ndërfitare të një anëtari të familjes (N=1584)	24
Figura 10: Mbështetja për mendimin se të rinjtë kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogës dhe sjelljeve të rrezikshme (N=1598)	28
Figura 11: Ka individë apo grupe që nxisin ekstremizmin politik (N=1598) / nacionalist (N=1593) / fetar (N=1598)	29
Figura 12: Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social (N=1599)	31
Figura 13: Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë (N=1597)	32
Figura 14: Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore (N=1595)	33
Figura 15: Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune (N=1600)	35
Figura 16: Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme (N=1599)	35
Figura 17: Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime (N=1598)	37
Figura 18: Në zonën ku banoj ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës (N=1597)	38
Figura 19: Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre (N=1591)	39
Figura 20: Disa punë/përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja (N=1597)	41
Figura 21: Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik (N=1596) dhe Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë (N=1589)	42
Figura 22: Të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore (N=1599)	48

Figura 23: Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja (N=1600)	49
Figura 24: Institucionet ligjzbatuese janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë (N=1599)	50
Figura 25: Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore (N=1596)	51
Figura 26: 'Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura' (N=1599) & 'Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët' (N=1598)	53
Figura 27: Detyra për të mbrojtur ideologjinë (N=1597) përkundër Detyrës për të mbrojtur fenë (N=1598)	54
Figura 28: 'besim i fortë, më pak korrupsion (N=1599) & 'Më shumë drejtësi nëse njerëzit besojnë fenë time' (N=1598)	57
Figura 29: Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti (N=1595)	59
Figura 30: 'Shteti si zbatues i ligjit apo si ofrues shërbimi' (N=1593) & 'Prania e shtetit më pak në zonat rurale' (N=1596)	60
Figura 31: Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare (N=1587)	62
Figura 32: Individë radikalë që promovojnë ekstremizmin politik/fetar/nacionalist. (N1=1595; N2=1595; N3=1591)	63
Figura 33: 'Strukturat globale u shpikën për të sunduar vendet myslimane' (N=1600) & 'Vendet e krishtera kanë më shumë mbështetje nga Perëndimi' (N=1594)	66
Figura 34: 'BE e padrejtë me vendet me shumicë myslimane' (N=1599) vs. 'ShBA të padrejtë me vendet me shumicë myslimane' (N=1600)	67
Figura 35: Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame (N=1600)	73
Figura 36: Sot është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame (N=1600) vs. besimtar i krishterë (N=1598) në Shqipëri	73
Figura 37: Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator (N=1594)	75
Figura 38: Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm (N=1595)	76
Figura 39: Sa të shqetësuar jeni me ekstremizmin politik/nacionalist/fetar në Shqipëri? (N1=1600; N2=1594; N=1593)	77
Figura 40: Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit. (N=1596)	79
Figura 41: Ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime të fesë... (N1=1597; N2=1593; N3=1591; N4=1597; N5=1587)	81
Figura 42: A mund të shkëputen besimtarët radikalë fetar? (N=1594) përkundër A mund të shkëputen të terroristët e dënuar ? (N=1596)	85



Figura 43: Organet shtetërore riintegrojnë të gjithë të rikthyerit (N=1,596) përkundër vetëm shtetasit shqiptarë që nuk kanë kryer krime (N=1596)	87
Figura 44: Pranimi i familjeve të rikthyera nga Siria në komunitetin e të anketuarve (N=1589)	88
Figura 45: Roli i aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë në rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria	89
Figura 46: Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj (N=1586)	91
Figura 47: Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të madh tek besimtarët (N=1579)	92
Figura 48: Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar (N=1591)	93
Figura 49: Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare (N=1595)	93
Figura 50: Shqetësimi dhe prania e perceptuar e ekstremizmit të dhunshëm politik, fetar dhe nacionalist	102



Lista e tabelave

Tabela 1. Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018	15
Tabela 2: Nxitësit social-ekonomikë të ekstremizmit të dhunshëm sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018	26
Tabela 4: Nxitësit kulturorë, sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018	71
Tabela 5: Mendimi i të anketuarve për faktorët kryesorë që mundësojnë ose nxisin radikalizimin fetar	95
Tabela 6: Aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri	96
Tabela 7: Faktorët e qëndresës ndaj ekstremizmit të dhunshëm	97



Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja dhe Hercegovina
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ
BM	Britania e Madhe
BP	Ballkani Perëndimor
DFK	Diskutime në fokus grupe
EDH	Ekstremizmi i dhunshëm
FHE	Forumi i hulumtimeve për ekstremizmin
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Komisioni Evropian
KEDH	Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm
KMSH	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
LH	Luftëtarët e huaj
LMAV	Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizata jo-qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
P/LKEDH	Parandalimi/Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QKEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
SPAK	Struktura e Posaçme e Anti-Korrupsionit
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar



1. Përmbledhje

Kanë kaluar më shumë se gjashtë vjet që nga largimi i të paktën 144 shtetasve shqiptarë për në Irak dhe Siri. Ndonëse është shmangur rreziku i madh për shkak të forcimit të kuadrit ligjor si dhe në sajë të ngritjes së kapaciteteve për parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (EDH) dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit përkatës të Veprimit, EDH mbetet ende i pranishëm në Shqipëri. Pas një vlerësimi të parë bazë të realizuar në vitin 2015 dhe të një vlerësimi të mëvonshëm kombëtar për nxitësit, format dhe rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri të kryer në 2018, ky studim bën një vlerësim të situatës pas gjashtë vitesh pune në drejtim të parandalimit/luftës kundër EDH, dhe përhapjen e nxitësve dhe faktorë të tjerë të lidhur me të që e ushqejnë ose e mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm. Vërehen përmirësime të mëdha në disa prej nxitësve të matur të EDH, si respektimi i të drejtave dhe lirive të qytetarëve, funksionimi i institucioneve larg abuzimeve, mundësitë e mira të punësimit për shqiptarët e mirë arsimuar, rënia e numrit të njerëzve që angazhohen në veprimtari të paligjshme ekonomike si dhe rënia e mbështetjes që mundëson nxitjen apo përfshirjen në konflikte të armatosura jashtë vendit. Gjatë viteve të fundit publiku është ndërgjegjësuar më shumë për fenomenin e EDH, për rreziqet dhe kërcënimet e tij në përgjithësi. U rrit ndjeshëm edhe gatishmëria e popullatës shqiptare për të rimarrë në gjirin e saj qytetarët shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konfliktit, si Siria, qoftë kjo edhe në komunitetin e tyre.

Megjithatë, mungesa e mundësive socio-ekonomike, gjendja e demokracisë dhe funksionimi i shtetit të së drejtës si dhe perceptimet për përjashtimin e perceptuar mund të bëjnë që disa individë të jenë të cenueshëm nga ekstremizmi i dhunshëm. Të cenueshëm nga grupet e EDH mund të jenë, në mënyrë të veçantë, të rinjtë, të papunët apo të përjashtuarit. Shqiptarët me nivel të ulët arsimor kanë më shumë gjasa të përfshihen në veprimtari të paligjshme ekonomike për të siguruar bukën e gojës ose të mbështesin përdorimin e mjeteve të dhunshme për të arritur ndryshime politike dhe për të mbrojtur vlerat, të drejtat dhe liritë e tyre. Besimtarët praktikantë në veçanti- shohin tashmë tek feja një mundësi për trajtimin e korrupsionit dhe pandëshkueshmërisë, duke qenë se besojnë se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuar dhe se në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi nëse më shumë njerëz do të bashkoheshin me fenë e tyre.

Perceptimet për diskriminimin shoqëror ndaj një individi apo komuniteti (ose të dyjave) mund të jetë në një kuptim të gjerë nxitës i ekstremizmit të dhunshëm. Ndonëse në Shqipëri toleranca fetare është mjaft e përhapur, 1 në 4 myslimanë shqiptarë mendon se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpër me myslimanët praktikantë. Krahasuar me studimin e vitit 2018, njerëzit priren të bien më shumë dakord me pohimin se BE është e padrejtë me vendet me shumicë myslimane në Ballkan ose se sistemi ndërkombëtar është përgjithësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë dhe popujt myslimanë në krahasim me vitin 2018. Po ashtu, pothuajse 1 në 4 shqiptarë është dakord se Islami në Shqipëri përballet me ndikime të huaja.

Ndonëse në vitet e fundit ekstremizmi i dhunshëm fetar përbënte një shqetësim serioz për Shqipërinë, studimi i vitit 2018, "Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri" (IDM, 2018), evidentoi një potencial në rritje të formave të tjera të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Në fakt, ky studim konfirmon se shqiptarët janë më shumë të shqetësuar për ekstremizmin politik sesa për ekstremizmin fetar apo nacionalist. Shqiptarët priren të deklarojnë se në komunitetin e tyre veprojnë më shumë grupet apo individët ekstremistë politikë (27.3%) sesa grupet apo individët ekstremistë fetarë (12.1%) apo nacionalistë (7.6%).



Duke marrë parasysh riatdhësimin dhe riintegrimin e pritshëm të shtetasve shqiptarë nga Siria, është me rëndësi të vazhdohet me përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke zvogëluar hapësirën e mundshme ku veprojnë grupe të tilla. Mbështetja e popullatës së gjerë dhe e komuniteteve pritëse në veçanti është e rëndësishme për risocializimin e qëndrueshëm të të rikthyerve. Kur bëhet fjalë për një individ që refuzon një ideologji ekstremiste fetare, shqiptarët nuk perceptojnë institucionet, por komunitetin, rrethin shoqëror dhe edukimin e duhur fetar si faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë ekstremiste fetare. Për ta shndërruar strategjinë aktuale P/LKEDH në një kuadër të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial për qëndresën e komunitetit kundër të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, duhet të ndërmerren në mënyrë të ngutshme hapa për realizimin e fushave prioritare të mëposhtme:

Nevojitet një strategji e përshtatur për trajtimin e çështjeve që janë specifike për komunitetet e cënueshme në vend të një strategjie që bazohet në ideologji dhe që fokusohet vetëm te feja. Strategjia gjithëpërfshirëse P/LKEDH duhet të trajtojë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm dhe duhet të orientohet nga parimet e qëndresës së komunitetit dhe dialogut gjithëpërfshirës.

Përmirësimi i hapësirës qytetare në Shqipëri është me rëndësi për të nxitur qytetarët që të marrin pjesë në vendimmarrje. Nismat e edukimit qytetar, ndërthurur me amendimet përkatëse ligjore, kanë më shumë gjasa të prodhojnë rezultate pozitive që çojnë në rritjen e llogaridhënies, ndërkohë që u mundësojnë komuniteteve të marginalizuara të angazhohen në një hapësirë më të sigurt, ku ata mund t'i adresojnë pritshmëritë e dështuara dhe pakënaqësinë me situatën aktuale.

Për të përmirësuar legjitimitetin e institucioneve qendrore dhe vendore, për forcimin e shtetit ligjor dhe për rritjen e përpjekjeve që synojnë të pengojnë ekonominë informale dhe kriminale dhe korrupsionin galopant, kërkohet një qasje mbarëqeveritare. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes vendore, në veçanti, është nevojë urgjente për të përmirësuar vazhdimisht performancën e tyre në ofrimin e shërbimeve.

Edhe pse toleranca fetare është vlerë themelore në shoqërinë shqiptare, aktorët P/LKEDH, institucionet arsimore dhe shoqëria civile duhet të rrisin përpjekjet për trajtimin e shkaqeve themelore dhe efekteve të stereotipeve, paragjykimeve dhe diskriminimit shoqëror me bazë ideologjike. Nevojitet të hartohet një program komunikimi strategjik për të kultivuar respektin ndaj të drejtave të njeriut që i bën të mundur shoqërisë të ofrojë rrjete mbështetëse shoqërore.

Fuqizimi i komuniteteve fetare duke i angazhuar ato në strategjitë e parandalimit dhe riintegrimin të zbatuara nga Qendra KEDH dhe ministritë e linjës është me rëndësi të madhe për lehtësimin e riintegrimin të të rikthyerve, duke i përgatitur dhe duke i nxitur klerikët vendorë të marrin përsipër një rol më aktiv si riedukatorë fetarë. Rritja e besueshmërisë që gëzojnë komunitetet fetare, idetë dhe vlerat e tyre kanë nevojë për një vlerësim të sfidave institucionale me të cilat përballen autoritetet fetare, të cilat i pengojnë këto autoritete të luajnë një rol më të madh në përpjekjet parandaluese.



2. Hyrje

Kanë kaluar gjashtë vjet që nga koha kur u krye vlerësimi i parë i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”¹ dhe tre vjet më vonë Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim bëri vlerësimin kombëtar të nxitësve, formave dhe rreziqeve të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri². Në vlerësimin bazë të vitit 2015 u analizuan radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në vend për të informuar politikëbërësit dhe aktorët e tjerë kryesorë për mënyrën e trajtimit të këtij fenomeni. Ky studim, që u bë bazë për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit përkatës të Veprimit, ndihmoi të kuptoheshin më mirë faktorët kryesorë që mund të çojnë në radikalizim dhe niveli i mbështetjes për ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Vlerësimi i vitit 2018, edhe pse fokusohet gjithashtu në ekstremizmin e dhunshëm fetar, i siguroi komunitetit të Parandalimit/Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (P/LKEDH) dhe institucioneve shtetërore një studim më të gjerë, të realizuar në 50 bashki ku u shqyrtuan perceptimet, qëndrimet, dhe përvoja bazë e shqiptarëve në lidhje me nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm.

Që nga ajo kohë, janë angazhuar shumë aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë në luftën dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri nëpërmjet zbatimit të ndryshimeve ligjore, mekanizmave të referimit, nismave të ngritjes së kapaciteteve, fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit, dhe projekteve vendore që synojnë më shumë qëndresë të komunitetit. Që nga viti 2017, këto përpjekje bashkërendohen nga Qendra Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, kryesuar nga Koordinatori KEDH. Ndërkohë që në periudhën 2012-2015 janë larguar nga Shqipëria për të luftuar në Siri dhe Irak 144 shqiptarë³, numri i luftëtarëve të rinj të huaj që u larguan nga vendi ra në zero pas vitit 2015, jo vetëm sepse ndryshimet në Kodin Penal në vitin 2014 e kriminalizuan “Pjesëmarrjen në formacione luftarake, organizata ushtarake ose paraushtarake në një konflikt të armatosur që zhvillohet në territorin e një shteti të huaj”⁴, por edhe në sajë të rritjes së vëmendjes së qeverisë ndaj P/LKEDH. Në vitin 2016, Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi një rrjet rekrutimi me nëntë vetë me një dënim total prej 16 vjet heqje lirie, ku masa e dënimeve varionte nga 7 në 18 vjet heqje lirie.⁵ Në vitet 2018 dhe 2019, u ndërmorën 28 hetime me akuzën e përfshirjes në veprimtari



- 1 Vurmo, G. (2015). Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/RadikalizmiFetar-webOK2.pdf>
- 2 Vurmo, G., & Sulstarova, E. (2018). Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Marrë nga <https://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>
- 3 Komisioni Evropian. (2018). Raporti i Progresit i Shqipërisë për vitin 2018. p. 36. Marrë nga: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>
- 4 Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 132, Datë 19/08/2014
- 5 Erebara, G. (2016). Albania Jails Nine Jihadi Recruiters. Balkan Insight. Gjendet në adresën: <https://balkaninsight.com/2016/05/04/heavy-sentences-spelled-for-albania-jihadi-recruiters-05-04-2016/>



terroriste, por asnjë prej tyre nuk rezultoi në dënime.⁶

Donatorët ndërkombëtarë kanë luajtur një rol tejet të rëndësishëm në zbatimin e masave parandaluese të përcaktuara në planin e veprimit KEDH. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe shtetet e saj anëtare, Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), disa agjenci të Kombeve të Bashkuara dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë kanë financuar qindra projekte ku angazhohen institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet fetare - veçanërisht Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH). Nismat e tyre kanë ndihmuar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në luftën kundër propagandës ekstremiste, në zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë, në rritjen e ndërgjegjësimit, punën me të rinjtë dhe gratë, zhvillimin e modeleve të bashkëpunimit në nivelin vendor - të tilla si “shkolla si qendër komunitare” -, promovimin e tolerancës fetare e kështu me radhë.

Gjatë procesit të zbatimit të strategjisë, u ndoq qasja e trajtimit të fenomenit jashtë kontekstit të sigurisë, ku sipas kësaj qasjeje theksi i vihet më shumë rolit të institucioneve që janë jashtë kuadrit të sigurisë (arsimi, bashkitë, agjencitë e punësimit, etj.) në nivel kombëtar e vendor. Gjithsesi, hasen ende sfida dhe shqetësime që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe që kërkojnë vazhdimin e përpjekjeve jo vetëm duke angazhuar aktorët kryesorë në nivel qendror, që ndodhen në Tiranë, por edhe në nivel vendor.⁷

Teksa Shqipëria po përgatitet për rehabilitimin dhe riintegrimin e 76 shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria⁸ dhe për P/LKEDH, dhe ndërkohë që aktorët vazhdojnë me zbatimin e programeve dhe aksioneve të ndryshme për të mbajtur nën kontroll ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çon në terrorizëm, lind nevoja për të vlerësuar situatën aktuale. Cilët janë nxitësit kryesorë që çojnë në radikalizim në Shqipëri? Cilat janë format kryesore të ekstremizmit të dhunshëm? Cilat janë rreziqet kryesore ndaj sigurisë në vend dhe riintegrimi i duhur i të kthyerve? Ndërkohë që studimet e viteve 2015 dhe 2018 për ekstremizmin e dhunshëm u përqendruan në ekstremizmin e dhunshëm fetar, studimi që keni në dorë shqyrton lloje të ndryshme të ekstremizmit politik, nacionalist dhe fetar. Në nivel botëror, ka një rritje të grupeve populiste dhe nacionaliste që bëjnë propagandë për ekstremizmin e djathtë dhe anti-mysliman. Edhe pse Shqipëria është më pak e prekur në krahasim me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nga ekstremizmi i ekstremit të djathtë⁹, ka mundësi që në Shqipëri të veprojnë grupe ekstremiste më radikale, të cilat mund të bëhen të dhunshme në të ardhmen.

Ky studim ka si qëllim të informojë vendimmarrësit dhe të përmirësojë kapacitetet e aktorëve kryesorë të P/LKEDH duke ofruar njohuritë që shërbejnë për të formësuar politikat e parandalimit,



6 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020 (f. 45). Burimi: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

7 “Duke pasur parasysh se fenomeni i ekstremizmit shqiptar është shumë më pak shqetësues sesa ai në vendet fqinje (p.sh. Maqedonia e Veriut, Kosova dhe BH), masat P/LKEDH në nivelin vendor duhet të modernizohen në kontekstin e programeve të policimit në komunitet (ku të përfshihen bashkitë, shkollat, shoqëria civile, media, drejtuesit e komunitetit, grupet fetare) duke ofruar kështu më shumë hapësirë për aktorët civilë vendorë jo-shtetërorë dhe duke zvogëluar gjasat për keqkuptime publike se ekstremizmi është i lidhur ekskluzivisht me Islamin dhe KMSH.” Raporti i ERF Albania 2018 (f. 29).

8 81 siç llogaritet nga Komisioni në Raportin e Progresit të Shqipërisë për vitin 2020, minus 5 qytetarë shqiptarë të riadhesuar në tetor 2020.

9 Rustemi, A. (2020). Tendencat e ekstremit të djathtë në Evropën Juglindore: Ndikimet e Rusisë, Kroacisë, Serbisë dhe Shqipërisë. Marrë nga: <https://hcss.nl/sites/default/files/files/reports/Far-Right%20Trends%20Report%20Final.pdf>

programet e ardhshme të shkëputjes (nga grupet ekstremiste), dhe masat institucionale e kapacitetet e aktorëve për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve dhe viktimave të mundshme të ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm në të ardhmen. Së fundi, ky studim do të rrisë përpjekjet, qëndrueshmërinë e ndikimit të punës P/LKEDH dhe do të kontribuojë në informimin më të mirë të debatit publik dhe në ngushtimin e hapësirave për ideologjitë e EDH për rritjen e mbështetjes apo zgjerimit të bazës së pasuesve të tyre.



3. Metodologjia

Ky studim ka si qëllim të ofrojë informacione që lidhen me kontekstin dhe evidenca për ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Në të analizohet situata aktuale pas pothuajse gjashtë vitesh fushatë për masat e luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe nxitësit dhe faktorët përkatës që e ushqejnë apo e mundësojnë atë. Studimi synon të paraqesë karakteristikat kryesore të ekstremizmit të dhunshëm, shtrirjen dhe madhësinë e tij, komunitetet në rrezik, zonat dhe grupet e cenueshme, rreziqet dhe implikimet e tjera të tij. Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është të përmirësojë performancën e vendit, ndikimin dhe kapacitete e aktorëve të KEDH nëpërmjet debatit të informuar, veprimeve të bazuar në evidenca, përmirësimit të të kuptuarit dhe njohurive të aktorëve kryesorë –shtetërore dhe jo-shtetërorë– të shoqërisë si dhe komunitetit të partnerëve që mbështesin Shqipërinë në këtë përpjekje.

Kështu, studimi përdor të njëjtën qasje si ai i vlerësimit të vitit 2018 “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM 2018), që u bazua në qasjen metodologjike të vlerësimit të parë bazë “Radikalizmi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri”¹⁰. Këto studime mbështeten të gjitha në kuadër të nxitësve social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë ndaj ekstremizmit të dhunshëm siç evidentohet edhe nga Denoeux dhe Carter (2009) në botimin “Udhëzues mbi nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm”. Ashtu si në vitin 2018, nuk u përfshinë tre nxitës politikë – konflikti lokal, mbështetja shtetërore, dhe qeveritë e diskretituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore – për shkak të mungesës së relevancës në kontekstin e Shqipërisë.

Për më tepër, janë hequr edhe disa pohime duke qenë se janë bërë të pavlefshëm për shkak të ndryshimeve ligjore. Disa pohime të tjera u ndryshuan paksa për të bërë të mundur shqyrtimin e formave të tjera të ekstremizmit të dhunshëm. Në studimin e vitit 2018, “Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri” u identifikuan katër nxitës specifikë të Shqipërisë për kurrikulën fetare, autoritetin fetar, shkëputjen, dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë. Në këtë studim, këto çështje shqyrtohen nën dritën e riatdhesimit të pritshëm të shtetasve shqiptarë nga Siria dhe jo për nxitësit drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Në kreun e ri “Riintegrimi dhe Parandalimi” shqyrtohen perceptimet e qytetarëve për shkëputjen, opinionin e tyre për rehabilitimin dhe riintegrimin, besueshmërinë e komuniteteve zyrtare fetare, gatishmërinë e klerit për të ofruar edukim fetar dhe rolin e aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në riintegrimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Si rezultat, kuadri i këtij studimi për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorët e tjerë nën shqyrtim përbëhet nga tre kategori, me gjithsej 17 nxitës të ekstremizmit të dhunshëm, siç evidentohet në Tabelën I.



¹⁰ Studimi i IDM i vitit 2015 gjendet në adresën: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/RadikalizmiFetar-webOK2.pdf>



Tabela 1. Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018

NXITËSIT SOCIAL-EKONOMIKË		NXITËSIT KULTURORË	
Perceptimet e përjashtimit dhe marginalizimit social	Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit	Islami nën rrethim	
Diskriminimi ndaj kulturës shoqëror	Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike	Agjendat “proaktive” fetare	
Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike	Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	
NXITËSIT POLITIKË			
Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët	Pushtimi i huaj	Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm
Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta	Dhunimi politik dhe/ose ushtarak	Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë

Për të shqyrtuar kuadrin e mësipërm, studimi u mbështet në një sërë instrumentesh kërkimore që shtjellohen më poshtë, përfshirë këtu hulumtimin paraprak, rishikimin e të dhënave dytësore, diskutimet në fokus grupe dhe një sondazh kombëtar. Ndryshe nga vlerësimi i mëparshëm kombëtar, në këtë studim përdoret një kampion përfaqësues kombëtar në të 61 bashkitë e vendit që prodhon informacione dhe të dhëna konkrete për secilin prej nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm. U hartuan gjithsej 43 pohime për të testuar rëndësinë dhe përmasat e tre kategorive të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm dhe 11 pohime e pyetje që mbulojnë riintegrimin dhe parandalimin. Pohimet u hartuan duke marrë parasysh sfidat e situatës në Shqipëri dhe kontekstin teorik të nxitësve të EDH, siç përshkruhen nga Denoeux dhe Carter (2009). Kështu, analiza mbështetet në një gamë të gjerë burimesh dhe të dhënash për një shqyrtim gjithëpërfshirës të a) nivelit të nxitësit ose faktorit përkatës, b) kategorisë së nxitësit ose faktorit, dhe c) marrëdhënies mes nxitësve të kategorive të ndryshme dhe ndërveprimeve të tyre në kontekstin shqiptar.

Instrumentet e hulumtimit

Ky studim u mbështet në hulumtimin e të dhënave parësore dhe dytësore, në mënyrë që jo vetëm të japë një panoramë të gjendjes aktuale të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm me informacione të përditësuara, por edhe të evidentojë progresin e arritur në vitet e fundit dhe dinamikën e debatit për P/LKEDH, drejtimin e masave, ndikimin e tyre dhe rezultatet. U bë edhe një analizë paraprake për të përditësuar instrumentin e hulumtimit, qasjen metodologjike, dhe kontekstin vendor të nxitësve aktualë që përcaktohen në këtë studim për të bërë të mundur një analizë më të mirë të rëndësisë së nxitësve dhe pohimeve.



Intervistat

Në fazën fillestare dhe në atë të vleftësimit të metodologjisë u bënë një numër i kufizuar (dhjetë) intervistash gjysmë të strukturuar me ekspertë, punonjës të KEDH, përfaqësues të fesë dhe institucioneve shtetërore. Instrumenti i sondazhit, objekti i hulumtimit, hartimi i pohimeve të kontrollit dhe gjetjet nga procedurat e testimit u konsultuan me ekspertë të zgjedhur dhe përfaqësues të bashkësive fetare, së bashku me konsultime të brendshme brenda grupit hulumtues të IDM-së që përbëhej nga hulumtues me përvojë që merren me tematikën e ekstremizmit të dhunshëm.

Sondazhi kombëtar

Bazuar kryesisht në sondazhin e vitit 2018, ekipi hulumtues i IDM-së hartoi një pyetësor të përditësuar (shih shtojcat), i cili iu nënshtroi një periudhe testimi në nëntor të vitit 2020 dhe që më pas u miratua nga ekipi hulumtues pa ndryshime të mëdha. Testimi paraprak i pyetësorit me 100 të anketuar u bë në dhjetor 2017. Gjetjet e pilotimit të parë u përdorën për të përmirësuar instrumentin e sondazhit dhe për ta nisur atë për një testim të dytë në dy versione (janar 2018, me 50 të anketuar për secilën), të cilat kishin të ndryshme shkallën e vlerësimit për pohimet e kontrollit. Pyetësori i përdorur për këtë sondazh përbëhet nga pesë seksione: (1) të dhëna demografike, (2) shoqëria dhe faktorët social-ekonomikë, (3) feja dhe faktorët (ndër)shtetërorë / politikë, (4) praktikimi i fesë në Shqipëri, dhe (5) rehabilitimi, riintegrimi dhe parandalimi. Në disa raste, pohimet që i përkasin kreut të nxitësve kulturorë apo të riintegritimit dhe parandalimit u spostuan në sondazh për të parandaluar njëanshmërinë e të anketuarve në përgjigje, si rrjedhojë e pyetjeve të bëra më parë.

Në nëntor të vitit 2020, ekipi i IDM-së përgatiti logjistikën për kryerjen e sondazhit në terren me një kampion kombëtar përfaqësues prej 1,600 të anketuarish. Anketa u krye në popullatën e përgjithshme me qytetarë të moshës mbi 18 vjeç, të cilët ishin banorë të përhershëm të Shqipërisë në kohën e sondazhit. Kuadri i kampionimit u bazua tek të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë (2011) të përditësuara me informacione për dinamikën e popullsisë. Shkalla e emigrimit të shtetasve shqiptarë u llogarit nga një Koeficient Sasior Vendbanimi bazuar në regjistrimin e popullsisë dhe numrin e popullsisë sipas Regjistrimit Civil 2015 (shtetas shqiptarë) dhe në shpërndarjen e tyre në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore. Të dhënat nga Regjistri Civil 2019 u ponderuan me koeficientët sasiorë të vendbanimit për secilën prej 61 bashkive nga të cilat u përzgjedhën të gjitha për të mundësuar një mbulim më të mirë gjeografik.¹¹

Vlerësimet e gabimit statistikor janë si më poshtë:

- Në nivel besueshmërie prej 95%, për një popullsi me 2,859,598 banorë, intervali i besueshmërisë është ± 2.4 .
- Në nivel besueshmërie prej 99%, për një popullsi me 2,859,598 banorë, intervali i besueshmërisë është ± 3.2 .

Grupi i intervistuesve u trajnuar në fund të muajit nëntor 2020 dhe puna në terren për sondazhin kombëtar, që konsistonte nga intervistat ballë për ballë, u realizua në muajin dhjetor 2020. Në të gjithë procesin u zbatuan kritere të rrepta për përzgjedhjen e të intervistuarve në çdo bashki dhe



11 Shpërndarja gjeografike e kampionit jepet në kreun e shtojcave.

njësi administrative si dhe u përdorën mekanizma rigorozë për sigurimin e cilësisë gjatë punës në terren me sondazhin dhe administrimin e pyetësorëve. Të dhënat e sondazhit u futën, pastruan dhe përpunuan në një bazë të dhënash duke përdorur programin SPSS dhe në muajin janar 2021 nisi analizimi i gjetjeve paraprake. Të dhënat e sondazhit të prezantuara në këtë studim janë rumbullakosur në dhjetëshen më të afërt. Për shkak të rumbullakosjes, përqindjet jo gjithmonë mund të plotësojnë 100%.



4. Profili i të anketuarve të sondazhit

Hulumtimet për radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm orientohen nga pritshmëria se duke kuptuar më mirë këto fenomene do të bëhen të mundur paralajmërimi në kohën e duhur dhe parandalimi e reagimi më efikas kundër grupeve apo individëve të ekstremizmit të dhunshëm. Në fakt, studimet e pakta të kryera në Shqipëri në vitet e fundit për ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin, luftëtarët e huaj, debati në media për ekstremizmin dhe çështjet e lidhura me të, kanë përmirësuar ndjeshëm njohuritë e aktorëve të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo ka rritur ndërgjegjësimin e publikut, ka forcuar qëndresën e bashkësive fetare dhe ka fuqizuar grupe të cënueshme duke u dhënë aftësi dhe kapacitete më të mira për të luftuar dhe parandaluar idetë dhe veprimet e ekstremizmit të dhunshëm.

Në këtë studim analizohen perceptimet dhe qëndrimet e shqiptarëve ndaj të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, përfshirë atë fetar, nacionalist dhe politik. Për më tepër, me riatdhesimin e pritshëm të shtetasve shqiptarë nga Siria, në këtë studim vlerësohet edhe qëndrimi kolektiv ndaj riatdhesimit, shkëputjes dhe riintegrit të shtetasve shqiptarë që ishin bërë pjesë e konflikteve në vende të huaja.

Demografia e kampionit

Sondazhi u krye me një kampion përfaqësues kombëtar. Nga pikëpamja gjinore, popullsia aktuale rezidente në Shqipëri¹² përbëhet nga 1,420,613 meshkuj (49.9%) dhe 1,425,342 femra (50.1%) të cilët aktualisht jetojnë në Shqipëri. Kampioni ynë, që ka 1600 vetë që banojnë në Shqipëri, përbëhet nga 49.8% meshkuj (N=797) dhe 49.9% femra (N=798), që është shumë pranë përbërjes së përgjithshme gjinore të popullsisë.¹³ (shih Figurën 1). Ndonëse nuk administrohet në statistikat zyrtare të Shqipërisë, ky studim përfshin si përgjigje alternative edhe 'tjetër' për gjininë, duke marrë parasysh shqiptarët me gjini jo-binare. Duke pasur parasysh se vetëm 5 të anketuar (0.3%) vendosën të identifikohej si 'tjetër', ka kufizime për sa i përket përgjithësisë të përgjigjeve të tyre. Prandaj, përgjigjet e tyre analizohen veçmas kur janë të rëndësishme për pohimin ose pyetjen.




12 INSTAT. (2020). Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2020. Shih: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografikë-dhe-socialë/popullsia/#tab3>

13 Të dhënat demografike të paraqitura në kapitujt e mëposhtëm janë rumbullakosur në dhjetëshen më të afërt. Për shkak të rumbullakosjes, përqindjet jo gjithmonë mund të plotësojnë 100%.




Figura 1: Përbërja gjinore e të anketuarve të sondazhit (%; N = 1,600)



Gjatë përcaktimit të të anketuarve për secilën bashki në vend, në sondazh u tregua kujdes për sa i përket raportit të vendbanimit zonë urbane-zonë rurale për secilën bashki për të qenë sa më afër raportit kombëtar¹⁴. Raporti urban-rural i kampionit prej 1600 të anketuarish është 59:41 me 938 të anketuar që jetojnë në qytete (58.6%) dhe 662 që jetojnë në zonat rurale (41.4%).

Në sondazh u analizuan vetëm përgjigjet e popullsisë madhore, ku 39.6% e kampionit është nën moshën 45 vjeç: 12.3% e të anketuarve janë të moshës 18-24 vjeç dhe 27.3% është e moshës 25-34 vjeç. Më shumë se gjysma e anketuarve janë të moshës 35-64 vjeç, ndërsa vetëm 6.7% e kampionit është e moshës mbi 65 vjeç (shih edhe Figurën 2).

Figura 2: Moshja e të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)




• • •

14 Sipas të dhënave më të fundit të Censurit, të kryer në vitin 2011, raporti urban-rural ishte 54:64. Gjithsesi, ndarja e re territoriale dhe administrative e vendit (që nga viti 2015) përfshiu disa zona rurale brenda kufijve të rinj administrativë të qendrave urbane në bashkitë e reja. Kjo, së bashku me urbanizimin e vazhdueshëm të Shqipërisë, është arsyeja që kampioni ynë ka qëllimisht një përqindje më të lartë të banorëve nga zonat urbane.



Më shumë se 2/3 e të anketuarve kanë përfunduar arsimin e mesëm apo të lartë (shih Figurën 3). 24.4% e të anketuarve kanë mbaruar arsimin fillor ose janë pa arsim: 64 të intervistuar (4%) janë pa arsim ose nuk e kanë përfunduar ciklin e plotë 8/9-vjeçar, 326 të intervistuar (20.4%) kanë mbaruar arsimin 8-vjeçar ose 9-vjeçar; 647 të anketuar (40.4%) kanë mbaruar arsimin e mesëm, 462 (28.9%) të anketuar kanë diplomë universitare dhe 97 të anketuar (6.1%) kanë mbaruar studimet pasuniversitare (studime master ose më tej).


Figura 3: Figura 3. Niveli arsimor i të intervistuarve të sondazhit (%; N = 1,600)



Shumica e të anketuarve janë të martuar (62.2%), ndërsa një çerek (24.6%) janë të pamartuar. 6.6% bashkëjetojnë, 35 të anketuar janë të divorcuar (2.2%) dhe 57 të anketuar janë të ve (3.6%). Dymbëdhjetë të anketuar (0.8%) refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Të anketuarve iu kërkua të deklarorin edhe statusin e tyre të punësimit. Më shumë se gjysma e të anketuarve (58.5%) janë pjesë aktive në fuqinë punëtore, me 41.4% të punësuar me pagë dhe 17.1% të vetëpunësuar. Të anketuarit e papunë përbëjnë një çerek të kampionit (25.2%) dhe 6.3% të të anketuarve janë studentë. Pjesa e mbetur e të anketuarve prej 9.4% deklaruan si status punësimi përgjigjen “tjetër”, ku pjesa më e madhe janë pensionistë dhe shtëpiake. 0.6% e të anketuarve nuk iu përgjigjen kësaj pyetjeje.

Figura 4: Statusi i punësimit i të intervistuarve të sondazhit (N=1600)




Përkatësia dhe praktikat fetare

Bashkëjetesa dhe toleranca fetare konsiderohen si vlera themelore të shoqërisë shqiptare. Shpesh e konsideruar si bastioni i fundit i tolerancës fetare në Evropë, Shqipëria është vendi i disa komuniteteve tradicionale fetare që janë krijuar para shumë shekujsh si dhe komunitetet fetare që janë krijuar kohët e fundit, në këto tre dekadat e fundit. Për qëllimet e hulumtimit tonë, i kërkuam të anketuarve të deklarojnë fenë e familjes së tyre dhe fenë e tyre personale. Feja e familjes është veçanërisht e dobishme për të mundësuar që kampioni të jetë sa më përfaqësues i shpërndarjes së bashkësive fetare në popullsinë e Shqipërisë. Sipas Censurit të fundit zyrtar të vitit 2011, 56.7 për qind deklaruan se ishin myslimanë sunitë, 10 për qind të krishterë katolikë, 6.8 për qind të krishterë ortodoksë, 2.1 për qind bektashinj, 0.2 për qind të kishave të tjera të krishtera.¹⁵ Rreth 2.5 për qind u deklaruan ateistë, ndërkohë që ka një numër të vogël Dëshmitarë të Jehovait, pasues të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Mëvonshëm (mormonët), përveç rreth 40-50 çifutëve që jetojnë në Shqipëri.¹⁶

Duke pasur parasysh kampionin përfaqësues të grupit më të madh të besimtarëve, myslimanët sunitë (që në këtë studim i referohemi si ‘myslimanë’ siç është zakon në Shqipëri), 57.0% e të anketuarve e identifikojnë veten si të tillë (shih Figurën 5). 10.8% e të anketuarve janë ortodoksë, 13.3% katolikë, 9.6% ateistë, dhe 6.6% bektashinj. 0.7% e kampionit u identifikua si ungjillorë, 2 të anketuar janë agnostikë dhe 0.6% i përkasin grupimeve të tjera fetare.

Figura 5: Përkatësia fetare e të anketuarve (N=1600) dhe e familjes së tyre (N=1595). Nuk janë përfshirë përgjigjet ‘Nuk e di’ dhe ‘Refuzoj të përgjigjem’.



15 Përfaqësuesit e të gjitha bashkësive fetare argumentojnë se regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 jep një pamje të pasaktë të demografisë fetare të Shqipërisë, dhe jo vetëm për shkak se pyetja ishte opsionale. Ky census gjendet në adresën: http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf


16 Kongresi Botëror i Çifutëve, Shqipëri (Raport), <http://www.worldjewishcongress.org/en/about/communities/AL>



Në sondazhin tonë, 963 të anketuar (60.3%) deklaruan se feja e familjes së tyre është Islami sunit. E njëjtë me përkatësinë e tyre fetare, 168 të anketuar (10.5%) vijnë nga familje të krishtera ortodokse dhe 201 të anketuar (12.6%) janë nga familje të krishtera katolike. 112 të anketuar (7.0%) deklaruan se familja e tyre është e besimit bektashian dhe 5 të anketuar (0.3%) janë nga familje të krishtera ungjillore. 7.1% e të anketuarve vijnë nga familje me përkatësi të përzier fetare, gjë që është mjaft e zakonshme në Shqipëri.

Për të vlerësuar besimin e të anketuarve, u përfshinë dy pyetje për të analizuar sa të rregullt janë të anketuarit në praktikimin e detyrimeve fetare (d.m.th., kryerjen e riteve fetare, falje/lutje). Të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin një opsion sipas një shkalle që përshkruan praktikimin e fesë së tyre. Kjo shkallë varion nga besimtari që i përmbush rregullisht kërkesat e besimit të tyre, tek besimtari që respekton ritet dhe rregullat kryesore të besimit, por që neglizhon pjesën tjetër, tek besimtari që nuk praktikon fare rregullat dhe ritet fetare, deri tek ateisti. Shumica e të anketuarve janë besimtarë që e praktikojnë besimin e tyre në mënyrë të moderuar. 19.8 për qind e deklarojnë veten që përmbushin rregullisht të gjitha ritualet fetare; 35.9 për qind praktikojnë ritet kryesore fetare gjatë një viti normal, dhe 33.5% janë besimtarë por nuk praktikojnë rite fetar. 9.5% e të anketuarve nuk praktikojnë asnjë rit fetar, sepse janë ateistë (shih Figurën 6).

Figura 6: Praktikimi i riteve fetare tek të anketuarit (N=1600)




Lutja/falja është ndoshta akti më i individualizuar në fetë abrahamike dhe në të njëjtën kohë është një shprehje kolektive e devotshmërisë, tejet e ritualizuar, me klerikë të specializuar dhe rregulla që duhen ndjekur. Prandaj, të anketuarve u bë më këtë pyetje: “Mund të më thoni sa shpesh luteni/faleni?” U dhamë një opsion për besimtarin e përkushtuar që lutet/falet rregullisht çdo ditë ose çdo javë, dy opsione për besimtarët që lutem/falem gjatë ritualeve kolektive, që është tregues i devotshmërisë më të vogël, një opsion për besimtarët që kryesisht bëjnë një jetë laike dhe i kthehen fesë në kohë krize, ndoshta si një mjet i fundit, një opsion si për besimtarët që nuk lutem apo edhe për jobesimtarët, si dhe një opsion “nuk lutem/falem” ose për të mos e zbuluar këtë informacion personal.

Shumica e të anketuarve (39.6%) lutem/falem me raste, në ngjarje të veçanta fetare gjatë një viti, ndërsa 21.8% lutem/falem rregullisht (çdo ditë ose javë). Gjetjet e sondazhit tregojnë se 22.1% e të anketuarve lutem/falem me raste, me 11.3% lutem/falem në festa fetare përgjatë gjithë vitit dhe 10.8%

në kohë krizash personale apo familjare. 15.5% e shqiptarëve nuk luten/falen asnjëherë, që është një përqindje shumë më e ulët krahasuar me sondazhin e vitit 2018, ku 23.9% e kampionit nuk lutej/falej asnjëherë.

Figura 7: Praktikimi i lutjes/faljes tek të anketuarit (N=1448)



Kur shqyrtojmë shpeshtësinë e lutjes/faljes dhe grupin fetar të cilit i përketin të anketuarit, të dhënat tregojnë se nga shtatë grupet fetare, të anketuarit që janë ungjillorë kanë frekuencën më të lartë të praktikimit të lutjes, me 54.5 për qind të tyre që deklarojnë se luten rregullisht çdo ditë apo javë. Shumica e të krishterëve të anketuar (51.4% katolikë; 44.8% ortodoksë) tregojnë se priren të luten më shpesh në festa fetare gjatë gjithë vitit, të ndjekur nga bektashinjtë me 42.9 për qind. Grupi më i madh fetar në Shqipëri, myslimanët, shfaqin një nivel të ngjashëm të lidhjes me fenë ashtu si të krishterët, me shumicën e tyre (36.9%) që praktikojnë faljen vetëm në festa fetare gjatë gjithë vitit dhe vetëm 20.8 për qind tregojnë se falen rregullisht.


Perceptimet dhe përvoja e bashkekzistencës fetare në Shqipëri

Me pesë bashkësi fetare zyrtare, Shqipëria konsiderohet si një shoqëri multi-fetare ku shumica e njerëzve në jetën e përditshme bashkëveprojnë me individë të besimeve të ndryshme. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë gjithmonë që shqiptarët ndërtojnë marrëdhënie kuptimplote me njerëz të një besimi tjetër, veçanërisht në një mjedis që ka të bëjë më familjen. Në përpjekje për të zvogëluar paragjykimin shoqëror që i shtyn të anketuarit të përgjigjen pozitivisht kur pyeten në përgjithësi nëse janë dakord me martesat ndër-fetare, të anketuarit u pyetën nëse ata personalisht do të mbështesnin një anëtar të familjes të martohet me një person që i përket një feje tjetër.

Shumica e të anketuarve (65.5%) thanë se sigurisht që do të mbështesnin një anëtar të familjes (vëlla/motër apo fëmijë) nëse do të martohet me një person të një përkatësie tjetër fetare, ndërsa 16.2% do ta pranonin një martesë të tillë, por jo ta mbështesnin apo ta inkurajonin atë. 5.8% do të kundërshtonin nëse personi me të cilin do të martohen është një besimtar praktikant dhe 4.6% do të kundërshtonin në çdo rast. 6.4% e të anketuarve nuk ishin të sigurt se cili do të ishte reagimi i tyre në një situatë të tillë, ndërsa 1.5% të tjerë refuzuan të japin një përgjigje për këtë pyetje (shih Figurën 8).




Figura 8: Mbështetja e të anketuarve për martesën ndërfetare të një anëtari të familjes (N=1584)



Të anketuarit e grupmoshës 18-24 (80.4%), të anketuarit me arsim pasuniversitar (80.2%), që aktualisht po ndjekin studime (78.8%) dhe që janë të pamartuar (76.2%) shfaqën një mbështetje dukshëm më të madhe për martesat ndërfetare brenda familjes. Nivel më i lartë tolerance vihet re edhe mes të anketuarve familjet e të cilëve kanë një kontekst të përzier fetar (82.1%) dhe të të anketuarve që janë bektashinj (78.8%), agnostikë (100%) ose ateistë (76.8%). Individët që nuk luten/falen asnjëherë (70.1%) janë më të prirur të mbështesin vëllezërit/motrat apo fëmijët e tyre nëse do të martoheshin me dikë nga një fe tjetër.

Së fundmi, shqyrtuam perceptimet e të anketuarve ndaj tolerancës fetare dhe bashkëjetesës paqësore, duke iu kërkuar atyre të tregonin në një shkallë përgjigjen e tyre për pyetjen: “Sipas mendimit tuaj, në Shqipëri ka kryesisht urrejtje apo harmoni fetare?” (Shih Figurën 9). Shumica dërrmuese e të anketuarve (93.6%) pohojnë se në Shqipëri ekziston (disi) harmoni fetare. 30.7% thonë se ekziston një farë harmonie fetare dhe 62.9% e të anketuarve thonë se ekziston harmoni fetare. Shumë pak (1.4%) zgjedhën urrejtjen fetare si perceptimin e tyre të situatës aktuale, ndërsa 5.1% mendojnë se në Shqipëri, ekziston disi urrejtje fetare. Të anketuarit nga familje me përkatësi të përzier fetare kishin më pak gjasa të perceptonin se ekziston (disi) harmoni fetare në Shqipëri (85.7%).

Figura 9: Opinioni i të anketuarve për tolerancën fetare në shoqërinë shqiptare (N=1592)



5. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri

5.1. Nxitësit social-ekonomikë

Në këtë kapitull shqyrtohet ndikimi i nxitësve social-ekonomikë në krijimin e kushteve të favorshme për përhapjen e ideve radikale dhe ekstremiste te popullata në vend. Faktorë të tillë si varfëria absolute dhe relative, fragmentarizimi social, përjashtimi social dhe diskriminimi, aktiviteti i paligjshëm ekonomik, mes të tjerash, dihet se shoqërohen me zhgënjimin me sistemin ekonomik dhe politik. Të rinj të papunë të izoluar që vijnë nga zona të pazhvilluara mund të bëhen pre e lehtë e propagandës dhe ideologjive ekstremiste që mbrojnë përdorimin e dhunës për të protestuar kundër rendit ekzistues dhe për të mundësuar ndryshimet e dëshirueshme së bashku me përfitimet personale.

Edhe pse Shqipëria është tashmë një vend ku të ardhurat për frymë janë mbi mesataren sipas Bankës Botërore, PBB për frymë në 2019 në Shqipëri ishte vetëm 14.5% e mesatares së BE-së¹⁷. Për më tepër, familja shqiptare është më shumë e rrezikuar ndaj varfërisë sesa pjesa më e madhe e vendeve të tjera të BE-së: në 2018, 23.4% familjeve shqiptare ishin në rrezik varfërie, ndërkohë që mesatarja e 28 vendeve të BE-së, përfshirë këtu edhe Britaninë e Madhe, ishte 16.9%¹⁸. Zhvillimi gjeografikisht i pabarabartë, që ekziston në këtë vend, bën që komunitetet në zonat rurale, të largëta dhe të pazhvilluara të mbeten tejte të marginalizuara. Të rinjtë zënë një përqindje tepër të madhe në statistikat e papunësisë. Në tremujorin e tretë të vitit 2020, niveli zyrtar i papunësinë në Shqipëri ishte 11.6%, ndërkohë që niveli zyrtar i papunësisë të të rinjve për të njëjtën periudhë është 20.7%.¹⁹

Në këtë studim kombëtar janë marrë parasysh disa nxitës social-ekonomikë me qëllim që të kuptohet ndikimi i tyre në zona të ndryshme të vendit dhe kërcënimi që paraqesin ato për shoqërinë, sepse ofrojnë kushtet për lindjen e grupeve radikale fetare dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Në tabelën e mëposhtme jepen nxitësit e identifikuar dhe përshkrimi i tyre.



17 PBB për frymë në 2019 në Shqipëri ishte \$5,369, ndërsa PBB për frymë në BE ishte \$37,104 në të njëjtin vit. Shih edhe: <https://countryeconomy.com/gdp/albania> dhe <https://tradingeconomics.com/european-union/gdp-per-capita>

18 INSTAT. (2019). Të ardhurat dhe kushtet e jetesës në Shqipëri, 2017 – 2018. Gjetet në adresën: <http://www.instat.gov.al/media/6544/income-and-living-conditions-in-albania-2017-2018.pdf>

19 <http://www.instat.gov.al/media/7812/lfs-q3-2020.pdf>



Tabela 2: Nxitësit social-ekonomikë të ekstremizmit të dhunshëm sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018

Perceptimet e përjashtimit social dhe marginalizimit	Ky perceptim mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku janë dëmtuar strukturat e familjes, kontrollet normale sociale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë kanë shumë kohë që rrinë pa bërë asgjë. Kjo sjell si rezultat një ndjesi izolimi dhe dëshirë për të shkelur ligjet. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, ndjesinë e gjetjes së qëllimit dhe përfshirjen në një lëvizje kolektive.
Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit	Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm në radikalizim dhe rekrutim. Njerëzit mund të përfshihen në grupe të ekstremizmit të dhunshëm së bashku me miqtë ose si rezultat i ndikimit të të afërmeve apo të ndonjë predikuesi karizmatik lokal.
Diskriminimi shoqëror	Diskriminimi i perceptuar apo i vërtetë ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyja), në një kuptim të gjerë mund të jetë një nxitës për ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë një pakicë e vogël, diskriminimi social-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet si i lidhur me mungesën e respektit për Islamin dhe myslimanët, gjë që provokon radikalizimin.
Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm për të rinjtë duke pasur parasysh përmirësimet në arsimim, sidomos në nivelin e shkollës së mesme dhe të universitetit. Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor priren të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria. Në përgjithësi, ata nuk mund të marrin vendet punës që mendojnë se i meritojnë; ata e dinë që nepotizmi pengon mundësitë për punë.
Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike	Mospërbushja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.
Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike	Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura në rrugë të lehta. Rrjetet që ushtrojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të fshehur sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm.

1. 'Perceptimet e përjashtimit social dhe marginalizimit' dhe

2. 'Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit'

Perceptimi i përjashtimit social mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku janë dëmtuar strukturat e familjes. Në një mjedis të tillë, kontrollet normale sociale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë kanë shumë kohë që rrinë pa bërë asgjë, gjë që bën që ata të bien pre e sjelljeve dhe qëndrimeve të rrezikshme. Si rezultat i ndjesisë së izolimit dhe dëshirës për të shkelur ligjet, grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, ndjesinë e gjetjes së qëllimit dhe përfshirjen në një lëvizje kolektive. Në mënyrë të veçantë, ky rreth shoqëror është një faktor i rëndësishëm për radikalizimin dhe rekrutimin. Në Shqipëri, shumica e njerëzve që u bashkuan me grupet kryengritëse në Irak dhe Siri ishin nga i njëjti rreth shoqëror. BIRN konstatoi se nga individët që largoheshin nga fshatrat afër Pogradecit, disa burra janë të afërm ose miq, të cilët u bashkuan në rrjetin radikal që vepronte në një xhami në një prej këtyre fshatrave.²⁰ Prevalenca e grupeve ekstremiste - qofshin ato politike, nacionaliste, apo fetare - është pjesë e rëndësishme e këtij nxitësi.

Pohimet në këta nxitës:

- Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhunës, veprime vandale, etj.)
- Në zonën ku banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin e dhunshëm politik/nacionalist/fetar

Pohimi: Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhunës, veprime vandale, etj.)

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh nga "aspak dakord" (1) deri në "plotësisht dakord" (4). Shumica dërrmuese (84.8% e të anketuarve) është dakord se ka shumë të rinj në zonën ku ata jetojnë, që kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogës apo sjelljeve të rrezikshme, ndërsa 11.8% nuk janë dakord. Krahasuar me 2018, kur 80.8% e të anketuarve ishin dakord, ka një rritje prej 4.0 p.p. në përqindjen e të anketuarve që janë dakord me këtë pohim.

Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (92%) ishin më shumë të prirur të binin dakord, në krahasim me të anketuarit e grupmoshës 18-24 vjeç (79%), të cilët ishin më pak të prirur të binin dakord. Të anketuarit me arsim fillor (91%) kishin më shumë gjasa të ishin dakord, ndërsa studentët (78%) ishin më pak të prirur. Sa më shpesh që praktikon fenë e tij apo lutet/falet i anketuari, aq më shumë ka të ngjarë të jetë dakord me pohimin: 88% e të anketuarve në këtë sondazh që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare dhe 89% e të anketuarve që luten/falen rregullisht thonë se janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim.

Të anketuarit që banojnë në Vlorë, Fier, Dibër, Durrës dhe Tiranë kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin. Në disa bashki të vogla si Cërriku, Fushë-Arrëzi, Himara, Mati,




20 Bogdani, A. (2016). Fshatrat e xhihadit: Si u rekrutuan të rinjtë për të luftuar në Siri. Reporter.al, available online: <https://www.reporter.al/fshatrat-e-xhihadit-si-u-rekrutuan-te-rinjte-per-te-luftuarne-siri/>



Vora, Rrësheni, Klosi, Kurbini, Memaliaj, Patosi dhe Puka, të gjithë të anketuarit tregojnë se në zonën ku jetojnë shumë të rinj kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogës ose sjelljeve të tjera të rrezikshme (dhuna, vandalizmi, etj.). Në Mallakastër, Prrenjas dhe Gramsh, përveç një të anketuari, të gjithë pohuan të njëjtën gjë. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, vihet re një rritje e dakordësisë me këtë pohim në qytete me dendësi të lartë popullore, si Tirana, Durrësi dhe Fieri. Njësoj si në sondazhin e këtij viti, Elbasani, Lezha, Kamza dhe Kukësi shfaqën një nivel më të lartë miratimi me këtë pohim edhe në 2018.

Figura 10: Mbështetja për mendimin se të rinjtë kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogës dhe sjelljeve të rrezikshme (N=1598)



Pohimi: Në zonën ku banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin e dhunshëm politik.

27.3% e të anketuarve bien dakord që në zonat ku ata jetojnë, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik, ndërsa shumica (61.9%) nuk janë dakord dhe 10.9% nuk janë të sigurt ose e konsiderojnë deklaratën si pa lidhje. Të anketuarit me arsim pasuniversitar (40%) kanë më shumë gjasa të jenë dakord me këtë pohim krahasuar me të anketuarit me nivel më të ulët arsimor. Të anketuarit e vetëpunësuar (46%) ishin më të prirur të binin dakord në krahasim me studentët (37%). Të anketuarit nga Bulqiza, Rrogozhina dhe Kamza kishin më shumë gjasa të ishin dakord me këtë pohim. Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet e fesë së tyre ishin grupet më të predispozuar të besimtarëve që binin dakord me pohimin. Sa më shpesh që lutet/falet një i/e anketuar, aq më i/e prirur është ai/ajo të bie dakord: 37% e të anketuarve që luten/falen rregullisht bien dakord që ka individë ose grupe në zonat e tyre që nxisin ekstremizmin politik.


Pohimi: Në zonën ku banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin e dhunshëm nacionalist.

7.6% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord se ka në zonën ku banojnë, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin e dhunshëm nacionalist, ndërsa 79.6% nuk ishin dakord dhe 12.9% ishin të pasigurt apo e shihnin pohimin si pa lidhje. Nuk u vunë re dallime të mëdha kur përgjigjet analizohen sipas treguesve demografikë. Të anketuarit nga Kuçova, Mati, Kurbini, dhe Pogradeci²¹ prireshin më shumë të binin dakord me këtë pohim.

Pohimi: Në zonën ku banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin e dhunshëm fetar.

12.1% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord se në zonën ku ata jetojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar, ndërsa 73.4% nuk ishin dakord dhe 14.3% nuk ishin të sigurt ose e konsideronin pohimin si pa lidhje. Të anketuarve iu kërkua të specifikonin përgjigjen e tyre nëse ishin dakord se në Shqipëri ka ekstremizëm fetar.²² Të anketuarit me arsim pasuniversitar (18%) prireshin më shumë të binin dakord me pohimin krahasuar me të anketuarit që kanë përfunduar ciklin 8/9 vjeçar të arsimit (9%). Të anketuarit e besimit katolik (18%), që praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet e fesë së tyre (21%) dhe luten rregullisht (21%) e mbështesin këtë pohim më shumë se mesatarja. Të anketuarit që banonin në Rrogozhinë, Kamzë, Durrës dhe Pogradec kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin. Krahasuar me listën e bashkive të 2018 ku të anketuarit raportuan më shpesh se ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar, në listë u shtuan edhe Rrogozhina dhe Pogradeci.

Figura 11: Ka individë apo grupe që nxisin ekstremizmin politik (N=1598) / nacionalist (N=1593) / fetar (N=1598)



- 21 Të gjithë të anketuarit nga Dropulli ishin dakord me këtë pohim, por kjo bashki kishte vetëm dy të anketuar.
- 22 Të anketuarve iu kërkua të thonin me cilën fe ishin të lidhur këta individë ose grupe. Nga 141 të anketuar që dhanë përgjigje specifike, 38.9% thanë Dëshmitarët e Jehovait. Edhe Islami zgjidhej shpesh (22.6%). Pjesa tjetër e të anketuarve e lidhnin ekstremizmin fetar me sjellje individuale radikale (15%) dhe me besimet fetare jo-tradicionale (3.5%). Nëntë të anketuar dhanë si përgjigje “Islami në Siri”, “ISIS” dhe “Siria”.



Me rritjen gjithnjë e më alarmante që raportohet për veprimtarinë kriminale, nuk është për t'u habitur që shumica e të anketuarve besojnë se të rinjtë shqiptarë kanë rënë pre e kumarit, alkoolit, drogës apo sjelljeve të tjera të rrezikshme. Krahasuar me gjetjet e vitit 2018, mbështetja për këtë pohim është rritur paksa, veçanërisht në bashkitë me dendësi të lartë popullore si Tirana, Durrësi dhe Fieri. Ndërkohë që dëmtimi i strukturave familjare dhe kërkimi i identitetit luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes së tyre, hulumtimet empirike sugjerojnë se të rinjtë e papunë, që nuk përmbushin dot nevojat bazë apo nuk kanë mundësi për të arritur qëllimin, kanë më shumë të ngjarë të përfshihen në sjellje të rrezikshme. Në këtë mënyrë, ata kërkojnë të tërheqin vëmendjen për pakënaqësitë që kanë²³, gjë që sugjeron që situata socio-ekonomike e individëve është përkeqësuar shumë. Dështimi i institucioneve për trajtimin siç duhet të përpjekjeve të këtyre të rinjve krijon një mjedis të përshtatshëm që shfrytëzohet grupet ekstremiste për të mbushur këtë boshllëk.

Rrjetet shoqërore njihen si faktorë që kontribuojnë në lehtësimin e rrugës drejt radikalizimit, sepse mund të ndikojnë te komunitetet më të izoluar që ndeshen me vështirësi ekonomike, papunësi apo mungesë zhvillimi. Në rastin e Shqipërisë, rrjetet shoqërore kanë qenë të një rëndësie parësore në ruajtjen e lidhjes së qëndrueshme me ideologjinë ekstremiste për shkak të një varësie që është krijuar gradualisht si dhe për shkak të rolit të tyre si ofrues të shërbimeve. Gjithsesi, shumica dërrmuese e shqiptarëve e mohojnë praninë në komunitetet e tyre të individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin politik, nacionalist apo fetar. Prania e individëve aktivë ose grupeve që nxisin ekstremizmin politik (27.3%) raportohet se është më e madhe se prania e grupeve ekstremiste fetare (12.1%), apo e ekstremistëve nacionalistë (7.6%). Njësoj si me pohimet e tjera nëse ekzistojnë grupe ekstremiste të dhunshme që veprojnë në zonën ku jetojnë të anketuarit, më pak se 2% e të anketuarve i konsiderojnë këto pohime si pa lidhje. Ashtu si në vitin 2018, Kamza dhe Durrësi raportohen në mënyrë të përsëritur se bëhen strehë e individëve apo grupeve që nxisin radikalizmin fetar, ndërsa në Kamzë dhe Rrogozhinë përmenden më shpesh individët apo grupet që nxisin ekstremizmin politik. Të anketuarit nga Pogradeci pohojnë praninë e grupeve që nxisin ekstremizmin fetar dhe nacionalist në zonën e tyre. Kjo gjë sinjalizon nevojën e shtimit të përpjekjeve në këto bashki për të luftuar dhe parandaluar ndikimin e grupeve ose individëve ekstremistë.

3. Diskriminimi shoqëror

Shqipëria njihet si shoqëri tolerante nga pikëpamja fetare, ku njerëzit janë të lirë të zgjedhin se çfarë besimi duan të praktikojnë. IDM (2018) konstatoi se 92.3% e të anketuarve mendojnë se toleranca fetare është një vlerë themelore për Shqipërinë.²⁴ Edhe pse shumica e shqiptarëve janë myslimanë sunitë, interpretimi shpesh është i gjerë dhe vetëm një përçindje e vogël e shqiptarëve e konsiderojnë veten besimtarë praktikantë. Për më tepër, shumica e të anketuarve të këtij studimi mohuan që ata, anëtarët e familjeve të tyre ose dikush tjetër në komunitetet e tyre të jenë diskriminuar për shkak të besimit fetar.²⁵ Diskriminimi i vërtetë apo i perceptuar ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyve) në një kuptim të gjerë mund të bëhet nxitës i ekstremizmit të dhunshëm. Për të analizuar perceptimet për diskriminimin u lexuam të anketuarve tre pohime duke i pyetur nëse janë dakord dhe në çfarë mase janë dakord me to.



23 Ikejiaku, B. (2009). "The Relationship between Poverty, Conflict and Development." Journal of Sustainable Development, vol. 2, no. 1, pp. 15-28. And Marke, D. (2007). Will Africa Ever Be Able to Replicate Successful Economies? Standard Times Press.

24 Vurmo, G., Sulstarova, E., Papa, A, Dhëmbo, E. dhe Jashari, D. (2018). Toleranca fetare në Shqipëri. UNDP & Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë

25 Po aty.

Pohimet në këtë nxitës:


- Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.
- Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.
- Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.

Pohimi: Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 12% janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërkohë që 61.9% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord. 13.1% e të anketuarve e konsideronin pohimin si pa lidhje dhe 5.8% ishin të pasigurt. Krahasuar me vitin 2018, ku 12.8% ishin dakord me pohimin, ka një rënie të vogël me 0.8 pikë përqindje (p.p.) në raportin e të anketuarve që janë dakord me pohimin.

Të anketuarit nga Kukësi, Puka, Tropoja, Vau i Dejës dhe Hasi ishin më të prirur të binin dakord me pohimin. Të anketuarit pa arsim ose me arsim më pak se fillor (27%) e mbështesnin më shpesh këtë pohim. Të anketuarit myslimanë (15%) kanë më shumë gjasa të jenë dakord me pohimin sesa të anketuarit bektashinj (4%). Të anketuarit që luten/falen me raste, në kohë krize familjare ose personale (19%) janë më të prirur të pajtohen me pohimin sesa ata që nuk luten/falen kurrë (8%).

Figura 12: Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social (N=1599)

**Pohimi: Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.**


Kur u pyetën nëse ishin dakord apo jo me pohimin, 1 në 4 të anketuar (25.8%) ishin dakord, ndërkohë që shumica e të anketuarve (62.7%) nuk ishin dakord ose aspak dakord. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018 ku 30.5% ishin dakord me pohimin, ka një rënie prej 4.7 p.p. në



numrin e të anketuarve që bëjnë lidhjen e mjekrës së gjatë dhe mbulimit të kokës me shami me ekstremizmin e dhunshëm. 8.8% e të anketuarve e konsideronin këtë pohim si pa lidhje dhe 2.9% nuk dinin nëse ishin dakord apo jo me pohimin.

Të anketuarit më pak të arsimuar (34% e të anketuarve me arsim fillor) kishin më shumë gjasa të idhin dakord me pohimin në krahasim me më të arsimuarit (12% e atyre me arsim pasuniversitar). Të anketuarit e papunë (30%) ishin më të prirur të ishin dakord me pohimin sesa të anketuarit e vetëpunësuar (20%). Të anketuarit agnostikë (N = 2; 100%), ungjillorë (N = 11; 46%), ortodoksë (35%) dhe katolikë (35%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa vetëm 1 në 5 të anketuar myslimanë ranë dakord me të. Sa më rrallë që praktikon fenë i/e anketuari/ja (31% e të anketuarve që identifikohen si ateistë), aq më të prirur janë ata të bien dakord me pohimin.

Figura 13: Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë (N=1597)




Pohimi: Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.

Kur u pyetën nëse ishin dakord apo jo me pohimin, 41.6% e të anketuarve bien dakord se komuniteti fetar të cilit i përkasin është i përfaqësuar mirë në politikë dhe institucione shtetërore, ndërsa 38.1% nuk janë dakord. 14.7% thanë se nuk e dinin nëse duhet të ishin dakord apo jo me pohimin dhe 5.6% e konsideronin këtë pohim si pa lidhje – duke u shprehur se përkatësia fetare e zyrtarëve publikë nuk është shqetësimi i tyre kryesor. Krahasuar me vitin 2018, ku 30.0% ishin dakord me pohimin, ka një rritje me 11.6 p.p. në raportin e atyre që janë dakord me pohimin se komuniteti fetar të cilit i përkasin është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.

Perceptimi se komuniteti fetar i të anketuarve është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore është më pak i përhapur te të anketuarit që kanë arsim universitar (36%) sesa tek ata të anketuar që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (50%). Të anketuarit e besimit ortodoks (52%), katolik (46%), bektashi (45%), dhe mysliman (42%) prireshin më shumë të binin dakord me këtë pohim. Sa më shpesh të praktikojë fenë e tij/saj i/e anketuari (50% e besimtarëve praktikantë), aq më i/e prirur është ai/ajo të jetë dakord me këtë pohim.

Figura 14: Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore (N=1595)



Shumica e të anketuarve mendojnë se besimi fetar nuk është motiv për diskriminimin shoqëror në Shqipëri, dhe as se pamja është tregues që një individ ka pikëpamje ekstremiste. Megjithatë, 38.1% e të anketuarve thonë se feja e tyre nuk është e përfaqësuar mirë në politikë. Sa më shpesh që një person ushtron fenë e tij, aq më i/e prirur është të deklarojë se mjekra e gjatë ose shamia për mbulimin e fytyrës nuk tregon se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë dhe se komuniteti fetar të cilit i përkasin është i përfaqësuar mirë në politikë dhe institucionet shtetërore. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, ka më pak njerëz që e lidhin mjekrën e gjatë dhe shaminë e mbulimit të kokës me ekstremizmin fetar.

Edhe pse diskriminimi shoqëror për shkak të përkatësisë fetare nuk është i evidentueshme, pasi shumica e shqiptarëve janë tolerantë ndaj grupeve të tjera fetare, ka disa faktorë që tregojnë se ka shkaqe që duhet të na shqetësojnë. Të paktën 12% e të gjithë të anketuarve mendojnë se përkatësia e tyre fetare bëhet shkak për diskriminimin ekonomik dhe social ndaj tyre. Për më tepër, një në katër të anketuar e lidhin mbajtjen e mjekrës ose shamisë për mbulimin e kokës me ekstremizmin fetar. Së fundi, më shumë se një në tre të anketuar besojnë se komuniteti i tyre fetar nuk është i përfaqësuar mirë në politikë dhe në institucionet shtetërore. Ndonëse nuk është e thënë që këto perceptime të prodhojnë vetë mesazhe të ekstremizmit të dhunshëm, pakënaqësia nga diskriminimi i perceptuar dhe mungesa e përfaqësimit të drejtë në institucionet shtetërore mund të keqpërdoren nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm.

4. Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ

Pavarësisht përmirësimeve relative në vitet e fundit, të rinjtë në Shqipëri, përfshirë edhe të diplomuarit universitarë, vazhdojnë të përballen me shumë vështirësi dhe privime, duke bërë që të ndjehen të zhgënjyer me pritshmëritë e tyre. Një sondazh i kohëve të fundit i kryer me të rinjtë shqiptarë konstatoi se 79% e studentëve dhe atyre me diplomë të shkollës së mesme dëshironin të migronin jashtë vendit, ndërsa 95% e të rinjve shqiptarë që aktualisht studiojnë jashtë vendit



tregojnë se nuk dëshirojnë të kthehen në atdhe pas studimeve.²⁶ Studimi i CESS citon faktorët socio-ekonomikë si nxitësit kryesorë të dëshirës së të rinjve për të migruar jashtë vendit. Këta të rinj me arsim të lartë mund të ndjehen të zhgënjyer kur nuk gjejnë punë që i përshtatet kualifikimeve të tyre. Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm të veprimtarisë ekstremiste të dhunshme mes të rinjve. Të rinjtë me më shumë nivel arsimor ka të ngjarë të mendojnë se meritojnë fryte më të mira në jetë nga çfarë mund t'u ofrojë shoqëria ku bëjnë pjesë. Përgjithësisht, ata nuk sigurojnë dot vende pune që mendojnë se i meritojnë dhe/ose pranojnë që nepotizmi pengon sigurimin e vendeve të tilla të punës.

Pohimet në këtë nxitës:

- Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune
- Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme

Pohimi: Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune

57.9% e të anketuarve besojnë se në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune, ndërkohë që 38.5% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord me këtë pohim. Në krahasim me vitin 2018, kur 24.1% ishin dakord, ka një rritje prej 33.8 p.p. në numrin e atyre që janë dakord se qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banojnë kanë siguruar vende të mira pune.


Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha mes grupeve gjinore dhe demografike. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (62%) janë më shpesh dakord me këtë pohim, ndërkohë që të anketuarit e grupmoshës 55-64 vjeç (52%), ata me arsim deri 8/9 vjeçar (52%), dhe të anketuarit e papunë (53%) prireshin më pak të ishin dakord me këtë pohim. Për më tepër, shumica e të anketuarve nga Roskoveci, Rrësheni, Selenica, Rrogozhina, Patosi, Saranda, Kurbini, Lushnja, Tropoja, dhe Mati nuk ishin dakord me këtë pohim, që do të thotë se nuk ishin dakord që qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banojnë kanë siguruar vende të mira pune.



26 Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale - CESS. (2019). Migrimi aktual dhe i mundshëm i studentëve nga Shqipëria. Një rrjedhje e supozuar e trurit? Gjetet në adresën: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17258.pdf>



Figura 15: Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune (N=1600)




Pohimi: Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme

Të anketuarve iu kërkua të thonin sa dakord ishin me pohimi duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). Pjesa më e madhe (63.5% e të anketuarve) ishin dakord me pohimin, ndërsa 30.9% thanë të kundërtën. Ndërkohë 9% e të anketuarve e konsiderojnë pohimin si pa lidhje dhe 4.8% nuk dinin nëse duhet të ishin dakord apo jo. Krahasuar me vitin 2018, ku 61.7% ishin dakord, ka një rritje prej 1.8 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord me pohimin.

Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (71%) janë më të prirur të bien dakord me pohimin. Të anketuarit nga Fieri, Durrësi, Kamza, Kruja, Patosi, Roskoveci, Rrësheni, Rogozhina, dhe Kurbini kishin më pak gjasa të ishin dakord. Të intervistuarit me diplomë pasuniversitare (55%) janë më pak të prirur të bien dakord me pohimi se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme.

Figura 16: Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme (N=1599)



Shumë të rinj shqiptarë po mendojnë të ikin jashtë vendit për mundësi më të mira social-ekonomike. Veçanërisht ata të mirë-arsimuar kanë më shumë gjasa të mendojnë se meritojnë fryte më të mira në jetë nga çfarë mund t'u ofrojë shoqëria ku bëjnë pjesë. Ndonëse shumica e shqiptarëve tregojnë se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë është puna e tyre e ndershme dhe se në përgjithësi njerëzit e arsimit mirë në zonën ku jetojnë kanë vende të mira pune, pothuajse 1 në 3 shqiptarë konfirmojnë se arsimit nuk i ka ndihmuar njerëzit në zonën e tyre të gjejnë punë të mirë dhe po kjo përqindje e të anketuarve thonë se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku ata jetojnë është puna e paligjshme.

Edhe nivelet e ulëta të pakënaqësisë, të krijuara si rezultat i pritshmërive vazhdimisht të parealizuara dhe i perspektivave të zymta ekonomike, janë faktor i rëndësishëm tërheqës për grupet e dhunshme ekstremiste. Arsyeja pse njerëzit mund të tërhiqen drejt këtyre grupeve është se mendojnë se meritojnë më shumë nga sa kanë për sa i përket arsimit dhe punësimit. Kjo bën që shumë njerëz, veçanërisht ata të brezit të ri, të jenë në kërkim të lidhjeve shoqërore që do t'i ndihmojnë të realizojnë pritshmëritë që kanë ose t'u japin një qëllim të ri në jetë.

5. Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike

Në shumë zona periferike dhe të pazhvilluara, shumë njerëz varen nga ndihma dhe asistencë ekonomike që jepen nga shteti. Prandaj, ka rëndësi të madhe që institucionet shtetërore të punojnë në mënyrë profesionale me individët dhe familjet në nevojë, jo thjesht për shkak të varfërisë, por edhe për shkak të ndjenjave akute të neglizhimit dhe përjashtimit që nxisin radikalizmin, ekstremizmin dhe sjelljen e dhunshme. Në vendet në zhvillim si Shqipëria, sektori i shoqërisë civile hyn në partneritet me shtetin për të ofruar ndihmë, asistencë dhe trajnime për njerëzit në nevojë. Përveç fondacioneve të huaja humanitare dhe organizatave joqeveritare (OJQ), në vend kanë qenë aktive edhe organizatat e huaja fetare, duke ofruar ndihma materiale, shërbime shëndetësore, arsim dhe këshillim shpirtëror për shumë qytetarë të tillë. Por ndonjëherë, veçanërisht në vitet 1990, organizatat humanitare fetare kanë shërbyer si mbulesë për ekstremistët e huaj fetarë për përhapjen e mesazheve të tyre dhe për ta kthyer Shqipërinë në një bazë operative për aktivitetet e tyre në vende të tjera. Ato patën ndikim të madh në zonat e varfra periferike dhe rekrutuan shumë pasues, kryesisht djem të rinj, të cilët filluan të praktikonin rite që ishin të panjohura për Islamin tradicional shqiptar deri në atë kohë. Me zbulimin e lidhjeve mes terrorizmit ndërkombëtar dhe disa prej këtyre organizatave "bamirose", këto të fundit u detyruan të mbyllnin aktivitetin e tyre në Shqipëri.²⁷

Niveli i lartë i varfërisë dhe papunësisë në zonat periferike dhe të privuara, si dhe shërbimet e dobëta sociale i ekspozojnë komunitetet vendore ndaj aktiviteteve të grupeve që kanë programe radikale apo ekstremiste. Mospërbushja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm. Për të kuptuar më mirë këtë dukuri, të intervistuarve iu parashtruan pohimet e mëposhtme



27 Balkan Investigative Reporting Network. (2014). Zanafilla e islamit radikal në Shqipëri. Reporter.al, gjendet në adresën: <https://www.reporter.al/zanafilla-e-islamit-radikal-ne-shqiperi/>

Pohimet në këtë nxitës:


- Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime.
- Në zonën ku banoj ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës.
- Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.

Pohimi: Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin, duke përdorur shkallën nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). 35.4% e të anketuarve janë dakord se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime, ndërsa më shumë se gjysma e të anketuarve (58.6%) nuk janë dakord ose aspak dakord me pohimin. Kur krahasohet me vitin 2018, ku 25.8% ishin dakord me këtë pohim, ka një rritje prej 9.6 p.p. në numrin e të anketuarve se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime në zonën ku banojnë. 9% e të anketuarve e konsideronin pohimin si pa lidhje dhe 5.1% nuk dinin nëse ishin dakord ose jo dakord.

Shumica e të anketuarve të grupmoshës mbi 65 vjeç (43%) dhe të anketuarit pa arsim ose me shumë pak vite arsim (40%) prirën më shumë të bien dakord se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime në zonën ku banojnë. Të anketuarit që jetojnë në Cërrik, Rrogozhinë, Belsh, Vlorë, Maliq, Gjirokastër, dhe Kamzë ishin më pak të prirur të ishin dakord se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime, ndërsa asnjë nga të anketuarit nga Kurbini, Libohova, Memaliaj dhe Rrëshen nuk ishin dakord me këtë pohim.

Figura 17: Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime (N=1598)




Pohimi: Në zonën ku banoj ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës

Kur u pyetën nëse ishin dakord apo jo me pohimin, shumica dërrmuese e të anketuarve (83.8%) ishin dakord se në zonën e tyre ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës, ndërkohë që 13.7% e të anketuarve nuk ishin dakord ose aspak dakord me këtë pohim. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 85.6% e të intervistuarve, numri i atyre që besojnë se në zonën e tyre ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës ka rënë me 1.8 p.p.

Të anketuarit me arsim universitar (77%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin në krahasim me të anketuarit që kanë përfunduar arsimin 8/9 vjeçar. Të gjithë të anketuarit që jetojnë në Dibër, Bulqizë, Librazhd, Mat, Peqin, Vorë, Prrenjas, Gramsh, Rrogozhinë, Sarandë, dhe Selenicë thanë se në zonën ku banojnë ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës. Nivel i lartë mbështetjeje për këtë pohim u vu re edhe në bashkitë Fier, Kurbin, Maliq, Divjakë, Vau i Dejës dhe Cërrik.

Figura 18: Në zonën ku banoj ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës (N=1597)




Pohimi: Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (53.5%) janë dakord se në komunitetin e tyre ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre, ku 19.3% janë plotësisht dakord. Nga ana tjetër, 25.6% nuk janë dakord me këtë pohim dhe 20.0% ishin të pavendosur për të përcaktuar nëse ishin dakord apo jo. Vetëm 9% e të anketuarve e shohin këtë pohim si pa lidhje. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, kur 30.7% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, kemi një rritje të konsiderueshme prej 22.8 p.p. në numrin e të anketuarve që thonë se në zonën e tyre ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.

Të anketuarit në grupmoshën 25 deri 34 vjeç (57%), të anketuarit katolikë (59%) dhe myslimanë (57%) kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin. Sa më shpesh që praktikon fenë i/e anketuari, aq më i/e prirur është të jetë dakord me pohimin (69% e atyre që praktikojnë të gjitha ritualet fetare dhe 69% e atyre që luten/falen rregullisht). Të anketuarit që banojnë në Durrës, Fier, Dibër, Shkodër, Kurbin dhe Shijak ka më shumë të ngjarë të bien dakord se në zonën e tyre ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike besimtarëve që praktikojnë fenë. Mbështetje e lartë për këtë pohim u evidentua edhe në Dropull, Libohovë, Mallakastër dhe Rrogozhinë, ndonëse numri i të anketuarve në këto bashki ishte tejet i ulët.

Figura 19: Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre (N=1591)



Shumica dërrmuese e të anketuarve konfirmojnë se në zonat ku jetojnë, ka shumë familje ose individë që nuk plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës, gjë që pritej po të kemi parasysh ndikimin ekonomik të tërmetit dhe pandemisë. Megjithatë, ky nuk është tregues që njerëzit të jenë më të ndjeshëm ndaj ekstremizmit të dhunshëm më shumë se të tjerët, pasi varfëria nuk ndërliket me prirjen drejt ekstremizmit. Gjithsesi, pamundësia për të siguruar financiarisht jetesën mund ta bëjë dikë të cenusshëm ndaj grupeve të ekstremizmit të dhunshëm - qofshin ato politike, nacionaliste apo fetare - duke krijuar varësi ndaj përfitimeve materiale ose ekonomike që ofrojnë këto grupe. Përqindja e të anketuarve që tregojnë se ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre në zonën ku jetojnë është rritur ndjeshëm që nga viti 2018, ku Durrësi, Fieri, Dibra, Shkodra, Kurbin dhe Shijaku kanë përqindjen më të madhe të rasteve të raportuara. Ndonëse kjo mund të shpjegohet nga drejtuesit dhe klerikët fetarë që vizitojnë zonat e prekura nga tërmeti dhe që ofrojnë mbështetjen e tyre, është me rëndësi që të shmanget varësia afatgjate nga kjo ndihmë me të mira materiale apo ekonomike.

Pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk mendojnë se në zonën ku jetojnë institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike veprojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime. Komunitetet dhe individët bëhen veçanërisht të cenusshëm ndaj propagandës së ekstremizmit të dhunshëm kur nevojat e papërbushura financiare ndërthuren me trajtimin e pakënaqshëm të qytetarëve nga institucionet e qeverisjes vendore. Në Divjakë, Durrës, Fier, Kamzë, Kurbin, Lushnjë, Memaliaj, Rrëshen, Rrogozhinë, dhe Vlorë më shumë se 85% e njerëzve thonë se shumë familje nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës dhe mbi 75% thonë



se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime e me drejtësi, gjë që mund të bëjë që njerëzit në këto bashki të ndjehen të braktisur nga shteti dhe shoqëria.

6. Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike

Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura në rrugë të lehta. Rrjetet që ushtrojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të fshehur sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm

Edhe pse ekstremizmi dhe terrorizmi i dhunshëm klasifikohen si krime të orientuara politikisht, ato janë të lidhura ngushtë edhe me aktivitete të tjera të paligjshme që kanë synime ekonomike. Organizatat terroriste angazhohen në veprimtari të paligjshme ekonomike për të financuar aktivitetet e tyre. Ato blejnë armë, dokumente false dhe materiale të tjera logjistike nga trafikantë si dhe pastrojnë paratë nëpërmjet kanaleve që përdoren edhe nga krimi i organizuar. Siç u tha edhe në nxitësin “Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike”, disa organizata bamirëse islamike në Ballkan kanë vepruar në të kaluarën si organizata të fshehta për aktivitete terroriste, duke u siguruar terroristëve dokumente të rreme të prodhuara në tregun e zi dhe duke financuar përmes transfertave bankare udhëtimet e tyre në rajon.²⁸ Për të shqyrtuar nëse mjedisi në Shqipëri ofron hapësirë për lidhjen e veprimtarisë kriminale me ekstremizmin e dhunshëm, në këtë studim të anketuarit e sondazhit u pyetën se sa të gatshëm do të ishin të merreshin me veprimtari të paligjshme për të siguruar bukën e gojës.

Pohimet në këtë nxitës:

- Disa punë / përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja.
- Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe i paligjshëm.
- Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet.

Pohimi: Disa punë / përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja.

38.8% e të anketuarve thanë se do ta refuzonin një punë të ligjshme ose përfitim ekonomik të ligjshëm nëse ndalohen nga feja e tyre. Pothuajse gjysma e të anketuarve (48%) nuk ishin dakord me këtë pohim. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, kur 33.1% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka një rritje me 5.7% të të anketuarve që do të refuzonin një punë apo përfitim ekonomik të ligjshëm nëse do të binte ndesh me fenë e tyre.




28 Zoto, E. (2013) Failure and Success of the Jihadi Information Operations on the Internet. Tezë për gradën master. Monterey (CA): Naval Postgraduate School.



Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, të anketuarit më pak të arsimuar (52% e atyre që kanë arsim deri 8/9 vjeçar) ishin më shumë të prirur ta miratonin këtë pohim përkundër atyre që kanë nivel më të lartë arsimor (25% e të anketuarve me diplomë pasuniversitare). Studentët (30%) ishin më pak të prirur të mbështesnin këtë pohim, ndërsa të anketuarit katolikë (60%) dhe myslimanë (57%) kishin më shumë dëshirë ta miratonin një pohim të tillë. Sa më pak të praktikojë besimin një i anketuar, aq më pak i prirur është të bie dakord me këtë pohim: 57% e besimtarëve praktikantë (ata që luten/falen rregullisht dhe/ose praktikojnë të gjitha ritet e fesë së tyre) kishin më shumë mundësi të binin dakord me pohimin.

Figura 20: Disa punë/përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja (N=1597)



Pohimet:

1. Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikojta çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe i paligjshëm.


2. Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet

54.4% e të anketuarve janë dakord se pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet, ndërkohë që 39.4% nuk janë dakord dhe 6.1% janë të pasigurt apo e konsiderojnë këtë fjali si pa lidhje. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 53.6% ishin dakord me pohimin, ka një rritje të vogël prej 0.8 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord me pohimin. Ndonëse më shumë se gjysma e të anketuarve janë dakord se pasurimin e shpejtë e duan të gjithë, vetëm 31.6% e të anketuarve se do të justifikonin çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe i paligjshëm, për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, një rënie prej 4.6 p.p.

Nuk u vunë re dallime të mëdha sipas statusit të punësimit të të anketuarve në lidhje me përgjigjet për këto pyetje. Analiza e të dhënave demografike zbulon se shumica e të anketuarve që kanë më shumë gjasa të bien dakord për justifikimin e çdo lloj aktiviteti ekonomik, përfshirë edhe ato të paligjshme, për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (39%). Gjithsesi, shumica e të anketuarve me arsim pasuniversitar (72%) thanë se të gjithëve u pëlqen pasurimi i shpejtë, pavarësisht se si arrihet.



Figura 21: Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikojta çdo lloj aktiviteti ekonomik (N=1596) dhe Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë (N=1589)



Grupet e ekstremizmit të dhunshëm dhe ato të krimit të organizuar shpesh përdorin të njëjtat rrjete për të realizuar aktivitetet e tyre të paligjshme. Kur një popullatë është me e hapur ndaj aktiviteteve të paligjshme kriminale për të siguruar bukën e përditshme, kjo nënkupton se për grupet e ekstremizmit të dhunshëm krijohet më shumë hapësirë për ta shfrytëzuar këtë nevojë në interes të tyre. Ky studim konstaton se ndonëse më shumë se gjysma e shqiptarëve janë dakord se të gjithëve u pëlqen pasurimi i shpejtë, pavarësisht se si arrihet ai, vetëm 31.6% e të anketuarve tregojnë se do të justifikonin çdo veprimtari ekonomike, përfshirë edhe ato të paligjshme, për hir të mbijetesës së përditshme.

Është me interes të theksohet se gjysma e shqiptarëve nuk shohin fenë si pengesë kur vjen fjala për të pranuar një punë apo një përfitim ekonomik. Gjysma e shqiptarëve thonë se nuk do të refuzonin një punë të ligjshme që nuk u lejohet nga feja e tyre, ndërsa shumica e besimtarëve praktikantë thonë se do të refuzonin një punë të ligjshme për shkak të vlerave ose normave të tyre fetare. Sa më pak i arsimuar të jetë individi, aq më shumë është i prirur drejt sjelljes së motivuar nga lakmia, që është tregues i individëve dhe komuniteteve që janë të prirur të merren me veprimtari kriminale. Propaganda e ekstremizmit të dhunshëm mund të jetë veçanërisht tërheqëse për ta për shkak të premtimeve për punëve me fitim dhe zonave të përbashkëta të veprimit.

Përfundime për nxitësit social-ekonomikë

Në total u analizuan gjashtë nxitës të kategorisë së nxitësve politikë për ekstremizmin e dhunshëm, tre nga të cilët kanë lidhje specifike me kontekstin shqiptar: (1) Perceptimet për përjashtimin social dhe marginalizimin; (5) Nevojat e papërmbyshura sociale dhe ekonomike; dhe (6) Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike. Edhe pse ende me rëndësi, nxitësit (2) Rrjetet shoqërore dhe dinamika e grupeve; (3) Diskriminimi shoqëror; dhe (4) Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ duket se janë më pak shqetësues.

Privimi relativ, perceptimi i përjashtimit social, dhe diskriminimi i një grupi të caktuar mund të bëjë që të krijohen grupe me pikëpamje politike ekstremiste. Ky konstatim mbështetet nga rezultatet e tetë pohimeve në këtë kapitull, që është tregues i një mjedisi social-ekonomik në përkeqësim, ndërkohë që vetë situata është shqetësuese. Më shumë se 80% e shqiptarëve tregojnë se në zonën

ku jetojnë ka shumë familje ose individë që nuk plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës dhe se shumë të rinj kanë rënë pre e sjelljeve të rrezikshme. Kur këto nevoja të papërmbyshura financiare ndërthuren me trajtimin e pakënaqshëm të qytetarëve nga institucionet e qeverisjes vendore (të dyja këto po bëhen më të dukshme për shkak të ndikimit ekonomik të pandemisë), kjo mund të krijojë një ndjenjë pakënaqësie apo edhe braktisjeje nga shteti dhe shoqëria. Në bashkitë si Divjakë, Durrës, Fier, Kamzë, Kurbin, Lushnjë, Memaliaj, Rrëshen, Rogozhinë dhe Vlorë, shumica e njerëzve thonë se shumë familje nuk i plotësojnë dot nevojat bazë dhe se institucionet shtetërore në nivel vendor nuk veprojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime.

Edhe pse arsimit mirë nuk është gjithmonë garanci për të siguruar mundësi më të mira, ka një rritje të konsiderueshme të njerëzve që mendojnë se në përgjithësi, njerëzit e arsimuar mirë në zonën ku jetojnë kanë siguruar vende të mira pune. Ndërkohë që në vitin 2018 vetëm 24.1% e shqiptarëve thanë se njerëzit e arsimuar mirë në zonën ku ata jetojnë kanë siguruar vende të mira pune, sot 57.9% e shqiptarëve thonë të njëjtën gjë, që do të thotë se sipas perceptimit të publikut, arsimit i ndihmon të rinjtë të kenë rezultate më të mira në jetë. Pavarësisht përmirësimit të mundësive për njerëzit e mirë arsimuar, aktiviteti i paligjshëm ekonomik nuk shmanget nga një pjesë e popullsisë në Shqipëri. Sipas gjysmës së popullsisë - dhe madje 72% e njerëzve me diplomë pasuniversitare - të gjithëve u pëlqen pasurimi i shpejtë, pavarësisht se si arrihet ai. Një në tre shqiptarë - veçanërisht ata me nivel të ulët arsimor - është i gatshëm të përdorë mjete të paligjshme për të siguruar jetesën dhe një përqindje e ngjashme tregon se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku ata jetojnë nuk vjen puna e ndershme. Sa më pak i arsimuar të jetë individi, aq më shumë është i prirur drejt sjelljes së motivuar nga lakmia, që është tregues i individëve dhe komuniteteve që janë të prirur të merren me veprimtari kriminale. Propaganda e ekstremizmit të dhunshëm mund të jetë veçanërisht tërheqëse për ta për shkak të premtimeve për punëve me fitim dhe zonave të përbashkëta të veprimit. Në Fier, Durrës, Kamzë, Krujë, Patos, Skrapar, Roskovec, Rrëshen, Rogozhinë, Tepelenë dhe Kurbin, njerëzit kanë më shumë të ngjarë të thonë se burimi kryesor i të ardhurave tek të rinjtë nuk është përmes punës së ndershme. Kur një popullatë është me e hapur ndaj aktiviteteve të paligjshme kriminale për të siguruar bukën e përditshme, kjo nënkupton se për grupet e ekstremizmit të dhunshëm krijohet më shumë hapësirë për ta shfrytëzuar këtë nevojë në interes të tyre, veçanërisht sepse rrjetet që përfshihen në veprimtari të paligjshme ekonomike janë shpesh të njëjta me ato që përdoren nga grupet ekstremiste të dhunshme.

Ndonëse në vitet e fundit, ekstremizmi i dhunshëm fetar ka qenë shqetësim kryesor për Shqipërinë, studimi i vitit 2018 "Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri" (IDM, 2018), nxori në pah një potencial në rritje për llojet e tjera të ekstremizmit në Shqipëri. Në fakt, ky studim konfirmon se prania e individëve ose e grupeve aktivë që nxisin ekstremizmin politik (27.3%) raportohet më shpesh sesa prania e grupeve ekstremiste fetare (12.1%) apo e ekstremistëve nacionalistë (7.6%). Në Bulqizë, Rogozhinë dhe Kamzë pjesa më e madhe e njerëzve konfirmojnë praninë e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin politik, ndërsa për ekstremizmin fetar kjo ndodh vetëm në Rogozhinë dhe më pak në Kamzë, Durrës dhe Pogradec. Kjo duhet të shërbejë si sinjal për aktorët e P/LKEDH në vend dhe posaçërisht për bashkitë e sipërpërmendura se ekziston nevoja për të vijuar më tej me nismat P/LKEDH për të përfshirë edhe dhunën politike ose ekstremizmin e dhunshëm politik.

Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se ekstremizmi fetar është më pak shqetësues nga sa ishte në vitin 2018. Në fakt, përqindja e të anketuarve që thonë se ekzistojnë grupe fetare që ofrojnë të mira materiale apo përfitime ekonomike për besimtarët praktikantë është rritur me 23 pikë përqindje në krahasim me vitin 2018. Në Durrës, Fier, Dibër, Shkodër, Kurbin dhe Shijak, prania e grupeve fetare që ofrojnë përfitime ekonomike ose materiale për besimtarët praktikantë është më e madhe. Ndonëse shpërndarja e shpërblimeve ekonomike nuk është domosdoshmërisht tregues i grupeve që përhapin ideologji ekstremiste (të dhunshme) fetare, dukuria e ofrimit të të mirave ekonomike ose materiale njerëzve për të praktikuar një besim të caktuar fetar të kujton fillimin e viteve 1990,



kur organizatat bamirëse fetare të lidhura me rrjetet ekstremiste filluan të hynin në Shqipëri. Për të parandaluar funksionimin e organizatave bamirëse të lidhura me këto rrjete në Shqipëri, hap vendimtar në frenimin e ndikimit të këtyre grupeve është forcimi i mekanizmave të financimit të anti-terrorizmit dhe i pastrimit të parave.

Perceptimet për diskriminimin shoqëror ndaj një individi apo komuniteti (ose të dyjave) mund të jetë në një kuptim të gjerë nxitës i ekstremizmit të dhunshëm. Ndonëse diskriminimi shoqëror për shkak të përkatësisë fetare nuk është aq evident duke qenë se pjesa më e madhe e shqiptarëve janë tolerantë ndaj grupeve të tjera fetare, ka disa faktorë që bëjnë të nevojshëm vëmendjen e aktorëve përkatës. 1 në 4 bëjnë lidhjen e mjekrës së gjatë apo shamisë së mbulimit të kokës me ekstremizmin e dhunshëm, gjë që nxjerr në pah perceptimin e shtrembëruar për fenë. 38.8% e shqiptarëve do të refuzonin një punë apo përfitim ekonomik që nuk u lejohet nga feja e tyre. Të paktën 12% e shqiptarëve thonë se njerëzit me përkatësi të njëjtë fetare përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik e social për shkak të kësaj përkatësie. 38.1% thonë se komuniteti fetar tek i cili bëjnë pjesë nuk është mjaftueshëm i përfaqësuar në politikë. Me secilin nga këto pohime, të anketuarit me nivel të ulët arsimor janë më të prirur të bien dakord. Këto gjetje sugjerojnë se edhe pse ekstremizmi fetar nuk është aq shqetësues sa ekstremizmi politik, marginalizimi sistematik i një komuniteti fetar - edhe nëse është thjesht perceptim i të anketuarve - krijon pakënaqësi dhe prodhon një mjedis të huaj për besimtarët. Nga ana tjetër, ky komunitet mund të bëhet më i hapur ndaj ndikimit të interpretimeve jozyrtare fetare që nxisin urrejtje fetare ose madje mund t'i shtyjë ata drejt përfshirjes në aktivitete kriminale. Për këtë qëllim, është me rëndësi që aktorët kryesorë të P/LKEDH, institucionet arsimore dhe ato fetare të rrisin përpjekjet e tyre për trajtimin e shkaqeve bazë dhe efekteve të stereotipeve, paragjyqimeve dhe diskriminimit shoqëror me motiv fetar. Po ashtu, është po aq e rëndësishme të vazhdohet me promovimin e tolerancës fetare dhe nxitjen e dialogut ndërfaqësor, jo vetëm në nivel qendror por edhe në komunitete dhe të punohet me qytetarët më pak të arsimuar dhe më pak të angazhuar.



5.2. Nxitësit politikë

Pjesa më e madhe e nxitësve politikë të EDH që lidhen me gjendjen e demokracisë, qeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor në vend. Për këta nxitës, nuk është vetëm gjendja e demokracisë, qeverisjes, dhe shtetit ligjor, por është edhe perceptimi i qytetarëve që ndikon në pakënaqësinë e njerëzve me shtetin dhe institucionet e tij. Në rastin e Shqipërisë, kjo vlen për nxitësit “mohimi i të drejtave politike dhe liritë civile”, “Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut”, “korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta” dhe “Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët”. Nxitësit “Pushtimi i huaj” dhe “Dhunimi politik dhe/ose ushtarak” nuk përshkruajnë realitetin apo kontekstin aktual në Shqipëri, ndonëse mbetet e rëndësishme të shqyrtohet nëse grupe të caktuara qytetarësh i perceptojnë këta nxitës si të rëndësishëm, për shembull për komunitetin e tyre ose kontekstin lokal.

Nxitësi “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë” lidhet më së shumti me perceptimet dhe qëndrimet ndaj Perëndimit dhe sistemit ndërkombëtar në përgjithësi. Nxitësit politikë vlerësohen në këtë studim nëpërmjet prizmit të fenomenit të luftëtarëve të huaj në Siri dhe Irak dhe qëndrimeve të besimtarëve fetarë ndaj vlerave dhe dinjitetit fetar, por edhe lloje të tjera të ekstremizmit të dhunshëm, si ekstremizmi politik dhe nacionalist (Tabela 3).

Tabela 3: Nxitësit politikë sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018

1	Mohimi i të drejtave politike dhe liritë civile	Mungesa e të drejtave politike dhe liritë civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të nxisin besimin se dhuna është mjeti i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë qytetare e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
2	Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individi në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë nxitja drejt veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.
3	Pushtimi i huaj	Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin që u është bërë atyre personalisht ose komunitetit të tyre.
4	Dhunimi politik dhe/ose ushtarak	Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.



5	Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta	Ky nxitës shkakton të paktën pasivitet qytetar e apati politike dhe mund të ushqejë një ndjesi të madhe të dhunës morale. Sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e ekstremizmit të dhunshëm të shpallin veten si alternativa e drejtë dhe t'i sulen elitave të pamoralshme qeverisëse.
6	Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët	Këto zona janë të izoluar, rajone me dendësi të ulët popullore që përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria.
7	Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm	Aty ku qeveritë nuk mund t'u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të siguruar me anë të forcës mbështetje për lëvizjen e tyre.
8	Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë	Popullsia mund të pranojë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi botëror politik dhe ekonomik diskriminojnë botën myslimane, gjë që mund të ngatërrohet me ndjenjat personale ose komunitare të diskriminimit

Lista e raportuar në Tabelën 3 nuk është shteruese. Nxitësit politikë nuk veprojnë të izoluar nga njëri-tjetri apo nga nxitës të tjerë brenda kategorive kulturore dhe social-ekonomike. Gjithsesi, Denooux dhe Carter (2009) argumentojnë se këta nxitës politikë shpesh sigurojnë mjedisin mundësues për ekstremizmin e dhunshëm:

“Një apo disa nga këta nxitës politikë mund të ndërthuren ngushtësisht me disa nga nxitësit socialë dhe ekonomikë që u trajtuan më sipër. Për shembull, korrupsioni mund të dobësojë gradualisht kapacitetin e shtetit duke dëmtuar aftësinë e qeverisë për t'u përballur me përjashtimin social, i cili, siç u diskutua edhe më sipër, shpesh nxit ekstremizmin e dhunshëm.”²⁹

Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë mjedisin e gjerë politik duke analizuar ndikimin e nxitësve në këtë kategori si dhe ndërveprimin e tyre me nxitësit e tjerë dhe faktorët kontekstualë që përcaktojnë realitetin shqiptar dhe përpjekjet e vendit për të konsoliduar shtetin ligjor. Vlerësimi i demokracisë në Shqipëri nuk ka ndryshuar krahasuar me atë të vitit 2018 të nxitësve, formave dhe rrethimeve të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Përkundrazi, Freedom House nxori në pah një rënie si për respektimin e të drejtave politike ashtu edhe të lirive civile gjatë periudhës 2018-2020. Shqipëria konsiderohet ende “pjesërisht e lirë”, duke shënuar 27 nga 40 pikë për respektimin e të drejtave politike dhe 39 nga 60 pikë për liritë civile.³⁰

• • •

29 Denooux, G. and Carter, L. (2009). Guide to the drivers of violent extremism. USAID. p. 27. Gjetet në adresën: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf

30 Freedom House. (2021). Freedom of the World 2021 report for Albania. Gjetet në adresën: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021>

Për më tepër, vlerësimi i përgjithshëm i demokracisë në vend ka rënë nga 48.21 në 47.02 (nga 100 të mundshme) për të njëjtën periudhë, për shkak të rënies së vlerësimit të Procesit Zgjedhor dhe të Qeverisjes Kombëtare Demokratike që mat karakterin demokratik të sistemit të qeverisjes dhe pavarësinë, efektivitetin dhe llogaridhënieën e pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv.³¹ Qytetarët shqiptarë kanë të njëjtin mendim: shumica e popullsisë në Shqipëri e konsideron qeverinë si jo transparente apo të përgjegjshme; besimi tek institucionet në vend është i ulët; korrupsioni i vogël dhe i madh konsiderohen si mjaft të përhapur; dhe shumica e shqiptarëve mendojnë se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike.³²

Mungesa e rezultateve të prekshme në përpjekjet e Shqipërisë për të përmirësuar qeverisjen demokratike dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës bëri që BE të bllokojë tre herë hapjen e negociatave të anëtarësimit gjatë periudhës 2016-2020. Pas marrjes së dritës jeshile në mars 2020 për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit, vendi tani shpreson të nisë zyrtarisht procesin e anëtarësimit në BE, me kusht që të përmbushë 15 kushtet e përcaktuara, përfshirë miratimin e një reforme zgjedhore, të vazhdojë me zbatimin e reformës në drejtësi, të sigurojë funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë dhe të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar.³³

Prandaj, gjetjet e këtij studimi për ndikimin e nxitësve politikë në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm nuk përbëjnë surprizë duke pasur parasysh përparimin e Shqipërisë me një ritëm tejet të ngadaltë drejt konsolidimit të shtetit ligjor, vonesat në zbatimin e reformës në gjyqësor, mungesën e dëshmimeve të qëndrueshme për ndëshkimin me sukses të korrupsionit të nivelit të lartë dhe, së fundmi, por jo më pak të rëndësishme, tendencën e vazhdueshme të mosbesimit të publikut tek institucionet. Në pjesën e mëposhtme të këtij seksioni shtjellohen gjetjet për secilin prej nxitësve politikë bazuar në sondazhin me përfaqësim kombëtar.

I. Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile

Mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të nxisin besimin se dhuna është mjete i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë qytetare e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Pohimet në këtë nxitës:

- Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore.
- Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.



31 Vurmo, G. (2021). Nations in Transit 2020 report for Albania. Freedom House. Gjetet në adresën: <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2020>

32 Vrugtman, L. dhe Dauti, M. (2021). Besimi në qeverisje 2020. Sondazhi i opinionit publik. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Gjetet në adresën: <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>

33 Shih Konkluzionin e Këshillit Evropian të 24 marsit 2020 për zgjerimin dhe stabilizimin dhe procesin e asociimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë. Gjetet në adresën: <https://Data.Consilium.Europa.Eu/Doc/Document/St-7002-2020-Init/en/pdf>




Pohimi: Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me 4 pikë nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). Pothuajse gjysma e të anketuarve (48.9%) janë dakord me këtë pohim, ndërsa 49.3% thanë se nuk ishin dakord me pohimin. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha për nga gjinia, mosha, statusi i punësimit, apo vendndodhjes gjeografike (urban/rural). Të anketuarit me arsim pasuniversitar (57%) ishin më të prirur të binin dakord me pohimin. Besimtarët praktikantë, pra ata të anketuar që falen/luten rregullisht dhe/ose praktikojnë të gjitha ritualet fetare, ishin më pak të prirur të binin dakord se të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore (44% për të dy grupet).

Në sondazhin e vitit 2018, pyetja u bë paksa ndryshe: “Në përgjithësi, të drejtat e qytetarëve dhe liritë civile respektohen nga institucionet shtetërore”. E përshtatëm ‘liritë civile’ në ‘liritë e qytetarëve’ për ta bërë pyetjen më të thjeshtë për t’u kuptuar nga të anketuarit. Atë vit, 35.7% e të anketuarve ishin dakord me pohimin; që do të thotë se kishte një rritje prej 13.2 p.p. në mbështetjen për këtë pohim për periudhën 2018-2021.

Figura 22: Të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore (N=1599)



Pohimi: Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.


44.1% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa më shumë se gjysma e të intervistuarve (51.8%) e kundërshtojnë këtë pohim. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 47.7% ishin disi ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rënie prej 3.6 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord me pohimin se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë. Të anketuarit në grupmoshën 18-24 vjeç (53%), me arsim deri atë fillor (50%), apo studentë (55%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit e grupmoshës

mbi 65 vjeç (40%), ata me arsim pasuniversitar (40%), apo ata nga zonat rurale (38%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Njerëzit që praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (37%) apo që luten/falen rregullisht (37%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja, ndërsa të anketuarit që nuk praktikojnë besimin fetar (53%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord.

Figura 23: Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja (N=1600)



Sistemet e papërgjegjshme politike apo mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile mund të nxisë besimin te qytetarët se dhuna është mjete i vetëm për ndryshimin politik. Ky studim tregon se gjysma e shqiptarëve nuk mendojnë se përgjithësisht të drejtat dhe liritë e qytetarëve respektohen nga institucionet shtetërore dhe se 44% e shqiptarëve besojnë se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet të ndryshohet edhe me dhunë nëse është e nevojshme. Faktikisht, përgjigjet për këto pohime janë pak më shumë pozitive sesa në vitin 2018. Gjithsesi, 18.9% e shqiptarëve do t'i mbështesnin plotësisht mjetet e dhunshme për të arritur ndryshimin politik. Ashtu si me sondazhin e vitit 2018, nuk vihet re asnjë motiv fetar për këto perceptime: asnjë nga grupet fetare nuk ka shumë pikë për të dy pohimet. Në fakt, shqiptarët që luten/falen rregullisht apo që praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre priren të jenë dakord se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja në krahasim me ata që nuk praktikojnë aktivisht ritualet e fesë së tyre.

Duke pasur parasysh se në të njëjtën kohë, 42% e shqiptarëve deklarojnë se janë të shqetësuar për ekstremizmin politik, i cili është më i përhapur se çdo lloj tjetër ekstremizmi (shih pjesën për nxitësit kulturorë), dhe 27% e shqiptarëve konfirmojnë praninë e individëve ose grupeve ekstremiste politike në zonën ku jetojnë (shih nxitësit socio-ekonomikë), perceptimi mes qytetarëve se ka mungesë të të drejtave politike dhe lirive civile nuk duhet të merret lehtë. Nëse disa shqiptarë janë të gatshëm të përdorin dhunën për të sjellë ndryshime politike, këta njerëz mund të jenë më të prirur edhe ndaj propagandës ekstremiste të dhunshme politike.



2. Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut

Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individi në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë nxitja drejt veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.

Pohimet në këtë nxitës:

- Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë.
- Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.

Pohimi: Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë.


Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 22.7% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa shumica e të intervistuarve (59.5%) nuk janë dakord ose aspak dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 13.2% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 9.5 p.p. në numrin e të anketuarve që mentojnë se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, statusit të punësimit apo vendbanimit (urban/rural). Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (33%), të anketuarit me arsim fillor (29%) apo ata me arsim deri në nivel fillor (30%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërkohë që të anketuarit me arsim universitar (19%) apo pasuniversitar ishin më pak të prirur (12%) për të rënë dakord me pohimin.

1 në 4 të intervistuar që identifikohet si mysliman apo që vjen nga familje myslimane janë dakord se institucionet ligjzbatuese janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë, që është edhe mesatarja në rang kombëtar.

Besimtarët praktikantë – të anketuarit që luten/falen rregullisht (18%) dhe/ose praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (19%) – bien më pak dakord me pohimi se ata që nuk praktikojnë apo jo-besimtarët.

Figura 24: Institucionet ligjzbatuese janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë (N=1599)




Pohimi: Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 35.1% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërkohë që 59.2% e të intervistuarve nuk ishin dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 35.8% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, nuk ka dallime të mëdha në numrin e të anketuarve që besojnë se njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo statusit të punësimit. Të anketuarit me nivel më të ulët arsimor ishin më shumë të prirur për të rënë dakord (30% dhe 29%), ndërsa të anketuarit në grupmoshën 35-44 vjeç (29%), ata me diplomë pasuniversitare (25%), apo të anketuarit që banojnë në zonat rurale (28%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin. Të anketuarit që luten/falen rregullisht (29%) praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (29%) janë më pak dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit që falen/luten me raste dhe besimtarët që praktikojnë jo të gjitha ritet fetare ishin më shumë të prirur për të rënë dakord.

Figura 25: Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore (N=1596)



Pavarësisht problemeve me shtetin ligjor në Shqipëri, nuk ka raste të shtypjes së pamëshirshme nga qeveria dhe shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut. Megjithatë, duke qenë se pothuajse çdo shqiptar ka një anëtar familjeje apo të afërm që banon në një vend perëndimor (Evropë, ShBA), shqiptarët i hedhin sytë nga standardet e demokracive perëndimore. Sipas rezultateve të sondazhit, pothuajse 1 në 5 shqiptarë mendojnë se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpër me besimtarët praktikantë myslimanë. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, ka një rritje prej rreth 10 p.p.

Edhe pse besimtarët myslimanë në thelb nuk janë dakord me pohimin, 1 në 4 prej tyre mendon se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpër me besimtarët praktikantë myslimanë. Ky perceptim nuk duhet të nënvlerësohet, sepse trajtimi i padrejtë në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të përdoret si propagandë nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm. Duke pasur parasysh se drejtësia është një vlerë tejet e rëndësishme në fenë islame, propaganda ekstremiste e dhunshme fetare mund të pretendojë se myslimanët në Shqipëri trajtohen në mënyrë të pabarabartë dhe se ky grup mund të ofrojë



një ndryshim nga një mjedis i tillë ose të sugjerojë se ka nevojë për hakmarrje. Opsioni i fundit duhet të jetë vërtetë shqetësues, sepse edhe pse përqindja e shqiptarëve që janë plotësisht dakord me pohimin “Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore” ka rënë nga viti 2018 në 2021, përqindja e atyre që janë dakord me këtë pohim është ende në nivelin 35.1%. Besimtarët praktikantë tregojnë më pak mbështetje për të dy pohimet në këtë nxitës.

3. Pushtimi i huaj

Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin që u është bërë atyre personalisht ose komunitetit të tyre. Edhe pse ky nxitës nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me situatën në Shqipëri, përfshirja e këtyre pyetjeve – dhe më gjerësisht të dy nxitësve “pushtimi i huaj” dhe “dhunimi politik/ushtarak” – na ndihmon të vlerësojmë mbështetjen e qytetarëve për ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2014, ndryshime që kriminalizuan veprat e pjesëmarrjes, financimit, dhe rekrutimit për konfliktet e armatosura jashtë kufijve të vendit.

Pohimet në këtë nxitës:

- Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura duhet lejuar
- Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët

Pohimi: Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura duhet lejuar

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4)³⁴. 16.3% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërkohë një shumicë e konsiderueshme, 76%, nuk ishin dakord ose aspak dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 21.0% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rënie prej 4.6 p.p. në numrin e të anketuarve që besojnë se përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura duhet lejuar.


Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, arsimit, statusit të punësimit, apo vendbanimit.



34 Pohimi në fakt është formuluar “Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar.” Megjithatë, për të lehtësuar krahasimin mes dy pohimeve në këtë nxitës, formulimi i fjalisë është bërë pozitiv dhe kategoritë e përgjigjeve janë kthyer në rendin e kundërt. Në sondazhin e vitit 2018, fjalia është formuluar siç jepet në sondazh.



Figura 26: 'Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura' (N=1599) & 'Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët' (N=1598)



Pohimi: Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët.

21.8% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 55.5% e të anketuarve ishin disi ose plotësisht dakord. 9.4% thanë se pohimi është pa lidhje dhe 13.1% nuk ishin të sigurt nëse duhet të ishin dakord ose jo dakord me pohimin. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 13.0% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 8.8 p.p. në numrin e të anketuarve që besojnë se përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, arsimit, statusit të punësimit, apo vendbanimit. Të anketuarit me nivel arsimor deri në atë fillor (38%) apo arsim fillor (27%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit me diplomë universitare (16%) apo studime pasuniversitare (19%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin.

Të anketuarit që janë besimtarë praktikantë ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët në krahasim me të anketuarit që janë më pak fetarë. Të intervistuarit që thanë se i praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (16%) dhe të anketuarit që luten/falen rregullisht (16%) janë më pak dakord me këtë pohim, ndërsa të anketuarit që luten/falen me raste, për festa të ndryshme fetare (31%) apo herë pas here, në kohë krizash familjare apo personale (33%) ishin më shumë dakord me pohimin.

Vendet nën pushtimin e huaj – edhe pse ky është veç pushtim i perceptuar sipas grupeve të caktuara – janë më të rrezikuar nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm që veprojnë në këto vende, nga kryengritjet dhe abuzimi me të drejtat e njeriut. Edhe pse pushtimi i huaj nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me situatën në Shqipëri, studimi tregon se ekziston një mbështetje për këtë nxitës te popullata shqiptare. Ndonëse shumica e shqiptarëve mendojnë se nxitja ose përfshirja në konflikte të armatosura jashtë duhet të jetë e paligjshme, siç është rasti në Shqipëri, 16.3% besojnë se nxitja ose përfshirja në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit duhet të lejohet. Kur krahasohet me vitin 2018, ky është një përmirësim i vogël.



Po ashtu, edhe pse pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk janë dakord se përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët, 21.8% ende ndjehen sikur kjo përfshirje të jetë fyerje për popujt myslimanë. Të anketuarit me regjim më të rreptë fetar ishin më pak të prirur për të rënë dakord në krahasim me njerëzit më pak fetarë. Fakti se ka një rritje prej 8.8 p.p. krahasuar me raportin e 2018 si dhe një rritje të mbështetjes për nxitësin “sistemi ndërkombëtar është përgjithësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë dhe popujt myslimanë” në të njëjtën periudhë sinjalizon se ka një rritje të perceptimit se popujt myslimanë trajtohen në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë me popujt dhe shoqëritë jo-muslimane.

4. Dhunimi politik/ushtarak

Në këtë nxitës vlerësojmë sa mundësi ka propaganda ekstremiste të gjenerojë mbështetje nëpërmjet nevojës së perceptuar për rikthimin e dinjitetit ose ideologjisë fetare në përgjithësi. Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.


Pohimet në këtë nxitës:

- Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim.
- Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht.

Pohimi: Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim

32.3% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa shumica, 60.3% e të anketuarve, nuk janë dakord. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, apo statusit të punësimit. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (43%) dhe të anketuarit që banojnë në zonat urbane (37%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord, ndërkohë që të anketuarit me arsim universitar (28%) apo arsim pasuniversitar (27%), dhe të anketuarit nga zonat rurale (26%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Figura 27: Detyra për të mbrojtur ideologjinë (N=1597) përkundër Detyrës për të mbrojtur fenë (N=1598)



Pohimi: Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht.

34.2% e të anketuarve janë disi ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 58.4% e kundërshtojnë atë. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, kur 40.6% e të anketuarve ishin dakord, ka një rënie prej 6.4 p.p. në numrin e të anketuarve që mendojnë se është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo vendbanimit. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor ishin më shumë të prirur për të rënë dakord (53%), ndërsa të anketuarit me arsim universitar (30%) apo pasuniversitar (22%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (40%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin 'është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht', ndërkohë që ata në grupmoshën 18-24 vjeç (28%) dhe studentët (21%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të intervistuarit që thonë se i praktikojnë të gjitha ritet fetare janë më shumë dakord (41%) sesa ata që nuk praktikojnë ritualet fetar (2%) apo që nuk luten/falen kurrë (15%).

Po të kemi parasysh se Shqipëria nuk vuan nga dhunimi i drejtpërdrejtë politik/ushtarak, nuk është për t'u habitur që shumica e shqiptarëve nuk japin mbështetje për këtë pohim në këtë nxitës. Madje, mbështetja për këtë nxitës ka rënë kur e krahasojmë me vitin 2018. Gjithsesi, rreth 1 në 3 shqiptarë janë dakord se është detyra e çdo qytetari të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim dhe detyra e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht. Për të dy pohimet, njerëzit me nivel të ulët arsimor ishin më shumë të prirur për të rënë dakord, ndërsa njerëzit me nivel të lartë arsimor ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Njerëzit që thonë se praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet fetare dhe luten/falen (qoftë rregullisht apo me raste) ishin më shumë dakord me pohimin. Kjo do të thotë se grupet e ekstremizmit të dhunshëm kanë disa mundësi për të fituar mbështetje nëse shohin nevojën e perceptuar për të mbrojtur dinjitetin e ideologjinë fetare në përgjithësi.

5. Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta

Ashtu si në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave politike dhe ekonomike me lidhje të forta kanë qenë sfida e përhershme në Shqipëri. Në vitin 2018, Strategjia e Komisionit Evropian për Zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor për herë të parë iu referua "elementëve të qartë të kapjes së shtetit" kur evidentonte sfidat me të cilat përballej shteti ligjor në vendet në rajon, përfshirë këtu edhe Shqipërinë.³⁵ Sipas Transparency International, besnikëria dhe përfitimet e ndërsjella bëjnë që zyrtarët të keqpërdorin postin për interesa private nëpërmjet ndikimit tek sistemi gjyqësor dhe hartimit të ligjeve me porosi. Ndërkohë, janë qytetarët ata që paguajnë për këtë kapje shteti, nëpërmjet humbjes së jetës,



35 Komisioni Evropian COM. (2018). A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans. p. 3. Gjetet në adresën: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf



shërbimeve të dobëta publike, kufizimit të mundësive dhe humbjes së besimit te demokracia.³⁶ Problemet e vazhdueshme me korrupsionin dhe krimin e organizuar bënë që të krijoheshin organe të posaçme anti-korrupsioni (SPAK dhe gjykata e anti-korrupsionit dhe krimin të organizuar) si pjesë e reformës në drejtësi.³⁷ Edhe pse këto institucione pritet të forcojnë edhe më shumë kapacitetin në përgjithësi të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, ato kanë filluar nga puna vetëm kohët e fundit, ndaj u mungojnë dëshmitë konkrete të hetimit dhe ndëshkimit të rasteve të nivelit të lartë.

Duke pasur parasysh këtë kontekst, realiteti i shkëputjes dhe i apatisë politike në Shqipëri nuk sjell çudira. Gjithsesi, ky realitet mund të nxisë një ndjenjë zemërate morale. Edhe pse në Shqipëri kjo nuk është aq e serioze në krahasim me vendet e goditura rëndë nga konfliktet, është me rëndësi të shqyrtohen angazhimi qytetar dhe pakënaqësia e mundshme me politikën dhe qeverisjen: sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e dhunshme të shpallen si alternativë e drejtë dhe të godasin elitat qeverisëse imorale.

Pohimet në këtë nxitës:

- Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara
- Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi

Pohimi: Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 38.3% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërkohë që 42.3% të anketuarve nuk janë dakord. 10.2% thanë se pohimi ishte pa lidhje 9.2% nuk dinë nëse duhet të jenë dakord apo jo me pohimin. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 31.4% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 6.9 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo vendbanimit. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (53%), me arsim deri në nivel fillor (55%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa studentët (31%) dhe të anketuarit me arsim të mesëm (31%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Të anketuarit që praktikojnë të gjithë ritualet fetare (55%) dhe që luten/falen rregullisht (55%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit që nuk praktikojnë rituale fetare (24%) apo që nuk luten/falen kurrë (23%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.




36 Zúñiga, N. (2020) Examining State Capture: Undue Influence on Law-Making and the Judiciary in the Western Balkans and Turkey. Transparency International. Gjetet në adresën: https://images.transparencycdn.org/images/2020_Report_ExaminingStateCapture_English.pdf

37 Komisioni Evropian COM. (2020). Raporti për Shqipërinë 2020. Gjetet në adresën: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf



Figura 28: 'besim i fortë, më pak korrupsion (N=1599) & 'Më shumë drejtësi nëse njerëzit besojnë fenë time' (N=1598)



Pohimi: Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi

38.0% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 34.4% e të anketuarve nuk janë dakord. Një në pesë të anketuar (19.6%) tha se për ta pohimi është pa lidhje. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 35.5% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 2.5 p.p. në numrin e të anketuarve që besojnë se në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi, nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë së tyre. Po ashtu, në 2018, 22.5% e të anketuarve thanë se për ta kjo fjali është pa lidhje.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo vendbanimit. Të anketuarit e grupmoshës 25-34 vjeç (43%) ata me arsim fillor (44%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa studentët (31%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Të anketuarit që praktikojnë të gjitha ritet fetare (46%) dhe ata që luten/falen rregullisht (47%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit që nuk praktikojnë asnjë rit fetar (20%) apo ata që nuk luten/falen kurrë (23%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Korrupsioni, kapja e shtetit dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta politike dhe ekonomike vazhdon të jetë një problem në Shqipëri. Ky nxitës analizon se sa pozitivisht ndikon besimi te qeverisja dhe drejtësia. Ndonëse një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve i konsideruan pohimet si pa lidhje për Shqipërinë, mbështetja e përgjithshme për pohimet në këtë nxitës është rreth 38%. Me fjalë të tjera, pothuajse 4 në 10 shqiptarë shohin një mundësi të feja për uljen e korrupsionit dhe të pandëshkueshmërisë. Për të dy pohimet, mbështetja është më e madhe se në vitin 2018, duke sinjalizuar një rritje të pandëshkueshmërisë së perceptuar dhe korrupsionit.

Duke pasur parasysh besimin e ulët te qeverisja në Shqipëri, ka potencial të vërtetë që qytetarët shqiptarë të bëhen apatikë ndaj politikës. Gjysma e shqiptarëve që janë besimtarë praktikantë (njerëz që luten/falen rregullisht dhe/ose praktikojnë të gjitha ritet fetare) janë dakord se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara dhe se në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi, nëse më shumë njerëz



do ishin besimtarë të fesë së tyre. Kjo do të thotë se grupet ekstremiste të dhunshme e kanë më të lehtë ta promovojnë veten si alternativë e drejtë përkundër elitave të perceptuara imorale ose të padrejta qeverisëse.

6. Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët

Zonat me dendësi të ulët popullsie dhe që përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria. Duhet të kuptohet se grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të tërhiqen drejt “shteteve me forcë të kufizuar”, në krahasim me shtetet e dështuara apo në dështim e sipër, ku mund të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar rrjetin e tyre dhe për të kryer operacionet e tyre. Ndonëse zonat e izoluara që janë të qeverisura dobët apo të paqeverisura nuk janë problem në Shqipëri, ky studim përpiket të vlerësojë rëndësinë dhe shtrirjen e “shtetit si ofrues shërbimi” dhe që ka në qendër qytetarin në perceptimet e shqiptarëve. Pohimet ndihmojnë të përcaktojmë rreziqet nga mesazhet e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm por edhe i hapësirës për grupet të tilla për të mbushur çdo boshllëk në ofrimin e shërbimeve publike cilësore në zona të caktuara. Përveç kësaj, studimi shqyrton praninë e shtetit në zonat rurale si dhe perceptimet e publikut për nevojën për të monitoruar aktivitetet fetare në Shqipëri

Pohimet në këtë nxitës:


- Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti
- Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët
- Prezenca e “shtetit” si ligjzbatues dhe ofrues i shërbimeve publike është më e ulët në fshat sesa në qytet.

Pohimi: Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 37.7% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa shumica, 56.0% e të anketuarve nuk janë dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 45.1% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rënie prej 7.4 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, statusit të punësimit, apo vendbanimit. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç ishin më pak të prirur (32%) të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit me arsim fillor (45%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord. Të intervistuarit që thonë se praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (43%) ose pjesën më të madhe të riteve fetare (42%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me pohimin sesa të anketuarit që nuk praktikojnë ritualet e fesë së tyre (25%) dhe të anketuarit që nuk luten/falen kurrë (22%).

Figura 29: Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti (N=1595)



Pohimi: Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët


64.2% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 30.1% nuk janë dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 70.2% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rënie prej 6 p.p. të mbështetjes për këtë pohim. Në mënyrë të veçantë, përqindja e të anketuarve që ishin plotësisht dakord me këtë pohim ra në mënyrë të ndjeshme, nga 44.8% në vitin 2018 në 29.7% në 2021 (-15.1 p.p.).

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, age, apo përkatësisë fetare. Studentët (73%) janë më shumë dakord me këtë pohim, ndërsa të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (58%) apo ata që banojnë në zonat rurale (58%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin. Të intervistuarit që thonë se i praktikojnë të gjitha ritet fetare të besimit të tyre (73%) apo që luten/falen rregullisht (73%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin.

Të anketuarit që banojnë në Cërrik, Elbasan, Kamzë, Kolonjë, Kurbin, Rrëshen, Rrogozhinë, dhe Skrapar ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. Shumë bashki që kishin pjesën më të madhe të të anketuarve që raportonin në 2018 se shteti vepronte më shumë si zbatues i ligjit në zonat ku jetojnë ata kanë përmirësim të ndjeshëm në 2021. Këto bashki janë Belshi, Dibra, Gramshi, Hasi, Kavaja, Klosi, Kukësi, Lezha, Librazhdi, Mati, Mirdita, Peqini, Prrenjasi, Tropoja, Ura Vajgurore, dhe Vau i Dejës.



Figura 30: ‘Shteti si zbatues i ligjit apo si ofrues shërbimi’ (N=1593) & ‘Prania e shtetit më pak në zonat rurale’ (N=1596)



Pohimi: Prezenca e “shtetit” si ligjzbatues dhe ofrues i shërbimeve publike është më e ulët në fshat sesa në qytet

72.2% e të anketuarve janë disi ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 20.7% nuk ishin dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 74.5% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, nuk ka rritje të konsiderueshme në mbështetje të këtij pohimi. Megjithatë, ka rënë ndjeshëm përqindja e të anketuarve që janë plotësisht dakord me këtë pohim, nga 54.2% në 2018 në 38.5% në 2021 (-15.7 p.p.).

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, age, statusit të punësimit, apo përkatësisë fetare. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (63%) apo ata që banojnë në zonat rurale (66%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin, ndërsa në 2018 njerëzit që banojnë në zonat rurale ishin më shumë të prirur për të rënë dakord. Të anketuarit që thonë se i praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (71%) apo që luten/falen rregullisht (81%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin.

Përhapja e nxitësit “Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët” në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm është e diskutueshme. Nga ana tjetër, është e vërtetë se organizata të dyshimta bamirëse kanë (keq) përdorur mungesën e shërbimeve publike në zonat e largëta për të shënjestruar të rinjtë dhe qytetarët që hasin vështirësi social-ekonomike. Kjo gjë u sinjalizua edhe nga disa prej të anketuarve të këtij studimi. Gjithsesi, ky shpërdorim nuk ka çuar në mbështetje të konsiderueshme për grupet (e dhunshme) ekstremiste në këto zona të izoluara në Shqipëri.

Në vitet e fundit, qeveria ka marrë masa për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike në zonat urbane dhe rurale. Në të njëjtën kohë, teksa shumë shqiptarë kanë parasysh standardin e shërbimeve që ofrohen në vendet e tjera të Evropës, cilësia dhe jo thjesht ekzistenca e shërbimeve publike po merr përherë e më shumë rëndësi. Kjo e bën mjaft të kuptueshme se shumica e të anketuarve të bien dakord se shteti si autoritet për zbatimin e ligjit është më shumë i pranishëm se shteti si ofrues i shërbimeve publike për qytetarët dhe se një përqindje edhe më e madhe është dakord se prania e shtetit si zbatues i ligjit dhe

ofruet shërbimesh është me e vogël në zonat rurale se ato urbane. Kur krahasohet me vitin 2018, numri i të intervistuarve që janë plotësisht dakord me pohimet ka rënë ndjeshëm. Gjithashtu, të anketuarit që banojnë në zonat rurale janë më pak dakord se prania e shtetit është më e ulët në fshatra sesa në qytete. Kjo mund të thotë se përpjekjet e qeverisë shqiptare po japin rezultate.

Të intervistuarit që jetojnë në zonat rurale ishin më pak të prirur për të rënë dakord me të dy pohimet, megjithëse shumica prej tyre ishte dakord. Qytetarët që banojnë në Cërrik, Dropull, Elbasan, Gramsh, Këlcyrë, Kolonjë, Lezhë, Rrëshen, Rogozhinë, Skrapar, dhe Tropojë, ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se 'vërehej më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofruet i shërbimeve për qytetarë në zonat ku banojnë ata dhe në zonat rurale më në përgjithësi'. Duke qenë se besimtarët praktikantë të rregullt, pavarësisht përkatësisë së tyre politike, priren më shumë të jenë dakord me pohimet në këtë nxitës, mund të krijohet terren mundësues për grupet e ekstremizmit të dhunshëm që përdorin propagandën fetare për të mbështetur kauzën e tyre në zonat e qeverisura dobët.

7. Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm

Aty ku qeveritë nuk mund t'u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të siguruar me anë të forcës mbështetje për lëvizjen e tyre. Ndonëse nxitësi i frikësimit apo kërcënimit nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm nuk përshkruan realitetin shqiptar, format e fshehta të shtrëngimit ose edhe presioni i bashkëmoshatarëve që mund ta detyrojë një person të bashkohet ose të tolerojë ideologji radikale apo të ekstremizmit të dhunshëm. Siç u shqyrtua për kategoritë e nxitësve social-ekonomikë (nevoja të papërmbushura sociale dhe ekonomike), më shumë se gjysma e të intervistuarve të sondazhit ishin plotësisht dakord se në komunitetet e tyre ekzistojnë grupe fetare që ofrojnë përfitime dhe privilegje ekonomike për anëtarët e tyre që praktikojnë fenë, ku 19.3% prej tyre ishin plotësisht dakord.


Për të vlerësuar këtë nxitës në kontekstin shqiptar, në këtë sondazh u synua të sigurohej përvojë personale e të anketuarve për të evidentuar nëse ata kanë vënë re individë radikale që u bëjnë presion njerëzve për t'iu bashkuar kauzave të tyre dhe qëndrimin të besimtarëve ndaj ekstremistëve fetarë në komunitetin e tyre.

Pohimet në këtë nxitës:

- Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.
- Në zonën ku unë banoj ka individë ose grupime radikale që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin politik/fetar/nacionalist.


Pohimi: Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga "aspak dakord" (1) deri në "plotësisht dakord" (4). 14.7% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 77.6% e të anketuarve nuk janë dakord; që do të thotë se një besimtar i denjë duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 13.7% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, nuk kemi rritje të konsiderueshme (1 p.p.) të përqindjes së të anketuarve që mendojnë se një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.



Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, age, sektorit të punësimit, apo vendbanimit. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (25%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. Është me interes të theksohet se, ndërsa në sondazhin e vitit 2018 besimtarët praktikantë ishin më pak të predispozuar për të denoncuar anëtarët e komunitetit të tyre që kanë pikëpamje ekstremiste fetare, tani besimtarët praktikantë janë më të prirur për të bërë një gjë të tillë. Të anketuarit që luten/falen rregullisht (11%) apo që praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (11%) janë më pak dakord me pohimin sesa të anketuarit që luten/falen me raste.

Figura 31: Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare (N=1587)




Pohimi: Në zonën ku unë banoj ka individë ose grupime radikale që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t’iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin politik/fetar/nacionalist.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimet duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Për pohimin nëse në zonën ku banojnë ka individë ose grupime radikale që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t’iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin politik, 23.6% e të anketuarve janë dakord: 11.4% janë disi dakord dhe 12.2% plotësisht dakord, ndërsa shumica nuk janë dakord (63.1%) dhe 12.0% janë të pasigurt. Dallimet sipas gjinisë, arsimit, vendbanimit, apo përkatësisë fetare janë të papërfillshme. Të anketuarit e moshës nën 44 vjeç (24.9%, 26.4%, 26.1%) dhe ata që banojnë në zonat urbane (25%) ishin më të predispozuar për të thënë se ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t’iu bashkuar grupimeve të ekstremizmit politik, ndërsa të anketuarit mbi 64 vjeç (18%) apo njerëzit që banojnë në zonat rurale (22%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të intervistuarit që banojnë në Bulqizë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Këlcyrë, Libohovë, Pukë, dhe Shijak prireshin më shumë për të deklaruar se ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t’iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin politik në zonën ku banojnë.

Për të njëjtin pohim, por duke u fokusuar te radikalët që i bëjnë presion njerëzve për t’iu bashkuar grupeve që promovojnë ekstremizmin nacionalist, 6.3% e të anketuarve ishin dakord:

4.1% thanë se ishin disi dakord dhe 2.3% plotësisht dakord. Dallimet sipas gjinisë, arsimit, vendbanimit, apo përkatësisë fetare janë të papërfillshme. Të intervistuarit që banojnë në Berat, Mat, Memaliaj, Pogradec, Shijak, Tepelenë, Ura Vajgurore, dhe Vau i Dejës ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin nacionalist në zonën ku banojnë, por në këto bashki numri i të anketuarve është i vogël.

Figura 32: Individë radikalë që promovojnë ekstremizmin politik/fetar/nacionalist. (N1=1595; N2=1595; N3=1591)



Për ekstremizmin fetar, që konsiderohet si lloji kryesor i ekstremizmit që përbën rrezik për sigurinë e Shqipërisë si nga aktorët vendas ashtu edhe ata ndërkombëtarë³⁸, vetëm 7.1% e të anketuarve janë dakord me pohimin 'ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin fetar në zonën ku banojnë'³⁹, ndërsa 76.3% nuk ishin dakord 15.0% ishin të pasigurt. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 11.5% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka një rënie prej 4.4 p.p. në numrin e të anketuarve që thonë se ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin fetar.

Dallimet sipas gjinisë, arsimit, vendbanimit, apo përkatësisë fetare janë të papërfillshme. Është më se e kuptueshme që të anketuarit që janë më të angazhuar me fenë ndeshem më



- 38 Vrugtman, L. (2021). Statusi i (parandalimit dhe luftës kundër) ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Gjendet në adresën: <https://idmalbania.org/pcve-albania-paper/>
- 39 Të anketuarve iu kërkua të përcaktonin se cilës fe i përkasin këto grupe apo këta individë. Disa të anketuar thanë "Mysliman" (Islami Sunit), "Dëshmitarët e Jehovait", ose "grupe të ndryshme fetare". Të tjerët deklaruan se ka njerëz që veprojnë në komunitetin e tyre që financohen nga jashtë, se ka individë/grupe që kërkojnë njerëz të varfër për t'i shfrytëzuar dhe/ose radikalizuar, ose që shohin individë që keqinterpretojnë besimin në komunitetin e tyre.



shpesh me individë radikalë që u bëjnë presion njerëzve për t'iu bashkuar grupeve që nxisin ekstremizmin fetar. Të intervistuarit që thonë se luten/falen rregullisht (10%) apo që ndjekin të gjitha festat fetare gjatë vitit (9%), si dhe të anketuarit që festojnë të gjitha (10%) apo shumicën (9%) e ritualeve fetare ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se 'ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin fetar' sesa të anketuarit që janë më pak fetarë.

8% e të anketuarve që banojnë në zonat urbane janë dakord me pohimin, ndërsa vetëm 6% e atyre që banojnë në zonat rurale janë dakord. Të intervistuarit që jetojnë në Cërrik, Kamzë, Kuçovë, Maliq, Pogradec, Rrogozhinë, Shkodër, Tiranë, dhe Ura Vajgurore prireshin më shumë për të deklaruar se në zonën ku banojnë ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin fetar. Në 2018, kishte më shumë të anketuar që konfirmuan (ishin dakord ose plotësisht dakord) një presion të tillë te besimtarët fetarë në bashkitë Durrës, Elbasan, Kamzë, Kavajë, Krujë, Shijak, Tiranë, Vlorë, dhe Vorë.

Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm nuk duket si problem i përhapur në Shqipëri. Shumica e shqiptarëve thonë se nuk ka individë radikalë që u bëjnë presion të tjerëve për t'iu bashkuar grupeve ekstremiste në komunitetin e tyre. Pothuajse 1 në 4 shqiptarë (veçanërisht të rinjtë) thonë se ka individë radikalë që u bëjnë presion njerëzve për t'iu bashkuar grupeve ekstremiste politike në zonën ku jetojnë, ndërsa vetëm pak shqiptarë thonë se ka individë që veprojnë në komunitetin e tyre që u bëjnë presion njerëzve të bashkohen me nacionalistët ose grupe ekstremiste fetare. Njësoj si me pohimet e tjera nëse ekzistojnë grupe ekstremiste të dhunshme që veprojnë në zonën ku jetojnë të anketuarit, më pak se 2% e të anketuarve mendojnë se këto pohime nuk kanë lidhje apo rëndësi për çështjen në fjalë. Është me interes të evidentohet shqetësimi që shprehin njerëzit për lloje të ndryshme ekstremizmi - kryesisht për ekstremizmin politik, më pak për ekstremizmin fetar ose nacionalist – gjë që është në përputhje me proporcionin relativ të të anketuarve që raportojnë se grupe të tilla veprojnë në komunitetin e tyre.

Krahasuar me studimin e vitit 2018, përqindja e të anketuarve që thonë se “në zonën ku banojnë ka individë radikalë që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t'iu bashkuar grupimeve që promovojnë ekstremizmin fetar” ka rënë dukshëm. Për më tepër, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve mendojnë se një besimtar i denjë duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare. Po aq interesante, ndërsa në sondazhin e vitit 2018 besimtarët praktikantë ishin më pak të prirur të denonconin anëtarët e komunitetit të tyre që kishin pikëpamje ekstremiste, tani këta besimtarë janë më të gatshëm për të bërë një gjë të tillë. Kjo do të thotë se rritja e fokusit të harmonia dhe dialogu fetar, jo vetëm nga drejtuesit fetarë që marrin pjesë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, por edhe nga klerikët vendorë, ka pasur ndikim pozitiv në tolerancën e besimtarëve ndaj pikëpamjeve ekstremiste. Drejtuesit e komunitetit – qoftë ky komunitet fetar, politik apo shoqëror - kanë një rol të rëndësishëm në zbutjen e ndikimit të individëve dhe grupeve ekstremiste të dhunshme. Nxitja e njerëzve për të denoncuar kur dikush ka ide që mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë ndihmon në rritjen e sigurisë në komunitet, sepse kur ideologjitë radikale e të dhunshme nuk pranohen nga anëtarët e komunitetit, hapësira e mundshme e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm zvogëlohet.

8. Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane

Popullsia shqiptare është jashtëzakonisht pro-evropiane dhe pro-amerikane. Sipas Eurobarometrëve

te kryer në 2017/2018⁴⁰, mbi 75% e shqiptarëve thanë se kanë besim te Bashkimi Evropian dhe sipas sondazhit të Gallup International 72% e shqiptarëve kanë mendim pozitiv për ShBA dhe udhëheqjen e saj⁴¹. Megjithatë, rruga me pengesa drejt anëtarësimit në BE, gjatë të cilit blloku shtyu hapjen e negociatave të anëtarësimit tre herë, dhe sulmet e vazhdueshme ndaj BE-së nga elitat politike shqiptare kanë bërë që niveli i miratimit për BE-në të bie. Eurobarometri i fundit i verës së vitit 2020 tregoi një rënie në 62% të vlerësimit për BE-në⁴², tendencë që është e dukshme edhe në Sondazhin e Opinionit Publik për Besimin në Qeverisje, të kryer nga Institut për Demokraci dhe Ndërmjetësim⁴³.

Toleranca fetare në Shqipëri konsiderohet si vlerë themelore e shoqërisë e rrënjësuar thellësisht në traditën dhe vlerat qytetare të vendit. Megjithatë, rritja e populizmit në mbarë botën dhe paragjykimet në vendet e BE-së, veçanërisht ndaj refugjatëve nga vendet myslimane, kanë arritur tek publiku në vend dhe kanë ndikuar tek opinionet e tyre. Në një kontekst të tillë, popujt mund të pranojnë propagandën se sistemi ekonomik e politik në botë diskriminon botën myslimane, gjë që mund të shkaktojë ndjenjën personale apo të përbashkët të diskriminimit. Për të shqyrtuar këtë nxitës, në këtë studim shqyrtohen perceptimet e shqiptarëve ndaj sistemit ndërkombëtar dhe Perëndimit, si në nivel global ashtu edhe në rajonin e Ballkanit, përfshirë këtu edhe perceptimet lidhur me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pohimet në këtë nxitës:

- Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame
- Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare
- Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut)
- SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut)

Pohimi: Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin ‘duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 26.2% e të anketuarve janë disi ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 51.2% e të anketuarve nuk janë dakord. 14.9% e të anketuarve nuk ishin të sigurt nëse duhet të ishin dakord apo jo. Kur krahasohet me vitin 2018,




- 40 Shih fletët informative të Eurobarometrit 87 deri 90. Burimi: <https://ec.europa.eu/commfrontoffice/publicopinion/index.cfm/General/index>
- 41 Zivanovic, M. (2018). Kosovo Leads World in Cheering for Trump, Poll Shows. Balkan Insight. Gjetet në adresën: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-shows-highest-support-for-us-leadership-in-europe-poll-01-18-2018>
- 42 Eurobarometri 93. Burimi: <https://ec.europa.eu/commfrontoffice/publicopinion/index.cfm/General/index>
- 43 Vrugtman, L. and Dauti, M. (2021). Besimi në Qeverisje 2020 Sondazhi i Opinionit Publik. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Gjetet në adresën: <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>



kur 18,5% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 7.7 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se global strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, arsimit, përkatësisë fetare, apo praktikimit. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (31%), studentët (33%), dhe të anketuarit që banojnë në zonat urbane (28%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit që banojnë në zonat rurale (23%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Figura 33: ‘Strukturat globale u shpikën për të sunduar vendet myslimane’ (N=1600) & ‘Vendet e krishtera kanë më shumë mbështetje nga Perëndimi’ (N=1594)



Pohimi: Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare

47.2% e të anketuarve janë disi ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 34.2% e të anketuarve nuk janë dakord. 12.2% nuk e dinë nëse duan të jenë dakord apo jo. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 34.5% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 12.7 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare.


Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, arsimit, apo statusit të punësimit. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (58%), të moshës 45-54 vjeç (53%) apo që banojnë në zonat urbane (50%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit e grupmoshës ‘35-44 vjeç’ (38%) apo ata që banojnë në zonat rurale (44%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të intervistuarit e krishterë (ortodoksë, katolikë) ishin më pak të prirur për të rënë dakord në krahasim me të anketuarit myslimanë.

Pohimi: Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut)

43.9% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 41.7% e të anketuarve nuk janë dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 27.7% ishin dakord me pohimin, ka një rritje prej 16.2 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas statusit të punësimit, apo vendbanimit. 47% e të anketuarve femra janë dakord me pohimin, krahasuar me 42% të të anketuarve meshkuj. Të anketuarit e grupmoshës 25-34 vjeç (37%) ose me arsim deri në nivel fillor (38%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit e moshës 18-24 vjeç (49%) dhe të anketuarit me arsim pasuniversitar (68%) ishin më shumë të predispozuar për të rënë dakord. Të anketuarit që i praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (51%) dhe të anketuarit që luten/falen rregullisht (51%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord. Njësoj si me pohimin e mëparshëm, të anketuarit e krishterë ishin më pak të prirur për të rënë dakord se BE ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane.

Figura 34: ‘BE e padrejtë me vendet me shumicë myslimane’ (N=1599) vs. ‘ShBA të padrejtë me vendet me shumicë myslimane’ (N=1600)



Pohimi: SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut)

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 35.0% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 50.8% e të anketuarve nuk janë dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 21.6% ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ka një rritje prej 13.4 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane.



Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, arsimit, vendbanimit, apo praktikimit të besimit. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (40%) dhe të anketuarit e papunë (40%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit e grupmoshës '18-24 vjeç' (28%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të intervistuarit që identifikohen si myslimanë (40%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane, ndërsa të anketuarit ortodoksë (24%) dhe bektashinj (28%) prireshin më pak të shpreheshin kështu.

Edhe pse shqiptarët janë jashtëzakonisht pro-evropianë dhe pro-amerikanë, integrimi i ngadaltë Euro-Atlantik ka ndikuar në mbështetjen e shqiptarëve ndaj BE-së. Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm kombëtar të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm (IDM, 2018), mbështetja për të gjitha pohimet në këtë nxitës është rritur. 19% e shqiptarëve janë plotësisht dakord se BE ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit me shumicë të konsiderueshme myslimane dhe se vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre fetare. Nga ana tjetër, mbështetja për pohimin se "SHBA-të kanë qenë të padrejta me vendet e Ballkanit me popullsi të konsiderueshme myslimane", është shumë më e vogël. Ka shumë të ngjarë që ky perceptim, përveç se nxitet nga anëtarësimi në BE me hapa breshke i Shqipërisë, Kosovës dhe Bosnjë dhe Hercegovinës, buron edhe nga diskursi publik rreth shtyrjes së fundit të hapjes së negociatave të anëtarësimit.

Kur një pjesë e popullsisë ndihet e trajtuar në mënyrë të pabarabartë –qoftë e vërtetë apo thjesht perceptim– kjo mund të shfrytëzohet nga grupe ekstremiste që kërkojnë të shpallin veten si alternativën e duhur apo "më të drejtë". Ashtu si në vitin 2018, perceptimi se SHBA janë të padrejta me vendet dhe shoqëritë myslimane është më pak i zakonshëm sesa perceptimi që "Perëndimi dhe/ose strukturat globale janë të padrejta ndaj myslimanëve", që do të thotë se propaganda e mundshme e ekstremizmit të dhunshëm rreth padrejtësisë së BE-së në kontekstin ballkanik mbart një rrezik më të lartë sesa propaganda në kontekst global ose ajo kundër ShBA-ve.

Përfundime për nxitësit politikë

Nga tetë nxitës të analizuar në këtë kategori nxitësish politikë drejt ekstremizmit të dhunshëm, tre nxitës duket se janë pikërisht të rëndësishëm për situatën në Shqipëri: (1) Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile; (5) Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta; dhe në disa komunitete, (6) Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët. Këta nxitës mbështeten nga afërsisht gjysma e të anketuarve edhe më shpesh sesa nga të rinjtë me nivel të ulët arsimor. Edhe pse disa nxitës duket se janë më të përhapur kur i krahasojmë me vitin 2018, si, p.sh., nxitësit 'Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta' dhe 'Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë dhe popujt myslimanë', kemi nxitës të tjerë, të tillë si 'zona të paqeverisura apo të qeverisura dobët' për të cilin numri i të anketuarve që janë plotësisht dakord me këtë pohim ka rënë me deri në 15 p.p.

Në vitet e fundit, qeveria ka marrë masa për të përmirësuar numrin dhe cilësinë e shërbimeve publike në zonat urbane dhe rurale. Edhe pse shumica e shqiptarëve që janë ende dakord se "shteti si autoritet për zbatimin e ligjit" është më shumë i pranishëm se "shteti si ofrues shërbimesh për qytetarët" dhe se një përqindje edhe më e madhe mendon se prania e shtetit si zbatues i ligjit dhe ofrues shërbimesh është më e vogël në fshat sesa në qytete, vihet re një përmirësim kur e krahasojmë me raportin e vitit 2018. Një tjetër përmirësim vihet re në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Pavarësisht kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë, pothuajse gjysma e shqiptarëve bien dakord se në përgjithësi të drejtat dhe liritë e qytetarëve respektohen nga institucionet shtetërore, që është + 13,2 p.p. po ta krahasojmë me vitin 2018.

Ndonëse këto janë zhvillime shumë pozitive në lidhje me ngushtimin e hapësirës së mundshme për ekstremizmin e dhunshëm, gjetjet tregojnë se jo të gjithë ndjehen sikur trajtohen njësoj apo se nuk po përfitojnë njësoj. Në përgjithësi, shqiptarë janë jashtëzakonisht pro-evropianë dhe pro-amerikanë. Megjithatë, debati publik që fajëson BE-në se është e e padrejtë me vendet myslimane në procesin e zgjerimit ka ndikuar në perceptimet e qytetarëve për komunitetin ndërkombëtar dhe Perëndimin. Krahasuar me vlerësimin kombëtar të vitit 2018 për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm, mbështetja për të gjitha pohimet në këtë nxitës është rritur. Pothuajse një në pesë shqiptarë janë plotësisht dakord se BE ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit me popullsi të konsiderueshme myslimane dhe se vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre fetare. Ashtu si në vitin 2018, perceptimi se SHBA janë të padrejta me vendet dhe shoqëritë myslimane është më pak e zakonshme sesa Perëndimi dhe/ose strukturat globale janë të padrejta ndaj myslimanëve, që do të thotë se propaganda e mundshme e ekstremizmit të dhunshëm rreth padrejtësisë së BE-së në kontekstin Ballkanik mbart një rrezik më të lartë sesa propaganda në kontekst global ose ajo kundër ShBA-ve.

Për më tepër, ka një rritje të numrit të shqiptarëve që mendojnë se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpër me myslimanët praktikantë. 1 në 5 shqiptarë – dhe 1 në 4 myslimanë shqiptarë – mendojnë se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpër me myslimanët praktikantë. Në një kontekst të tillë, grupet ekstremiste të dhunshme e kanë më të lehtë ta promovojnë veten si alternativë e drejtë përkundër elitave të perceptuara imorale ose të padrejta qeverisëse. Pothuajse 4 në 10 shqiptarë - dhe besimtarët praktikantë edhe më shpesh - shohin tashmë tek feja një mundësi për trajtimin e korrupsionit dhe të pandëshkueshmërisë së elitave me lidhje të forta, duke qenë se besojnë se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuar dhe se në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi nëse me fenë e tyre do të bashkoheshin më shumë njerëz.

Nxitësit si dhunimi politik dhe shtypja e pamëshirshme nga qeveria nuk janë lidhje të drejtpërdrejtë me situatën në Shqipëri, por mund të perceptohen si të tilla nga grupe apo komunitete të caktuara. Pothuajse një në tre shqiptarë mendojnë se është detyrë e çdo qytetari të mbrojë ideologjinë e vet dhe detyrë e çdo besimtarit të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht. Në të dy rastet njerëzit me nivel të ulët arsimor binin më shumë dakord. E njëjta prirje vihet re edhe kur pyesim nëse do të përdornin dhunën për të arritur ndryshimin politik. 44.1% e popullsisë në vend mendojnë se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet të ndryshohet edhe me dhunë nëse është e nevojshme dhe 35.1% thonë se njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore. Edhe këtu, njerëzit me nivel të ulët arsimor priren të bien më shumë dakord, gjë që na sinjalizon se ata mund të jenë më të prirur për të përdorur mjete jodemokratike për të mbrojtur vlerat, të drejtat dhe liritë e tyre. Në këtë drejtim, lind nevoja për t'i informuar njerëzit me nivel të ulët arsimor për mundësitë që kanë për pjesëmarrje politike dhe angazhim qytetar.

Edhe pse besimtarët praktikantë –pra, ata që luten/falen shpesh dhe që praktikojnë të gjitha ritualet fetare– priren më pak të jenë më shumë dakord me disa nga pohimet të nxitësve politikë, ata janë më pak të prirur të bien dakord se njerëzit duhet të përdorin dhunën për të arritur ndryshimin. Për të gjitha pohimet e përmendura në paragrafin e mësipërm, si nevoja për ndryshimin e sistemit politik me mjete të dhunshme, vetëgjyqësia, dhe mbrojtja e fesë me çdo çmim, besimtarët praktikantë janë më pak të predispozuar për t'i mbështetur ato. Për më tepër, ata kanë më shumë gjasa se të tjerët për të thënë se besimtarit i vërtetë duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij fetar që shprehin pikëpamje ekstremiste fetare – ndërkohë që në 2018 ata ishin më pak të gatshëm të bënin një gjë të tillë. Kjo gjë mund të jetë rezultat i ndikimit të drejtuesve fetarë dhe klerikëve që predikojnë interpretime të moderuara të besimit fetar në Shqipëri.



Në përfundim, duke pasur parasysh sfidat e shtetit ligjor dhe të qeverisjes demokratike në Shqipëri, mund të kemi materializim të ideologjive ekstremiste të dhunshme, por nuk është e thënë që ato të jenë me motive fetare. Prania e ekstremistëve dhe individëve fetarë që ushtrojnë presion mbi besimtarët fetarë për t'iu bashkuar kauzave ekstremiste konfirmohet nga 7% e shqiptarëve, veçanërisht në bashkitë Cërrik, Kamzë, Kuçovë, Maliq, Pogradec, Rogozhinë, Shkodër, Tiranë dhe Ura Vajgurore. Gjithsesi, problem më i madh duket se është prania e individëve që u bëjnë presion njerëzve për t'iu bashkuar me grupet ekstremiste politike. Pothuajse 1 në 4 shqiptarë konfirmon praninë e tyre, veçanërisht në Bulqizë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Këlcyrë, Libohovë, Pukë dhe Shijak. Kjo, së bashku me 44% të shqiptarëve që bien dakord se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet të ndryshohet edhe me dhunë nëse është e nevojshme, sinjalizon se një tjetër kërcënim për sigurinë në vend mund të vijë nga grupe ekstremiste të dhunshme me motive politike dhe jo nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm fetar.



5.3. Nxitësit kulturorë

I ndodhur në udhëkryqin midis Perëndimit dhe Lindjes, Ballkani Perëndimor është bërë mozaik i grupeve etnike dhe fetare, ku secili grup përshtat besimin me traditat dhe kontekstin vendor. Si urë mes shoqërive perëndimore dhe kulturave më “tradicionale” ortodokse dhe islamike lindorefeja në Shqipëri përballet vazhdimisht me ndikime nga të dy anët. Pavarësisht se janë me lidhje të forta në komunitetet vendore, personat fetarë e konsiderojnë veten si pjesë të një bashkësie më të madhe besimtarësh dhe ndajnë kështu shqetësimet e bashkëbesimtarëve të tjerë në vende të tjera.

Ndjësia e përkatësisë ndaj një komuniteti fetar rajonal apo edhe global ka qenë nxitës kryesor që njerëz të ndryshëm të marrin pjesë në konflikte të huaja në emër të mbrojtjes së bashkëbesimtarëve. Kjo ka nxitur luftëtarët e huaj në Afganistan në vitet 1980, Bosnje dhe Hercegovinë në vitet 1990 dhe Siri e Ukrainë në 2010. Edhe pse komunitetet myslimane në Ballkan kanë pak lidhje transnacionale dhe nuk i përmbahen vizionit të Islamit “universalist”: “Burimi i umma-s (xhematit) si formë e identitetit politik ka qenë sporadik e jo sistematik dhe nuk u shndërrua kurrë në program ideologjik”⁴⁴, disa u inkurajuan për t’u përfshirë në konfliktin në Siri për këtë arsye, mes të tjera gjërash.

Duke e paraqitur veten si rimishërim i idealit të një kalifati botëror, Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë u shndërrua në një pikë tërheqjeje për shumë myslimanë të radikalizuar nga e gjithë bota që besonin se po zhvillohej një xhihad botëror kundër Perëndimit. Për këtë arsye, në këtë studim përfshimë një seksion për nxitësit kulturorë për të vlerësuar perceptimet e të anketuarve për kërcënimet e mundshme ndaj identiteteve dhe stilit të jetesës. Pyetjet u bazuan në studimin e Denoux dhe Carter (2009), të cilët theksuan tre lloje nxitësish kulturorë që lidhen me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare, si vijon: (1) perceptime të sulmeve dhe padrejtësive të vazhdueshme nga vendet perëndimore ndaj kulturës dhe vendeve myslimane; (2) perceptime të pushtimit dhe asimilimit të kulturës tradicionale të një vendi nga influenca të huaja moderniste, dhe (3) përpjekje proaktive të grupeve radikale për imponimin dhe përhapjen e nën-kulturës dhe rrymës së tyre të repte të Islamit mbi traditat dhe kulturat e tjera.⁴⁵

Tabela 4: Nxitësit kulturorë, sipas Denoux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018

Feja nën rrethim	Ekziston një lidhje e fortë mes suksesit të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon Islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera.
Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	Popullata mund të perceptojë një kërcënim të përgjithshëm kulturor ndaj traditave, zakoneve, vlerave dhe ndjesisë së nderit dhe dinjitetit personal dhe kolektiv.
Agjendat “Proaktive” fetare	Grupet që nxisin agjendat e tyre do të tentojnë të imponojnë versionin e tyre të Islamit, xhihadit, etj., tek popullatat vendase, duke dobësuar kështu strukturat dhe praktikatat më të moderuara e më tolerante fetare. Kjo krijon kushtet për ekstremizmin e dhunshëm.



44 Merdjanova, I. (2013) *Rediscovering the Umma: Muslims in the Balkans between Nationalism and Transnationalism*. Oxford: Oxford University Press, f. 58.

45 Denoux, G. dhe Carter L. (2009) “Development Assistance and Counter Extremism: A Guide to Programming”, United States Agency for International Development.



I. Feja nën rrethim

Ky nxitës kulturor lidhet me perceptimet se Islami dhe myslimanët sulmohen nga Perëndimi. Për shkak të konflikteve ku përfshihen myslimanë, në vende si Palestina, Siria, Iraku, Afganistani dhe gjetkë, teoritë ekstremiste të konspiracionit pretendojnë se fuqitë perëndimore po kërkojnë të nënshtrojnë dhe të poshtërojnë vetë Islamin. Këto perceptime rreth një komploti të vazhdueshëm perëndimor kundër Islamit dhe shoqërive myslimane janë të përhapura në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore (LMAV) për shkak të disa faktorëve, siç janë përvojat e kaluara të kolonializmit, konflikti izraelito-palestinez dhe dështimi i regjimeve arabe laike dhe nacionaliste për të realizuar zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve të tyre.

Ekziston një lidhje e fortë mes suksesit të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon Islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera. Në studimin e IDM-së për ekstremizmin e dhunshëm (2015) raportohen raste të imamëve të vetëshpallur që predikonin urrejtje ndaj myslimanëve të tjerë shqiptarë, duke i quajtur hipokritë apo edhe qafirë (të pafe) dhe duke i akuzuar ata si bashkëpunëtorë me politikën e Perëndimit kundër Islamit.⁴⁶ Që nga ajo kohë, ndikimi i këtyre imamëve të vetëshpallur është zbutur shumë për shkak të përpjekjeve të KMSH për të marrë nën kontroll të gjitha xhamitë e paligjshme e të paregjistruara, nxjerrjen e direktivave për imamët dhe rritjen e mundësive për kontrollin e edukimit dhe trajnimit fetar në Shqipëri. Megjithatë kemi përmirësim të situatës, është ende e rëndësishme të vazhdohet me monitorimin e perceptimeve të popullatës shqiptare në lidhje me mesazhet propagandistike.

Pohimet në këtë nxitës:

- Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame
- Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame
- Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë

Pohimi: Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame


Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 39.4% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 45% nuk ishin dakord, dhe 15.7% ishin të pasigurt se e konsideronin këtë pohimi si pa lidhje. Krahasuar me rezultatet e sondazhit të vitit 2018, kur 25.6% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka një rritje prej 13.8 p.p. numrin e të anketuarve që janë dakord me pohimin.

Të anketuarit e moshës mbi 64 vjeç (47%), me diplomë pasuniversitare (51%), studentët (48%), dhe ata që banojnë në zonat urbane (43%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit që jetojnë në zonat rurale (34%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Besimtarët jopraktikantë (njerëzit që praktikojnë ritet fetare vetëm në ngjarje të veçanta dhe që luten/falen vetëm në kohë krize) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin (të dy me 34%), në krahasim me besimtarët praktikantë apo ata që nuk besojnë fare.



46 Shih IDM (2015) “Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri.” Tirana. fq. 89–90.


Figura 35. Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame (N=1600)



Pohimi: Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame

Të anketuarve iu kërkua të thonin sa janë dakord apo nuk janë dakord me pohimin. 19.9% janë dakord se në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame, ndërsa shumica (69.9%) nuk janë dakord. Krahasuar me rezultatet e sondazhit të vitit 2018, kur 10.3% e të anketuarve ishin dakord, përqindja e të anketuarve që janë dakord me pohimin është rritur me 9.6 p.p. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, age, përkatësisë fetare, apo praktikimit të fesë. Të anketuarit me arsim fillor (25%) dhe studentët (26%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin.

Figura 36: Sot është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame (N=1600) vs. besimtar i krishterë (N=1598) në Shqipëri



Pohimi: Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë

Për këtë pohim, vetëm 9.5% e të anketuarve thanë se ishin dakord, ndërsa shumica dërrmuese e të anketuarve (79.4%) nuk ishin dakord ose aspak dakord. Në krahasim me rezultatet e 2018, kur 5.0% ishin dakord me pohimin, vihet re një rritje prej 4.5 p.p. e numrit të të anketuarve që mendojnë se sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, age, statusit të punësimit, përkatësisë fetare, apo praktikimit të fesë. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (14%) apo me arsim 8/9 vjeçar (12%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. Besimtarët praktikantë (të intervistuarit që luten/falen rregullisht apo që praktikojnë të gjitha ritet fetare) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin (të dy me 6%) se të intervistuarit që praktikojnë fenë me raste.

Njerëzit që ndihen të shtypur apo të marginalizuar mund të bëhen më të cenueshëm nga propaganda e dhunshme ekstremiste që pretendon se Perëndimi synon të nënshtrojë dhe poshtërojë Islamin. Edhe pse gjuha e urrejtjes e përhapur nga hoxhallarë radikalë të vetëshpallur, siç u theksua në studimin e vitit 2015 për ekstremizmin e dhunshëm, nuk është e përhapur sot, është e rëndësishme të vazhdohet me monitorimin për të kuptuar nëse njerëzit e një feje të caktuar ndihen të marginalizuar. Përgjigjet ndaj pohimeve në nxitësin 'Feja nën rrethim' tregojnë se, ndonëse shumica e shqiptarëve nuk mendojnë se është e vështirë të jesh një besimtar praktikant në Shqipëri, një në katër prej tyre është i mendimit se Perëndimi është armiqësor ndaj shteteve dhe kulturave islamike.

Përqindja e shqiptarëve që kanë këtë perceptim është rritur me 13.8 p.p. që nga viti 2018. Kjo gjetje e shoqëruar me rritjen e perceptimit se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor ndaj shoqërive dhe popujve myslimanë (siç u pa edhe te nxitësit politikë), sugjeron se vonesat në integrimin në BE mund t'i shtyjë qytetarët shqiptarë të reflektojnë se çfarë i dallon ata nga popujt e tjerë evropianë. Stigma e brendësuar për shkak të përkatësisë fetare rrit gjasat që këta individë të bëhen të ndjeshëm ndaj propagandës radikale fetare. Si pasojë, përpjekjet për informim dhe rritje ndërgjegjësimit në të ardhmen duhet të shënjestrojnë jo vetëm besimtarët praktikantë, por edhe popullatën në përgjithësi për të luftuar si perceptimet e diskriminimit ashtu edhe Islamofobinë.

2. Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës

Kërcënimi kulturor perceptohet në formën e zbehjes së traditave "autentike" dhe gërryerjes së solidaritetit të grupit nga ndikimet kulturore që vijnë nga jashtë. Ringjallja e fesë në Shqipërinë postkomuniste u shoqërua me dyndjen e misionarëve dhe fondacioneve fetare të huaja që përpiqeshin t'i kthenin "ateistët" shqiptarë në fenë "e vërtetë" ose t'u mësonin atyre versionin e saktë të fesë përkatëse. Që në fillim të viteve 1990, në Shqipëri u ngritën shqetësime se në vend po prezantoheshin mësimet dhe norma fetare që ishin të huaja për traditat fetare të vendit

Për të matur perceptimet e publikut për kërcënimet e formave tradicionale të praktikimit të fesë islame apo të feve të tjera në Shqipëri, të anketuarit iu lexuan dy pohime. Për më tepër, shqiptarët u pyetën se cilat lloje ekstremizmi sipas mendimit të tyre janë rreziku kryesor në vend.

Pohimet në këtë nxitës:

- Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator
- Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm
- Sa të shqetësuar jeni me ekstremizmin politik/nacionalist/fetar në Shqipëri?⁴⁷


Pohimi: Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator

Të anketuarve iu kërkua të tregonin sa dakord ishin me pohimet duke përdorur një shkallë prej katër pikësh nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). 39.1% janë dakord me pohimin, ndërsa 41.2% e kundërshtojnë atë dhe 16.3% thanë se nuk dinin të jepnin një përgjigje. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 33.2% e të anketuarve ishin dakord, ka një rritje prej 2.9 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord me pohimin.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, apo statusit të punësimit. Të intervistuarit me arsim pasuniversitar (30%) dhe me arsim deri në nivel fillor (33%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit me arsim fillor (46%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord. 41% e të anketuarit që banojnë në zonat urbane dhe 36% e të anketuarit që banojnë në zonat rurale janë dakord.

Besimtarët myslimanë (38%) janë më pak dakord me pohimin sesa të anketuarit me përkatësi tjetër fetare. Besimtarët praktikantë – pavarësisht se cilën fe praktikojnë – ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. 42% e të anketuarve që praktikojnë të gjitha ritualet fetare janë dakord me pohimin, ndërsa 39% besimtarëve jo-praktikantë dhe 28% e të anketuarve që nuk praktikojnë ritet fetare sepse nuk janë njerëz fetarë, janë të mendimit se besimtarët myslimanë në Shqipëri po përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator.

Figura 37. Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator (N=1594)



47 Lutemi referojuni pjesës 3 në pyetësor (Shtojca VIII.2) për këtë pyetje. Gjetjet që lidhen me këtë pyetje jepen në seksionin e nxitësve kulturorë, duke parasysh kontekstin e pyetjes.




Pohimi: Besimi, traditat dhe dinjteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm

Të anketuarve iu kërkua të thonin sa dakord janë me pohimin “besimi, traditat dhe dinjteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm” duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 21.7% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 66.6% nuk ishin dakord. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 20.0% e të anketuarve e mbështetën këtë pohim, nuk ka dallime të konsiderueshme në numrin e të anketuarve që janë dakord me pohimin.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, arsimit, statusit të punësimit, apo vendbanimit. Të intervistuarit me diplomë pasuniversitare (16%) dhe ata me arsim deri në nivel fillor (16%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit me arsim fillor (30%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord. Besimtarët myslimanë (26%) janë më shumë dakord me pohimin sesa të intervistuarit me përkatësi tjetër fetare. Të anketuarit që praktikojnë fenë me raste (si ata që luten/falen ashtu edhe ata që praktikojnë ritualet fetare) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se besimi, traditat dhe dinjteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm, në krahasim me ata që nuk praktikojnë asnjë rit apo praktikojnë me raste.

Figura 38: Besimi, traditat dhe dinjteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm (N=1595)



Pohimi: Sa të shqetësuar jeni për ekstremizmin politik/nacionalist/fetar në Shqipëri?

Të anketuarve iu kërkua të thonin sa të shqetësuar janë për ekstremizmin politik/nacionalist/fetar në Shqipëri duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak i shqetësuar” (1) në “shumë i shqetësuar” (4). Të intervistuarit kishin më shumë gjasa të ishin të shqetësuar për ekstremizmin politik: 42.0% e të anketuarve thanë se janë të shqetësuar (22.4%) apo shumë të shqetësuar (19.6%). Kjo ndiqet nga ekstremizmi fetar, gjë që është shqetësuese për 31.8% të të anketuarve, ndërsa vetëm 16.7% e të anketuarve thanë se janë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar me ekstremizmin nacionalist.


Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas statusit të punësimit apo vendbanimit. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (47%), me

arsim universitar (47%), apo me arsim pasuniversitar (46%) kishin më shumë gjasa të ishin të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për ekstremizmin e dhunshëm politik. Të anketuarit që jetojnë në Bulqizë, Kamzë, Kuçovë, Kurbin, Maliq, Rrëshen, Tiranë, dhe Ura Vajgurore kishin më shumë gjasa të ishin të shqetësuar për ekstremizmin politik.

Për ekstremizmin e dhunshëm nationalist (mesatarja: 16.7%), të anketuarit e grupmoshës 25-34 vjeç (15%) apo me arsim pasuniversitar (8%) ishin më pak të prirur të ishin të shqetësuar ose shumë të shqetësuar. Të anketuarit që banojnë në Kavajë, Kuçovë, Kurbin, Mat, Rrëshen, Shijak, dhe Vau i Dejës ishin më shumë të shqetësuar për ekstremizmin nationalist se të intervistuarit që jetojnë në bashki të tjera.

29% e të anketuarve meshkuj dhe 35% e të anketuarve femra janë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar për ekstremizmin fetar. Të anketuarit e grupmoshës 25-34 vjeç (28%) prireshin më pak të ishin të shqetësuar ose shumë të shqetësuar për ekstremizmin e dhunshëm fetar. Të anketuarit që praktikojnë fenë – pavarësisht cilën fe – më shpesh (luten/falen rregullisht, praktikojnë të gjitha ose shumicën e riteve fetare) prireshin më shumë për të qenë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar për ekstremizmin fetar. Të intervistuarit që jetojnë në Bulqizë, Lezhë, Memaliaj, Rrëshen, dhe Rrogozhinë ishin më shpesh të shqetësuar për ekstremizmin fetar.

Figura 39: Sa të shqetësuar jeni me ekstremizmin politik/nacionalist/fetar në Shqipëri? (N1=1600; N2=1594); N=1593)



Kur ndikimi i grupeve fetare të huaja bëhet aq i fortë sa dëmton traditën dhe kulturën vendase, kjo mund të krijojë perceptimin e një kërcënimi më të përgjithshëm kulturor në popullatë. Në fakt, 21.7% e shqiptarëve mendojnë se traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. Besimtarët myslimanë (26%) dhe besimtarët që praktikojnë fenë herë pas here (si ata që luten/falen ashtu edhe ata që praktikojnë rituale fetare) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. Për më tepër, 39.1% e popullsisë shqiptare mendojnë se besimtarët myslimanë në Shqipëri po përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator. Ndonëse mbështetja për këto pohime nuk është rritur që nga viti 2018, është e rëndësishme që të vazhdohet me monitorimin e ndikimit të huaj në çështjet e brendshme fetare dhe të besimtarët shqiptarë.

Duke pasur parasysh fokusin e aktorëve P/LKEDH tek ekstremizmi i dhunshëm fetare si rrezik për sigurinë, është me interes të evidentohet se një numër më i madh shqiptarësh janë më shumë të shqetësuar për ekstremizmin politik (42%) sesa për ekstremizmin fetar (38%) – veçanërisht ata që banojnë në Bulqizë, Kamzë, Kuçovë, Kurbin, Maliq, dhe Tiranë. Këto gjetje sugjerojnë se sistemet aktuale të dialogut janë të papërshtatshme ose të pamundura për popullsinë në përgjithësi. Metodatat që përqendrohen te promovimi i dialogut dhe te nxitja e llogaridhënies do t'u mundësonin individëve më pak të rrezikuar të angazhohen në një hapësirë të sigurt, jo vetëm për të trajtuar shqetësimet e tyre ndaj të tjerëve, por edhe për të reflektuar për krijimin e një identiteti të bazuar në parime. Kjo do t'u bëjë të mundur këtyre individëve të kuptojnë potencialin e tyre transformues dhe të marrin një rol më aktiv në shoqëri, duke vepruar si ndërmjetës dhe duke zbutur ndikimin e kërcënimeve dashakeqëse kulturore, teksa njëkohësisht ruajnë edhe zakonet dhe vlerat tradicionale. Duke u mbështetur te vlerat kombëtare, siç është harmonia fetare, dialogu gjithëpërfshirës do të bëjë të mundur diskutimin në mënyrë produktive në lidhje me integrimin e qëndrimeve që janë jashtë rrymës kryesore.

3. Agjenda “proaktive” fetare

Kur flasim për marrëdhënien midis fesë dhe kulturës në kohët moderne, Roy (2015) bën dallimin mes dy qëndrimeve: akomodimizmi dhe fundamentalizmi.⁴⁸ Grupet besimtare të akomodimizmit mendojnë se feja është e ngulitur në kulturë dhe se kultura e përbashkët është parakusht për ekzistencën e fesë. Për akomodimizmin, besimtari i një feje mund të ketë të njëjtën kulturë me një jobesimtar dhe besimtarë të feve të tjera. Fundamentalizmi kërkon ndarjen e fesë nga kultura.

Kur grupet ekstremiste ose radikale promovojnë qëndrimin e tyre - fundamentalist - të Islamit ose të feve të tjera te popullata në vend, ato dobësojnë strukturat dhe praktikat fetare tradicionale më të moderuara dhe tolerante. Indoktrinimi i një version kaq të ngurtë të besimit e shkëput besimtarin nga kultura përreth dhe shoqëria mund të bëjë që këta individë dhe grupe të përqafojnë ekstremizmin fetar. Mundësia dhe rreziku i individëve dhe grupeve radikalë për të zbatuar një agjendë proaktive fetare në Shqipëri matet përmes dy pohimeve. Pohimi i parë vlerëson sa e konsiderojnë shqiptarët Shtetin Islamik në Siri dhe Irak si përfaqësuesin e vërtetë të Islamit, ndërsa pohimi i dytë vlerëson nëse në Shqipëri veprojnë grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të besimeve të ndryshme.

Pohimet në këtë nxitës:

- Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit.
- Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë islame/ortodokse/katolike/bektashiane/evangeliste apo të feve të tje

Pohimi: Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit.

Të anketuarve iu kërkua të thonin opinionin e tyre nëse “Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit”, për të cilën 12.3% e të anketuarve thanë se janë dakord me pohimin, 70.0% nuk ishin dakord dhe 13.5% nuk dinin të jepnin një përgjigje.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë,




48 Roy, O. (2013) Holy Ignorance: When Religion and Culture Part Ways. Oxford: Oxford University Press.



moshës, apo statusit të punësimit. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (22%), arsim fillor (16%), dhe ata që jetojnë në zonat urbane (14%) ishin paksa më të prirur për të rënë dakord me pohimin sesa të anketuarit që banojnë në zonat rurale (10%) apo ata me nivel më të lartë arsimor (me arsim universitar: 9%, pasuniversitar: 7%). 13% të anketuarve myslimanë ishin dakord me pohimin. Të anketuarit praktikantë të besimit –pavarësisht se cilës fe i përkasin– ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin (ata që praktikojnë të gjitha ritualet dhe që luten rregullisht, 9%) sesa ata besimtarë që i praktikojnë ritet me raste apo jo-besimtarët.

Figura 40: Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit. (N=1596)




Pohimi: Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë islame

Të anketuarve iu kërkua të thonin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 38.0% e të anketuarve janë dakord me pohimin, 41.3% nuk janë dakord, dhe 19.4% nuk janë të sigurt. Krahasuar me studimin e vitit 2018, kur 26.0% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka një rritje prej 12.0 p.p. në numrin e të anketuarve që raportojnë praninë e grupeve të mirë-organizuara që përhapin interpretimin ekstremist të fesë islame. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, age, arsimit, statusit të punësimit, apo vendbanimit. 34% e të anketuarve myslimanë janë dakord. Të anketuarit që luten/falen rregullisht (43%) apo që praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (44%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin sesa besimtarët që nuk i praktikojnë ritet fetare (33%) dhe njerëzit që luten/falen vetëm në kohë krizash (31%).

Pohimi: Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë ortodokse.

Kur u pyetën nëse ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë ortodokse në Shqipëri, 17.3% e të anketuarve janë dakord me pohimin, 54.2% nuk janë dakord, dhe 27.2% janë të pasigurt. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, arsimit, statusit të punësimit, apo vendbanimit. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (23%) me arsim 8/9 vjeçar (19%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin se të intervistuarit me diplomë pasuniversitare (8%). 12%



e të anketuarve ortodoksë janë dakord. Të intervistuarit që e praktikojnë fenë me raste (20%) apo që luten/falen në vetëm në kohë krizash (23%) janë më shumë dakord me pohimin sesa të anketuarit që luten/falen rregullisht (9%) dhe që praktikojnë të gjitha ritet e fesë së tyre (9%).

Pohimi: Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë katolike.

19.7% e të anketuarve janë dakord se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë katolike në Shqipëri, ndërsa 53.6% e kundërshtojnë këtë pohim dhe 25.5% nuk janë të sigurt. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, apo arsimit. Të anketuarit e vetëpunësuar (25%) dhe ata që banojnë në zonat urbane (22%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit nga zonat rurale (16%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. 24% e të anketuarve katolike janë të këtij mendimi. Njerëzit që luten/falen me raste për ngjarje të veçanta fetare (25%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë katolike në krahasim me ata që nuk praktikojnë rregullisht ritet e fesë së tyre (15%) apo ata që nuk luten/falen asnjëherë (12%).

Pohimi: Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë bektashiane.

Kur u pyetën për të dhënë mendimin e tyre me përgjigjet që varionin nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4) me pohimin, 13.2% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 56.2% e kundërshtonin pohimin dhe 29.7% thanë se nuk dinin të jepnin një përgjigje. Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, apo statusit të punësimit. Të anketuarit me arsim deri në nivel fillor (22%) apo që banojnë në zonat urbane (15%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin në krahasim me njerëzit që kanë arsim pasuniversitar (6%) apo që jetojnë në zonat rurale (11%). 10% të të intervistuarve bektashinj ishin të këtij mendimi. Të anketuarit që luten/falen me raste për ngjarje të veçanta (21%) apo në kohë krizash (20%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord, ndërsa të anketuarit që praktikojnë ritualet e fesë së tyre rregullisht (7%) apo që luten/falen rregullisht (7%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin.


Pohimi: Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë evangjeliste.

Vetëm 15.7% e të anketuarve janë dakord se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë së krishterë ungjillore në Shqipëri, ndërsa 47.2% nuk janë dakord dhe 35.5% thanë se nuk e dinin nëse ishin dakord apo jo. Të intervistuarit e moshës mbi 64 vjeç (22%), studentët (21%), dhe ata që jetojnë në zonat urbane (19%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit që banojnë në zonat rurale (11%) ishin më pak dakord. Asnjë nga të 11 të anketuarit e besimit të krishterë ungjillor nuk ishte dakord me pohimin. Të anketuarit që luten/falen me raste për ngjarje të veçanta (25%) apo në kohë krizash (21%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord, ndërsa të anketuarit që praktikojnë ritualet e fesë së tyre rregullisht (8%) apo që luteshin/faleshin rregullisht (8%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin.

Pohimi: Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të feve të tjera.

Të intervistuarit u pyetën nëse në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të feve të tjera. Nga 78 të anketuar në total që zgjodhën të specifikonin përgjigjen, 65 thanë Dëshmitarët e Jehovait.

Figura 41: Ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime të fesë... (N1=1597; N2=1593; N3=1591; N4=1597; N5=1587)



Kur grupet ekstremiste ose radikale përhapin interpretimin e tyre fundamentalist të besimit, ato dobësojnë strukturat dhe praktikatat fetare tradicionale më të moderuara dhe tolerante. Mundësia dhe rreziku i grupeve dhe individëve radikalë për zbatimin e agjendës proaktive fetare në Shqipëri u mat duke vlerësuar mbështetjen për Shtetin Islamik të Irakut dhe Sirisë si përfaqësuesin e vërtetë të fesë islame dhe ekzistencën e grupeve të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të feve të ndryshme që veprojnë në Shqipëri.

12% e shqiptarëve – veçanërisht ata me nivel të ulët arsimor apo që banojnë në zonat urbane – janë dakord se Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë është përfaqësuesi e vërtetë të fesë islame. Besimtarët praktikantë ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin në krahasim me besimtarët që praktikojnë me raste, apo jo-besimtarët. Është me interes të evidentohet se përhapja e perceptuar e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm fetar që veprojnë në Shqipëri është më e madhe se përhapja faktike e raportuar aktualisht. 38.0% e të anketuarve thonë se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë islame në Shqipëri dhe 10%-20% e të intervistuarve besojnë se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë ortodokse, katolike, bektashiane, apo të krishterë ungjillore në Shqipëri. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se interpretimi ekstremist i një besimi nuk implikon domosdoshmërisht praninë e ekstremizmit të dhunshëm. Në të njëjtën kohë, rezultatet e nxitësit 'Rrjetet shoqërore dhe dinamika e grupit' tregojnë se vetëm 12.1% e të anketuarve raportojnë se në komunitetin e tyre veprojnë grupe të ekstremizmit të dhunshëm fetar.



Njerëzit ishin përgjithësisht më pak të predispozuar për të denoncuar grupe që përhapnin interpretime ekstremiste të së njëjtës fe me të tyre, gjë që mund të tregojë se ekstremizmi fetar perceptohet më lehtë nga besimtarët e feve të tjera. Në të njëjtën kohë, besimtarët praktikantë aktivë janë më të prirur të deklarojnë se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë islame (43%) në Shqipëri, ndërsa në të njëjtën kohë ata janë më pak të prirur të thonë se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë bektashiane (7%), ortodokse (9%) apo të krishterë ungjillore (8%). Gjetjet në këtë nxitës nxjerrin në pah nevojën për të promovuar dialogun si mjet për krijimin e qëndresës duke u bazuar te vlerat dhe traditat fetare shqiptare. Për këtë qëllim, autoritetet fetare duhet të luajnë rolin vendimtar për eliminimin e ndikimit fundamentalist të propagandës fetare shqiptare.

Përfundimet për nxitësit kulturorë

Ndërsa shumica e të anketuarve nuk shohin qëndrime armiqësore ndaj Islamit, përqindja e shqiptarëve që janë dakord (39.4%) se Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame është rritur ndjeshëm me 13.8 p.p. krahasuar me sondazhin e 2018. Ajo që është më rëndësishme është se pothuajse gjysma e shqiptarëve myslimanë janë dakord me këtë pohim. Për më tepër, përqindja e shqiptarëve be besojnë se në ditët e sotme është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman apo i krishterë është rritur. 19.9% janë dakord se në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame, ndërkohë që 9.5% thonë të njëjtën gjë për fenë e krishterë. Shqiptarët që respektojnë fenë e tyre pak a shumë nuk shohin vështirësi se një njeri i zakonshëm, por që gjithsesi problemi mbetet duke qenë se 1 në 5 myslimanë në vend shohin kufizime në ushtrimin e fesë.

Për sa i përket pranisë dhe rrezikut të perceptuar të grupeve të dhunshme ekstremiste në Shqipëri, pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk shqetësohen për ekstremizmin e dhunshëm. Shqetësimi kryesor për shqiptarët është ekstremizmi politik, i ndjekur nga ekstremizmi fetar dhe nacionalist. Të anketuarit në moshë të madhe janë më shpesh të shqetësuar për ekstremizmin - qoftë ai politik, nacionalist apo fetar – në krahasim me të anketuarit e rinj në moshë. 31.8% e popullsisë në Shqipëri është e shqetësuar për ekstremizmin fetar, ku shqiptarët myslimanë kanë më pak gjasa të shqetësohen. Besimtarët praktikantë- pavarësisht nga feja – ishin më shumë të prirur të shqetësoheshin për ekstremizmin fetar. Kur bëjmë krahasime të ndërsjella të kësaj me llojet e tjera të grupeve ekstremiste fetare që veprojnë në vend, 38% e të anketuarve thonë se në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë Islam, ndërsa diku 10-20% e të anketuarve besojnë se ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të fesë ortodokse, katolike, bektashiane, apo të krishterë ungjillore. 4% e të anketuarve përmendën në mënyrë të veçantë Dëshmitarët e Jehovahit kur u pyetën për llojet e tjera të grupeve ekstremiste fetare që veprojnë në Shqipëri, perceptim që mund të jetë ndikuar nga mediat e lajmeve që lidhin vetëvrasjen e një nëne dhe vajzës së saj në Tiranë me sektin Dëshmitarët e Jehovahit, pavarësisht se ky grup mohoi të kishte lidhje me këtë ngjarje.⁴⁹


Kur 34% e vetë besimtarëve myslimanë tregojnë praninë e grupeve që përhapin interpretime ekstremiste, fundamentalizmi islamik është më shqetësuesi, gjë që sugjeron nevojën për të rritur



49 Nase, P. dhe Maçi, M. (2020). Lanë ushqimin, sakrifikuan veten e tyre për nënën dhe bijën, dëshmia e motrës nga spitali. Shqiptarja.al. Gjetendet në adresën: <https://shqiptarja.com/lajm/detaje-tronditese-nga-veteflijimi-anisa-josifi-prej-kohesh-mbahej-e-pajete-ne-banese-e-motra-se-keni-idene-cfare-kaluam-ne-per-te-fituar-ringjalljen>

rolin e autoriteteve fetare. Sipas 39.1% të shqiptarëve, besimtarët myslimanë në Shqipëri po përballen me ndikimet e huaja të Islamit konservator. Besimtarët praktikantë, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare, ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se besimtarët myslimanë po përjetojnë ndikimin e huaj. Edhe pse shqiptarët myslimanë ishin më pak të prirur për të rënë dakord me këtë pohim, 1 në 4 vetë mendojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcimin të vazhdueshëm. 12% e shqiptarëve dhe 13% e shqiptarëve myslimanë janë dakord se “Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit” – ku njerëzit me nivel të ulët arsimor prireshin më shumë për të rënë dakord me këtë pohim.

Hapësirat e pamjaftueshme për t’u angazhuar në dialog konstruktiv kanë nxitur përhapjen e interpretimeve fundamentaliste fetare. Këto gjetje sugjerojnë nevojën për të vazhduar monitorimin e ndikimit të huaj të çështjet e brendshme fetare, ndërkohë që duhet të vijohet me dialogun gjithëpërfshirës. Nevojitet një qasje ku të përfshihet e gjithë shoqëria për të krijuar një hapësirë të sigurt për dialog gjithëpërfshirës, që u bën të mundur individëve të marrin përsipër detyrat e tyre qytetare në mënyrë të përgjegjshme dhe të informuar. Në këtë aspekt, kjo do të ndihmonte që komunitetet e marginalizuara të angazhohen në dialog koheziv, ku mund të trajtojnë shqetësimet e tyre, ndërkohë që nxisin kërkesën e llogarisë. Duke u mbështetur te vlerat kombëtare, si toleranca fetare, ky dialog do të bëjë të mundur që qëndrimet jo-standarde të kalojnë përmes filtrit të shoqërisë shqiptare – ku kjo e fundit ekuilibron çdo ndikim të huaj që do të synonte të ndërhynte në identitetin e saj. Në këtë drejtim, autoritetet fetare, në mënyrë të veçantë, mund të luajnë një rol vendimtar.



6. Riintegrimi dhe parandalimin

Ashtu si pjesa më e madhe e vendeve evropiane, Shqipëria po përballet me rikthimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre që iu bashkuan grupeve kryengritëse në Irak dhe Siri. Ndonëse afati dhe objekti i riadhesimit dhe ri-integrimit të shtetasve shqiptarë mbeten të pasigurt, ka të ngjarë që Shqipëria të shohë shtetasit e saj të rikthehen nga Siria në të ardhmen e afërt. Përveç sfidave logjistike të riadhesimit dhe rehabilitimit, Shqipërinë e pret sfida më e madhe e riintegritimit të këtyre familjeve. Për më tepër, institucionet shtetërore kanë përgjegjësinë të sigurohen që luftëtarët e huaj që kthehen dhe familjet e tyre nuk paraqesin kërcënim për sigurinë për shoqërinë shqiptare.

Për rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë kërkohet angazhim i të gjithë shoqërisë, përfshirë këtu institucionet shtetërore vendore dhe qendrore, punonjësit e vijës së parë, si shërbimet psiko-sociologjike, shkollat dhe policinë dhe komunitetin pritës. Për të parandaluar përhapjen e rrezikut të mundshëm për sigurinë në komunitet, nevojiten strategji me shumë aktorë me qëllim që të trajtohet gradualisht konteksti i përgjithshëm shoqëror, ekonomik dhe kulturor që ushqen sjellje ekstremiste dhe të dhunshme, veçanërisht tek të rinjtë. Në strategjitë për rehabilitimin e qëndrueshëm të të rikthyerve dhe për parandalimin duhet të ndërthuren nismat nga të gjitha nivelet e shoqërisë për të ngushtuar hapësirën e mundshme në të cilën mund të veprojnë grupet e ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, është e rëndësishme të dimë se cili është perceptimi i popullsisë në vend për riadhesimin dhe riintegrimin e shtetasve të rikthyer shqiptarë.

Në këtë kapitull bëhet një vlerësim i mbështetjes nga popullsia për riadhesimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre si dhe i mbështetjes mes shqiptarëve ndaj bashkive të tyre për të strehuar familjet e rikthyera. Ajo që vjen më pas është analiza e perceptimeve të publikut për rolin e autoriteteve fetare, institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm për të marrë përsëri të rikthyerit. Pastaj, për të kuptuar më mirë mundësinë e risocializimit të luftëtarëve të huaj me popullsinë, të anketuarit pyeten nëse besojnë se besimtarët radikalë fetarë ose terroristët e dënuar mund të shkëputen nga ideologjitë e tyre. Së fundmi, kapitulli eksploron se çfarë roli duhet të luajnë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm sipas popullsisë në vend duke identifikuar mundësuesit dhe faktorët e qëndruesës.

1. Shkëputja e radikalëve dhe terroristëve të dënuar

Anëtarët e grupeve të dhunshme ekstremiste shpesh i nënshtrohen një indoktrinimi të gjithanshëm, që i shtyn ata të zhvillojnë një botëkuptim të polarizuar dhe vendin që ata zënë në të. Mjedisi i marginalizuar shoqëror shpesh përforcon ideologjitë ekstremiste që këta individë kanë përqaftuar - duke penguar shkëputjen dhe duke nxitur rekrutimin. Në këtë pjesë shqyrtohet sa besojnë shqiptarët se besimtarët radikalë fetarë dhe terroristët e dënuar mund të shkëputen, veçanërisht duke bërë dallimin mes luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre.

Pohimet në këtë nënkaptull:

- Është e pamundur që besimtarët e radikalizuar fetarë të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare
- Është e pamundur që terroristët e dënuar të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste




Pohimi: Është e pamundur që besimtarët e radikalizuar fetarë të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Më shumë se gjysma e të anketuarve (56.1%) janë dakord me pohimin, ndërsa 25.2% nuk janë dakord, që do të thotë se 1 në 4 shqiptarë mendon se është e mundur që besimtarët e radikalizuar fetarë të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare. 1.7% e të anketuarve të sondazhit e konsiderojnë këtë pohim si pa lidhje, ndërsa 9.1% nuk dinin të jepnin një përgjigje.

Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (68%), me arsim deri në nivel fillor (80%), që jetojnë në zonat urbane (64%), ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit e grupmoshës 18-24 (51%), studentët (52%), të anketuarit e papunë (53%), dhe njerëzit që banojnë në zonat rurale (45%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Për më tepër, të anketuarit që luten/falen rregullisht (51%) praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (51%) janë më pak dakord me pohimin, që do të thotë se të anketuarit më fetarë shohin një mundësi që besimtarët e radikalizuar fetarë të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare.

Kur krahasohet me vitin 2018, 48.9% e të anketuarve ishin dakord se është e pamundur që besimtarët e radikalizuar fetarë të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare, që do të thotë se përqindja e të anketuarve që janë dakord me këtë pohim është rritur me 7.2 p.p.

Figura 42: A mund të shkëputen besimtarët radikalë fetarë? (N=1594) përkundër A mund të shkëputen të terroristët e dënuar? (N=1596)



Pohimi: Është e pamundur që terroristët e dënuar të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste

Të anketuarit u pyetën nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 64% e të anketuarve janë dakord se është e pamundur që terroristët e dënuar të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste, ndërsa 11.5% nuk janë dakord. 1.5% e të anketuarve të sondazhit e konsideronin këtë pyetje si pa lidhje, ndërsa 9.3% e tyre nuk dinin të jepnin një përgjigje.



Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç (72%), me arsim deri në nivel fillor (72%), që jetojnë në zonat urbane (64%), ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa studentët (58%), të anketuarit e papunë (60%), dhe njerëzit që banojnë në zonat rurale (56%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të anketuarit që luten/falen me raste apo që praktikojnë ritet kryesore të fesë së tyre janë më të prirur të bien dakord me pohimin, edhe pse ka dallime të vogla.

Me rëndësi shumë të madhe për përmirësimin e mundësive që besimtarët e radikalizuar fetarë dhe terroristët e dënuar të shkëputen nga ideologjitë e tyre është adoptimi i një qasjeje që përfshin të gjithë shoqërinë. Rezultatet e mësipërme sugjerojnë se riedukimi ideologjik i të rikthyerve në Shqipëri do të përballlet me mosbesimin e publikut në përgjithësi, që mund të çojë në stigmatizim. Edhe pse 1 në 4 shqiptarë shohin një mundësi për shkëputjen e besimtarëve të radikalizuar fetarë nga ideologjia e tyre radikale fetare, vetëm 11.5% e të anketuarve do të besonin se një terrorist i dënuar do të shkëputej nga ideologjia ekstremiste. Duke qenë se kuadri ligjor shqiptar parashikon ndëshkime të rënda, në disa raste edhe burgim për jetë për individët që përfshihen në veprimtari terroriste, përpjekjet e shkëputjes duhet të përqendrohen kryesisht tek institucionet e riedukimit.

Për të ndihmuar në përpjekjet e të rikthyerve për t'u riintegruar në shoqëri, komuniteti i punonjësve të P/LKEDH dhe aktorët e tjerë duhet të nxisin një debat konstruktiv që e ndihmon shoqërinë të krijojë një perceptim më optimist të mundësive të tyre për shkëputje. Në të njëjtën kohë, duhet të mundësohet një mjedis ushqyes që ndihmon të rikthyerit të zhvillojnë respektin për diversitetin dhe tolerancën si dhe u bën të mundur atyre që me kalimin e kohës të rimendojnë ndjenjën e përkatësisë. Duke marrë parasysh gjasat në rritje të besimtarëve praktikantë (pavarësisht nga përkatësia fetare) dhe të shqiptarëve myslimanë që besojnë se besimtarët radikalë dhe terroristët e dënuar mund të shkëputen nga ideologjia e tyre, këto grupe si dhe komunitetet fetare mund të luajnë një rol në krijimin e lidhjes së komunitetit pritës me familjet e rikthyer.

2. Perceptimi i qytetarëve për riatdhesimin, riintegrimin dhe rehabilitimin

Perceptimi i publikut për sa i përket riatdhesimit dhe riintegrimin të shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë vendit janë një temë me shumë interes për aktorët në vend dhe ata ndërkombëtarë të P/LKEDH, duke qenë se shqiptarët luajnë një rol të rëndësishëm në risocializimin e familjeve të rikthyer. Për të vlerësuar masat e mundshme që orientojnë veprimet e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë në trajtimin e të rikthyerve, të anketuarit u pyetën rreth perceptimit të tyre mbi riintegrimin e ish-luftëtarëve të huaj dhe shqiptarëve të tjerë dhe rolin e institucioneve në këtë proces.

Pohimet/pyetjet në këtë nënkaptull:


- Organet shtetërore duhet të riatdhesojnë dhe riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por që nuk kanë kryer krime.
- Organet shtetërore duhet të angazhohen për të riatdhesuar dhe riintegruar të gjithë shtetasit shqiptarë të përfshirë në konfliktet jashtë vendit.
- Unë nuk do ta kisha problem, nëse familjet e kthyer nga Siria do të bëheshin pjesë e komunitetit ku unë banoj.
- Si e vlerësoni rolin që duhet të kenë aktorët e mëposhtëm në rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga Siria

Pohimi: Organet shtetërore duhet të riadhesojnë dhe riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por që nuk kanë kryer krime.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Shumica e të anketuarve (63.3%) janë dakord me pohimin “Organet shtetërore duhet të riadhesojnë dhe riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por që nuk kanë kryer krime”, ndërsa 30.4% e kundërshtojnë këtë pohim. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 49.1% e të anketuarve ishin dakord, ka një rritje prej 14.2 p.p.


Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të konsiderueshme sipas gjinisë apo statusit të punësimit. Të anketuarit e moshës mbi 55 vjeç (të dy grupmoshat: 69%), me arsim deri në nivel fillor (75%), apo që banojnë në zonat urbane (69%) priren më shumë të jenë dakord me pohimin sesa të anketuarit me diplomë universitare (59%) apo ata që jetojnë në zonat rurale (56%). Besimtarët që nuk praktikojnë (60%) dhe të anketuarit që nuk luten/falen kurrë (55%) janë më pak të predispozuar për të qenë dakord me pohim se organet shtetërore duhet të riadhesojnë dhe riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por që nuk kanë kryer krime.

Figura 43: Organet shtetërore riintegrojnë të gjithë të rikthyerit (N=1,596) përkundër vetëm shtetasit shqiptarë që nuk kanë kryer krime (N=1596)



Pohimi: Organet shtetërore duhet të angazhohen për të riadhesuar dhe riintegruar të gjithë shtetasit shqiptarë të përfshirë në konfliktet jashtë vendit.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (52.3%) janë dakord se organet shtetërore duhet të angazhohen për të riadhesuar dhe riintegruar të gjithë shtetasit shqiptarë të përfshirë në konfliktet jashtë vendit, ndërsa 40.9% nuk janë dakord. Krahasuar me sondazhin e vitit 2018, kur 61.5% ishin dakord me pohimin ‘organet shtetërore duhet të angazhohen për të riadhesuar




dhe riintegruar të gjithë shtetasit shqiptarë të përfshirë në konfliktet jashtë vendit,⁵⁰ ka një rënie prej 9.2 p.p.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, statusit të punësimit, apo vendbanimit. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare (68%) janë më shumë dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit e grupmoshës 18 to 24 vjeç (46%) me arsim deri në nivel fillor (44%), apo studentët (45%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të intervistuarit që nuk praktikojnë asnjë ritual fetar (43%) apo që luten/falen me raste apo në kohë krizash personale apo familjare (47%) janë më pak të prirur për të miratuar pohimin se organet shtetërore duhet të angazhohen për të riatdhesuar dhe riintegruar të gjithë shtetasit shqiptarë të përfshirë në konfliktet jashtë vendit.

Pohimi: Unë nuk do ta kisha problem, nëse familjet e kthyer nga Siria do të bëheshin pjesë e komunitetit ku unë banoj.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Të anketuarit ishin të ndarë në opinionin e tyre, me një shumicë të vogël që ishin dakord apo plotësisht dakord (47.4%) përkundër 44% të të anketuarve që nuk janë dakord. Të anketuarit meshkuj (50%), të anketuarit me arsim pasuniversitar (58%) apo ata që banojnë në zonat urbane (50%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit femra (45%), të anketuarit e moshës 45-54 vjeç (41%) apo që jetojnë në zonat rurale (44%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord. Të anketuarit që luten/falen rregullisht (55%) apo ata që praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre (55%) janë më të prirur të pranojnë familjet e rikthyer nga Siria në komunitetin e tyre.

Figura 44: Pranimi i familjeve të rikthyer nga Siria në komunitetin e të anketuarve (N=1589)




50 Vini re se fjala “të gjithë” është përfshirë në pohimin e përdorur në sondazhin e këtij viti për ta bërë më të qartë dallimin mes dy pohimeve në këtë pjesë.

Pyetje: Si e vlerësoni rolin që duhet të kenë aktorët e mëposhtëm në rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria?

Duke pasur parasysh qëndrimet e të anketuarve ndaj riintegrit të ish luftëtarëve të huaj dhe të rikthyerve të tjerë, është me interes të analizohet roli që ata i caktojnë aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë në procesin e riintegrit. Prandaj, të anketuarve iu kërkua t'i përgjigjeshin pyetjes 'Si e vlerësoni rolin që duhet të kenë aktorët e mëposhtëm në rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria?' duke përdorur një shkallë me 5 pikë nga "asnjë rol" (1) në "rol shumë të rëndësishëm" (5).

Të gjithë institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore të përmendura më sipër u perceptuan se kanë një rol (relativisht) të rëndësishëm për të luajtur në rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria, sipas të anketuarve. 81.8% e të intervistuarve i atribuojnë një rol (relativisht) të rëndësishëm qeverisë qendrore. Roli i dytë më i rëndësishëm u caktohet shkollave (78.9%), ndërsa komunitetet fetare (78.2%) vijnë të tretët. 75.3% e të anketuarve mendojnë se një rol relativisht të rëndësishëm ose të rëndësishëm kanë organizatat e shoqërisë civile, të cilat ndiqen nga pushteti vendor, që 73.8% e të anketuarve i caktojnë një rol të rëndësishëm. Mes opsioneve të listuara, media perceptohet se ka rolin më të vogël në procesin e riintegrit dhe rehabilitimit. Gjithsesi, të paktën 6.5% e kampionit zgjedhën ta konsiderojnë si aktorin më ndikim më të madh në rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria. 3.9% thonë se familja luan një rol të rëndësishëm në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, ndërsa 1.3% mendojnë se një rol të rëndësishëm luan i gjithë komuniteti. Katër të anketuar përmendin në mënyrë specifike rolin e sistemit të drejtësisë dhe 13 të anketuar vunë në dukje se të gjitha institucionet bashkërisht luajnë një rol shumë të rëndësishëm për rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria.

Figura 45: Roli i aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë në rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga Siria



Sipas shumicës së të anketuarve, qeveria qendrore, shkollat, komunitetet fetare dhe bashkitë kanë rolin më të rëndësishëm për të luajtur kur bëhet fjalë për rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga zonat e konfliktit. Gjithsesi, mbështetja e komunitetit pritës është po aq e rëndësishme për riintegrimin e suksesshëm të të rikthyerve nga Siria. Edhe pse pjesa më e madhe e popullsisë në vend beson se organet shtetërore duhet të riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konfliktit jashtë kufijve të vendit por që nuk kanë kryer krime, vetëm 1 në 2 shqiptarë mbështet riatdhesimin dhe riintegrimin e të gjithë shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë vendit (që do të thotë se përfshihen edhe ata që kanë kryer krime). Për më tepër, kur bëhet fjalë për pranimin e familjeve të tilla të rikthyera në komunitetin e tyre, vetëm 47% e shqiptarëve nuk do ta kishin problem. Të anketuarit e mëdhenj në moshë, njerëzit me arsim fillor dhe ata që janë në zonat urbane kanë më shumë gjasa të mbështesin riintegrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer që nuk kanë kryer krime, ndërsa njerëzit me një diplomë pasuniversitare kishin më shumë gjasa të mbështesnin riatdhesimin dhe riintegrimin edhe të luftëtarëve të huaj.

Mospërputhja mes nivelit të pranimit të shqiptarëve të rikthyer nga Siria dhe rëndësisë së miratimit nga shoqëria të këtyre individëve në shoqërinë shqiptare nxjerr në pah nevojën për një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi nëpërmjet të cilit të informohen të gjithë aktorët për hapat që duhet të ndërmerren me qëllim që të ndihmojnë të rikthyerit të kapërcejnë pengesat praktike dhe ato që lidhen me sigurinë. Nëse të rikthyerit mirëpritën në një komunitet që u ofron atyre rjetet shoqërore mbështetëse, mundësitë për punë dhe të hartojnë strategji të shëndetshme për trajtimin e traumave, mundësia për rehabilitim të suksesshëm rritet në mënyrë të konsiderueshme. Gjetjet sugjerojnë se të rikthyerit gjejnë një mjedis më mikpritës mes shqiptarëve që luten/falen rregullisht apo që praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre, mes njerëzve me diplomë pasuniversitare dhe mes atyre që jetojnë në zonat urbane, të cilët janë më të hapur kur vjen puna tek pranimi në komunitetet e tyre i familjeve të rikthyera.

3. Autoritetet fetare dhe përgatitja e institucioneve fetare për të pranuar të rikthyerit

Roli i klerikëve fetarë në komunitet dhe formimi i tyre fetar janë me rëndësi tejet të madhe në drejtim të ndihmës për ish-anëtarët e grupeve ekstremiste që të krijojnë aftësitë e të menduarit kritik me qëllim që të kuptojnë procesin e manipulimit dhe që të shkëputen prej tij. Niveli i besimit dhe i mbështetjes që gëzojnë komunitetet fetare është vendimtar jo vetëm për vlerësimin e rolit të tyre në ri-integrimin e të rikthyerve, por edhe në identifikimin e formave të mundshme të kundërshtimit ndaj qëndrimeve zyrtare të komuniteteve fetare përkatëse ose vatrave të nxehta që kundërshtojnë autoritetin e tyre.

Pohimet në këtë nënkaptull:

- Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj.
- Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të madh tek besimtarët.
- Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar.
- Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare.


Pohimi: Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Shumica e të anketuarve, 58.2%, janë dakord, ndërsa 15.2% e tyre e kundërshtojnë këtë pohim. 3.3% thanë se e konsideronin pohimin si pa lidhje dhe 23.1% nuk kishin asnjë ide si përgjigje. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 55.0% ishin dakord me pohimin, ka një rritje prej 3.2 p.p. në numrin e të anketuarve që janë dakord se qëndrimet e kreut të komunitetit të tyre fetar gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetojnë të anketuarit.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo vendbanimit. Të anketuarit e moshës 18-24 vjeç (50%), 25-34 vjeç (54%), të anketuarit me arsim universitar (51%) dhe studentët (52%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit e moshës mbi 65 vjeç (72%), ishin më shumë të prirur për të rënë dakord. Ky pohim gjeti më pak mbështetje në bashkitë Devoll, Bulqizë, Mallakastër, Patos, Mat, Sarandë, Dibër, Roskovec, dhe Ura Vajgurore.

Të intervistuarit ortodoksë (72%), katolikë (66%), dhe bektashinj (65%) ishin dakord me pohimin më shumë se ata të anketuar me përkatësi tjetër fetar. Të anketuarit që praktikojnë fenë (ata që praktikojnë të gjithë ritualet fetare apo që luten rregullisht) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin sesa ata që e praktikojnë fenë më pak.

Figura 46: Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj (N=1586)




Pohimi: Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të madh tek besimtarët

Të pyetur për t'iu përgjigjur pyetjes “Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të madh tek besimtarët” duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4), 49.3% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 23.8% nuk ishin dakord. 1 në 4 të anketuar nuk ishte i sigurt nëse duhet të binte dakord apo jo. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 43.3% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka një rritje prej 6.0 p.p. në numrin e të anketuarve që mendojnë njësoj me pohimin.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk u vunë re dallime sipas gjinisë. Të anketuarit e moshës 45-54 vjeç (54%), me arsim fillor (60%), apo që banojnë në zonat urbane (51%) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me pohimin, ndërsa Të anketuarit e moshës 18 to 24 vjeç (42%), 25-34 vjeç (46%), të anketuarit që banojnë në zonat rurale (47%), të anketuarit me arsim universitar (40%) ishin më pak të prirur për ta miratuar këtë pohim. Të intervistuarit që jetojnë në Bulqizë, Mallakastër, Maliq, Shijak, Devoll, Sarandë, Gjirokastrë, Patos, Vlorë, ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin.

Të intervistuarit myslimanë (49%) dhe bektashinj (48%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin se kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetojnë ka ndikim të madh tek besimtarët, ndërsa besimtarët praktikantë (të anketuarit që luten/falen rregullisht dhe/ose praktikojnë të gjitha ritet e fesë së tyre) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord (73% dhe 72% përkatësisht).

Figura 47: Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të madh tek besimtarët (N=1579)




Pohimi: Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar

Të anketuarve iu kërkua të tregonin mbështetjen ndaj pohimit të mësipërm duke përdorur një shkallë me 4 pikë nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). 23.8% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 36.5% nuk janë dakord. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve, 36.8%, nuk dinin të jepnin një përgjigje përfundimtare. Kur krahasohet me vitin 2018, kur 23.7% e të anketuarve ishin dakord me pohimin dhe 39.6% nuk e dinin nëse në komunitetin e tyre fetar ka klerikë pa arsimin/formimin e duhur fetar, përgjigjet nuk kanë ndryshime të dukshme.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas moshës, statusit të punësimit, vendbanimit, apo rregullsisë së praktikimit të fesë. 26% e të anketuarve meshkuj dhe 21% e atyre femra e miratonin këtë pohim. Të intervistuarit me diplomë pasuniversitare (39%), dhe të anketuarit myslimanë (26%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa ata të besimit bektashian (15%) dhe ortodoks (19%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord.

Figura 48: Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar (N=1591)




Pohimi: Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 45.7% e të anketuarve janë dakord njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare, ndërsa 40.6% e të anketuarve nuk janë dakord. 10.3% e të anketuarve nuk e dinin të jepnin një përgjigje përfundimtare në lidhje me pohimin dhe 3.4% e konsideronin pohimin si pa lidhje.

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas moshës apo përkatësisë fetare. 48% të anketuarve meshkuj dhe 44% të anketuarve femra janë dakord me pohimin. Të anketuarit me arsim fillor (51%), ata që banojnë në zonat rurale (49%), ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit që banojnë në zonat urbane (43%), edhe ata që janë të vetëpunësuar (39%) ishin më pak të prirur të kishin mendim pro. Besimtarët praktikantë (të anketuarit që luten/falen rregullisht dhe/ose praktikojnë të gjitha ritet e fesë së tyre) ishin më pak të prirur për të rënë dakord se njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare (të dy grupet me 41%).

Figura 49: Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare (N=1595)



Gjetjet nën këtë nënkapitull tregojnë se ekziston një terren pjellor për zhvillimin e programeve të riintegritimit dhe parandalimit në të cilat parashikohet një rol më i madh për klerikët fetarë shqiptarë. Besimtarët praktikantë përbëjnë shumicën e të anketuarve në sondazh të cilët janë të mendimit se kryetari i komunitetit të tyre fetar gëzon mbështetjen e plotë të besimtarëve në vend (58%), dhe se klerikët fetarë në komunitetin e tyre kanë një ndikim të madh te besimtarët (49%). Ashtu si në vitin 2018, shqiptarët i perceptojnë klerikët fetarë vendorë si disi më pak me ndikim sesa kryetarët e komuniteteve fetare në Tiranë, duke evidentuar se ekziston ende nevoja për të forcuar rolin e institucioneve fetare në nivelin vendor.

Hapi i parë drejt fuqizimit të institucioneve fetare është përmes edukimit. Klerikët pa arsimin e duhur fetar (edhe nëse kjo është vetëm në perceptimin e besimtarëve) mund të minojnë besueshmërinë e komunitetit fetar përkatës dhe me gjasa të rrisin mundësitë për përqaftimin e komuniteteve fetare jozyrtare, idetë dhe vlerat e tyre. Një në katër shqiptarë, veçanërisht ata me një diplomë pasuniversitare, beson se në komunitetin e tyre fetar ka klerikë pa arsimin e duhur fetar. Këtë mendim e ka edhe një në katër besimtarë praktikantë. Kjo duhet të nxisë të gjithë aktorët të reflektojnë në çdo aspekt për gjendjen e arsimit fetar në Shqipëri, me qëllim që të vlerësojnë nëse arsimi fetar në Shqipëri i plotëson të gjitha nevojat e komunitetit të besimtarëve, klerikëve fetarë dhe predikuesve. Për më tepër, rritja e transparencës në lidhje me formimin arsimor të klerikëve fetarë do të përmirësonte ndjeshëm perceptimin e publikut dhe do të kontribuonte në krijimin e besimit mes autoritetit fetar dhe besimtarëve.

Së fundi, është përgjegjësia e të gjithë komunitetit të parandalojë që njerëzit të ndjekin interpretime fetare që devijojnë nga qëndrimi zyrtar i komunitetit të tyre fetar. 45.7% e shqiptarëve janë të mendimit që njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime jo zyrtare fetare nëse nuk pajtohen me interpretimin e bashkësive të tyre zyrtare fetare. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit që shihen si “të cenueshëm” (me nivel të ulët arsimor, që banojnë në zonat rurale) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me këtë pohim, ndërkohë që besimtarët praktikantë ishin më pak të prirur për ta miratuar atë. Po të marrim në konsideratë ndikimet e huaja në çështjet fetare - jo vetëm se shumë klerikë u arsimuan jashtë vendit - nuk është habi që po gjen më shumë përkrahje ndjekja e interpretimeve jozyrtare fetare. Megjithatë, kur propaganda nuk mbahet në monitorim nga një autoritet qendror dhe i njohur zyrtarisht, në vend mund të kemi përhapjen e më shumë interpretimeve radikale dhe jotolerante fetare. Këto interpretime mund të bëjnë që njerëzit të jenë më pak të lidhur me mjedisin e tyre fizik, me njerëzit e besimeve të tjera, apo edhe me mjedisin tolerant të Shqipërisë. Prandaj, është me rëndësi që komunitetet zyrtare fetare të mbeten tolerantë ndaj interpretimeve të tjera të së njëjtës fe, të jenë gjithëpërfshirëse ndaj ideve të tjera, për të siguruar që të gjithë besimtarët të përfaqësohen në komunitetin e tyre fetar.

Për riintegrimin e të rikthyerve nga Siria më konkretisht, do të jetë më se e nevojshme që klerikët fetarë në vend të lidhen me të rikthyerit dhe familjet e tyre. Përmes rritjes së kontakteve dhe këshillimit, klerikët mund t'i ftojnë familjet e ish-ekstremistëve të rikthehen në komunitetet zyrtare myslimane. Për këtë qëllim, klerikët fetarë në nivel qendror e vendor duhet të punojnë për rritjen e shkëmbimit të informacionit me aktorët e tjerë dhe të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për ndërtimin e një komuniteti koheziv.

4. Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm

Në këtë studim të anketuarve iu bë një sërë pyetjesh për të marrë mendimin e tyre për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, për faktorët mundësues apo të qëndresës dhe se cilët janë aktorët më të rëndësishëm me role specifike në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Pohimet/pyetjet në këtë nënkapitull:

- Sipas jush, cilat janë TRE arsyet kryesore që krijojnë ose nxitin radikalizimin fetar tek individët në Shqipëri?
- Sipas jush, cilët janë TRE aktorët më të rëndësishëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri?
- Sipas jush, cilët janë TRE faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë fetare ekstremiste?

Pyetja: Sipas jush, cilat janë TRE arsyet kryesore që krijojnë ose nxitin radikalizimin fetar tek individët në Shqipëri?

Të anketuarve iu kërkua të thonin mendimin e tyre në lidhje me tre aktorët kryesorë që krijojnë apo radikalizimin fetar tek individët në Shqipëri. Në Tabelën 5 më poshtë jepet shpeshësia e përgjigjeve të të anketuarve për faktorët mundësues. Arsyet ekonomike, si papunësia dhe varfëria, ishin përgjigja më e shpeshtë si faktor mundësues (66%), pasuar nga niveli i ulët arsimor (54.2%), izolimi shoqëror (36.8%), ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetare (35.5%), dhe niveli i ulët i njohurive fetare (31.7%). Më shumë se një e katërta e të anketuarve e konsiderojnë të shkuarën kriminale (njerëz me precedent penal) si faktor të mundshëm mundësues të rrugës së një individi drejt radikalizimit fetar. Paaftësia e institucioneve shtetërore (23.3%) dhe e klerikëve (13.6%) perceptohet më rrallë si faktori mundësues më i rëndësishëm për ekstremizmin e dhunshëm fetar. Interesant është fakti se kur e shqyrtojmë në aspektin e përkushtimit për të ushtruar besimin, të anketuarit që janë besimtarë praktikantë (njerëzit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet e fesë së tyre dhe/ose luten/falen rregullisht) i konsiderojnë arsyet ekonomike si dhe nivelin e ulët të njohuri fetare si faktorët më të rëndësishëm.

Tabela 5: Mendimi i të anketuarve për faktorët kryesorë që mundësojnë ose nxisin radikalizimin fetar

Fajtori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Arsyet ekonomike (p.sh. papunësia, varfëria etj.)	1048	65.5%
Niveli i ulët arsimor	861	53.8%
Izolimi shoqëror	585	36.6%
Ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetarë	564	35.3%
Niveli i ulët i njohurive fetare	503	31.4%
E shkuara kriminale (persona me precedent penal)	423	26.4%
Paaftësia e institucioneve shtetërore	372	23.3%
Paaftësia e klerit	218	13.6%

Shënim: Kjo është pyetje me shumë përgjigje alternative. Përqindjet nuk përmbushin të gjithë 100%. Numri i rasteve = 4579. Numri i përgjigjeve = 1548.



Në 2018, faktorët të përzgjedhur ishin niveli i ulët arsimor (67.0%), arsyet ekonomike (61.6%), dhe niveli i ulët i njohurive fetare (40.7%) si faktorët mundësues më kryesorë për ekstremizmin e dhunshëm fetar. Krahasuar me gjetjet e këtij sondazhi, përqindja e të anketuarve që mendojnë ndikimin e grupeve të huaja radikale fetare si faktor kryesor është rritur me 8.3 p.p., ndërsa niveli i ulët arsimor përmendet më pak në këtë sondazh.

Pyetja: Sipas jush, cilët janë TRE aktorët më të rëndësishëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri?

Të pyetur se cilët janë aktorët më të rëndësishëm në parandalimin e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm fetar në Shqipëri, të anketuarit mendojnë se janë qeveria qendrore (44.5%), drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare (38.7%), dhe shkollat (29.5%) si tre aktorët më të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit fetar. Media perceptohet si aktor me ndikim nga 26.7% e të anketuarve, ndërsa rreth një e katërta e të anketuarve u japin rëndësi klerikëve vendorë, institucioneve të zbatimit të ligjit (policia, prokuroria, gjykatat) ose shoqërisë civile. Pushteti vendor (21.5%), shërbimet e mirëqenies sociale (20.2%) dhe besimtarët fetarë (14.2) perceptohen më rrallë si aktorë me rëndësi në parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri. 1.1% e të anketuarve vendosën të thonë “të tjerë”, i cili sipas 12 të anketuarve është ‘familja’ (shih Tabelën 6).

7% të anketuarve femra dhe 5% të anketuarve meshkuj besojnë se gratë janë një nga tre aktorët më të rëndësishëm për parandalimin të ekstremizmit fetar në Shqipëri. Të anketuarit me nivel më të ulët arsimor prirën t’i japin rëndësi rolit të shkollave në parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar. Po ashtu, të anketuarit që i praktikojnë të gjitha ritualet e fesë së tyre dhe që luten/falen rregullisht ose të paktën me raste sipas festave zyrtare fetare gjatë një viti prirën të mendojnë se janë klerikët vendorë dhe drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare si aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri.

Tabela 6: Aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri

Aktori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Pushteti Qendror (qeveria, ministritë)	701	44.5%
Drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare	609	38.7%
Shkollat	464	29.5%
Media	421	26.7%
Klerikët lokalë	395	25.1%
Institucionet ligjzbatuese (policia, prokuroria, gjykatat)	395	25.1%
Shoqëria civile	383	24.3%
Pushteti vendor (Bashkia)	338	21.5%
Shërbimet e ndihmës sociale	318	20.2%
Besimtarët	225	14.3%
Të rinjtë	199	12.6%
Gratë	95	6.0%

Aktori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Të tjerë	17	1.1%
Nuk e di / Refuzim	46	2.9%

Shënim: Kjo është pyetje me shumë përgjigje alternative. Përqindjet nuk përmbushin të gjithë 100%. Numri i rasteve = 4606. Numri i përgjigjeve = 1600.


Në vitin 2018, drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare, media, dhe klerikët vendorë konsideroheshin si tre aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri. Kjo do të thotë se rëndësia e mediave dhe klerikëve vendorë - në perceptimin e të anketuarve - ka rënë, ndërsa qeveria qendrore dhe shkollat kanë marrë një rol edhe më të madh. Për më tepër, krahasuar me rezultatet e vitit 2018, gratë perceptohet se luajnë një rol më të rëndësishëm në frenimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri. Ndërkohë që në 2018 3.6% e të anketuarve zgjodhën gratë si aktorin kryesor, në 2021 6.0% e të anketuarve i konsiderojnë gratë si të rëndësishme në parandalimin e ekstremizmit fetar në Shqipëri.

Pyetja: Sipas jush, cilët janë TRE faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë fetare ekstremiste?

Së fundi, në sondazh iu kërkua të anketuarve të evidentonin faktorët e qëndresës që mendohet se janë të rëndësishëm për rehabilitimin dhe ri-integrimin e shqiptarëve të rikthyer nga Siria. Të anketuarve iu kërkua të rendisnin tre faktorët kryesorë, të cilët sipas tyre, ndihmojnë që individët të refuzojnë ideologjitë ekstremiste fetare. Përgjigjet u grupuan në nëntë kategori kryesore, duke filluar me përgjigjet më të shpeshta që kishin të bënin me lidhjet familjare, mbështetjen nga familja e një individi në procesin e shkëputjes, si dhe nga komuniteti. Shumica e të anketuarve i perceptojnë njohuritë - qoftë arsimin apo informacionin e saktë fetar - si faktorë të rëndësishëm që mund të frenojnë shtrirjen dhe ndikimin e ekstremistëve fetarë. Edhe pse shumica e të anketuarve i konsiderojnë arsyet ekonomike si faktorin më shpesh të raportuar që mundëson radikalizimin fetar të individëve, situata e mirë financiare dhe ekonomike për shqiptarët si faktor qëndresë renditet në vendin e katërt (27%). Ndërkohë që në vitin 2018, faktori kryesor i qëndresës për shumicën e të anketuarve ishte kultura dhe tradita shqiptare e tolerancës fetare, në 2021 ky faktor raportohet shumë më pak (9%).

Tabela 7: Faktorët e qëndresës ndaj ekstremizmit të dhunshëm

Faktori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Marrëdhëniet e ngushta shoqërore, ndikimi i familjes dhe komunitetit	993	68%
Arsimi	669	46%
Edukimi dhe informimi i duhur fetar	519	35%
Situata e mirë financiare dhe ekonomike	396	27%
Frika nga pasojat	303	21%
Shteti (institucionet, reformat, veprimet)	215	15%



Faktori	Nr. i përgjigjeve	Përqindja e rasteve
Kultura dhe tradita e tolerancës fetare në Shqipëri	129	9%
Ateizmi apo indiferenca fetare	111	8%
Media	84	6%

Shënim: Kjo është pyetje me shumë përgjigje alternative. Përqindjet nuk përmbushin të gjithë 100. Total Numri i rasteve = 3419. Total Numri i përgjigjeve = 1467.

Në vitet e mëvonshme, Shqipëria do të përballet me rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve të saj të kthyer nga Siria. Përveç sfidave në praktikë, problem kryesor për qeverinë shqiptare është të sigurojë që të rikthyerit të mos përbëjnë rrezik për sigurinë në të ardhmen. Në këtë drejtim, krijimi i komuniteteve të qëndrueshme dhe ngushtimi i hapësirave që mundësojnë funksionimin e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm janë objektiva kryesore për komunitetet pritëse. Për parandalimin e përhapjes në komunitet i propagandës së ekstremizmit të dhunshëm kërkohet angazhimi i aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë në nivel qendror e vendor.

Në këtë nënkapitull, të anketuarit iu kërkua të ndanin mendimin e tyre, se cilët janë faktorët kryesorë që mundësojnë ose nxisin radikalizimin fetar te individët në Shqipëri. Tre faktorët që u përmendën më shpesh që çojnë në ekstremizëm fetar sipas të anketuarve në Shqipëri janë arsyt ekonomike (p.sh. papunësia, varfëria, etj.), niveli i ulët arsimor dhe përjashtimi social. Ndërthurur me gjetjet nga nxitësit socio-ekonomikë, politikë dhe kulturorë, perceptimet e opinionit publik evidentojnë nevojën e një strategjie të përshtatur për trajtimin e çështjeve që janë specifike për komunitetet e cenushme në vend të një strategjie që bazohet në ideologji dhe që fokusohet vetëm te feja. Strategjia gjithëpërfshirëse P/ LKEDH duhet të trajtojë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm dhe duhet të orientohet nga parimet e qëndresës së komunitetit dhe dialogut gjithëpërfshirës.

Edhe këtë vit ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetarë dhe niveli i ulët i njohurive fetare renditen ndër pesë faktorët kryesorë që nxisin ekstremizmin fetar. Drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare përgjithësisht perceptohen se kanë një rol mjaft të rëndësishëm për parandalimin në krahasim me klerikët vendorë, duke ritheksuar nevojën për të fuqizuar autoritetet fetare në nivel vendor, siç u përmend më sipër. 35% e anketuarve të sondazhit përmendën informimin dhe edukimin e duhur fetar mes faktorëve që mundësojnë qëndresën, ndërkohë që kultura dhe tradita e tolerancës fetare në Shqipëri u rendit ndër faktorët më pak të konsiderueshëm që bëjnë që individët të refuzojnë ideologjitë ekstremiste fetare. Këto gjetje bëjnë të nevojshme kryerjen e një vlerësimi të sfidave institucionale dhe sociale me të cilat përballen autoritetet fetare, sfida që bëhen pengesë që këto autoritete të luajnë një rol më të madh në përpjekjet parandaluese.

Të pyetur për tre aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri, të anketuarit përmendën qeverinë qendrore, drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare dhe shkollat. Besimtarët praktikantë ka më shumë të ngjarë të mendojnë se klerikët vendorë dhe drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare si aktorët më të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit fetar në Shqipëri. Është me interes të evidentohet se kur bëhet fjalë për një individ që refuzon një ideologji fetare ekstremiste, shqiptarët nuk sjellin në mend institucionet, por komunitetin dhe rrethin shoqëror si faktorë kryesorë. Marrëdhëniet e ngushta shoqërore, familja dhe ndikimi i komunitetit; arsimit; dhe informimi/ edukimi i duhur fetar shihen si faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë ekstremiste fetare. Këto konstatime rikonfirmojnë se për të deradikalizuar dhe risocializuar ish ekstremistët kërkohet një qasje me shumë aktorë, ku të bëjnë pjesë aktorët shtetërorë e jo-shtetërorë.

7. Përfundime dhe rekomandime

Çfarë e nxit ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri?

Në kërkim të shpjegimeve pse individë të caktuar bëhen pjesë e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm, si hulumtuesit ashtu edhe punonjësit e sektorit shpesh i referohen shkaqeve të ndryshme kryesore, faktorit strukturor dhe kushteve themelore. Faktorët e tjerë më të gjerë social-ekonomikë dhe politikë, si nevojat e papërmbushura sociale dhe ekonomike, pritshmëritë e dështuara, dhe pamjaftueshmëria e pavarësisë, efektivitetit dhe llogaridhënies së pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, shpesh përmenden më pak.⁵¹ Pas vlerësimit të parë bazë në vitin 2015 dhe më pas, të një vlerësimi në nivel kombëtar të nxitësve, formave dhe rreziqeve të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, të kryer në vitin 2018, në studim analizohet situata aktuale pas pothuajse gjashtë vitesh punë në drejtim të luftës/parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorëve nxitës të lidhur me to dhe që ushqejnë apo mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm. Studimi synon të paraqesë karakteristikat kryesore të ekstremizmit të dhunshëm, shtrirjen dhe madhësinë e tij, komunitetet në rrezik, zonat dhe grupet e cenueshme, rreziqet dhe implikimet e tjera që lidhen me përmirësimin e kapaciteteve të P/LKEDH dhe ndikimit që kanë nismat në këtë fushë në Shqipëri. Edhe pse ky studim nuk trajton në mënyrë shteruese të gjithë nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht ata në nivel individ, ai përcakton 17 nxitës të grupuar në tre kategori që konsiderohen se vlejné për situatën në Shqipëri.

Në studimet e mëparshme të viteve 2015 dhe 2018, disa bashki shfaqën mbështetje shumë më të madhe për pohime të caktuara tek nxitësit social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë në krahasim me mesataren kombëtare. Këto të ashtuquajtura “vatra të nxehta” nuk u vëzhguan në këtë studim: vetëm bashkitë me një numër të vogël të anketuarish që marrin më shumë pikë se mesatarja kombëtare në më shumë se gjysmën e pohimeve të zgjedhura.⁵² Tek nxitësit social-ekonomikë, u vunë re përmirësime të konsiderueshme në drejtim të rritjes së numrit të njerëzve të mirë arsimuar që kanë siguruar vende të mira pune, të institucioneve shtetërore në nivel vendor që veprojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime, dhe rënie të numrit të njerëzve që pranojnë të angazhohen në aktivitete të paligjshme ekonomike. Mjekra e gjatë dhe shamia për mbulimin e kokës perceptohen nga një numër më i vogël njerëzish si shenjë e ekstremizmit dhe më shumë të anketuar besojnë se komuniteti i tyre fetar është i mirë përfaqësuar në politikë dhe në institucionet shtetërore. Po ashtu, nxitësit politikë tregojnë se është rritur numri i njerëzve që mendojnë se të drejtat dhe liritë e qytetarëve respektohen nga institucionet shtetërore, se shteti po luan një rol më të madh në ofrimin e shërbimeve publike sesa në vitin 2018, dhe se ka rënë mbështetja për lejimin e nxitjes ose pjesëmarrjes në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit. Është rritur ndjeshëm edhe gatishmëria e popullatës shqiptare për të marrë qytetarët e rikthyer shqiptarë që kanë jetuar në



51 Denoeux, G. and Carter, L. (2009). Guide to the Drivers of Violent Extremism. USAID. Gjetet në adresën: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf

52 Bashkitë Pukë, Fushë-Arrëz, Patos, Vau i Dejës, dhe Mat shënuan përqindje të larta në thuajse gjysmat e pohimeve, ndërsa Memaliaj, Kukësi, Kurbini, Gjirokastra dhe Mallakastra shënuan përqindje të larta në 7 ndër 19 pohime.



zonat konflikti si Siri, qoftë kjo edhe në komunitetin e tyre. Në të njëjtën kohë, shqiptarët duket se janë më të ndërgjegjësuar për sfidat që kanë përpara. Është rritur numri i njerëzve që kuptojnë ndikimin e huaj te komunitetet fetare dhe që shkëputja e ish ekstremistëve apo të të rikthyerve do të jetë e vështirë. Nga ana tjetër, mungesa e mundësive social-ekonomike, situata e demokracisë, dhe funksionimi i shtetit ligjor si dhe perceptimet për marginalizimin mund të rrezikojë grupe të caktuara në shoqëri nëpërmjet fuqisë së manipulimit të ideologjive ekstremiste. Në këtë pjesë përshkruhen më tej gjetjet më të rëndësishme tek nxitësit social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë dhe përhapja e tyre në kontekstin shqiptar.

Nxitësit socio-ekonomikë – Dihet se faktorë të tillë si varfëria absolute apo relative, fragmentimi social, përjashtimi social, diskriminimi dhe veprimtaria e paligjshme ekonomike sjellin zhgënjimin me sistemin politik dhe ekonomik. Mbi 80% e shqiptarëve thonë se në zonën ku banojnë ka shumë familje apo individë që nuk përmbushin dot nevojat bazë të jetesës dhe se shumë të rinj kanë rënë pre e sjelljeve të rrezikshme. Kur nevojat e papërmbushura ndërthuren me trajtimin e padrejtë të qytetarëve nga institucionet shtetërore (fenomene që po marrin më shumë përhapje për shkak të pandemisë), mund të lindë ndjenja e pakënaqësisë me shtetin dhe shoqërinë. Në mënyrë të veçantë, të rinjtë e papunë apo të izoluar mund të jenë të cenueshëm nga propaganda e ideologjive ekstremiste që mbrojnë përdorimin e dhunës për të protestuar kundër rendit ekzistues dhe për të bërë të mundur ndryshimet e dëshiruara si dhe për përfitime personale. Sipas gjysmës së popullsisë në vend, të gjithë e duan pasurimin e shpejtë, pavarësisht se si arrihet ai. Një në tre shqiptarë, veçanërisht ata me nivel të ulët arsimor, ka dëshirë të përfshihet në veprimtari të paligjshme ekonomike për të siguruar bukën e përditshme dhe po e njëjta përqindje tregon se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banojnë nuk vjen nga puna e ndershme. Propaganda e ekstremizmit të dhunshëm mund të jetë veçanërisht tërheqëse për ta për shkak të premtimeve për punëve me fitim dhe zonave të përbashkëta të veprimit.

Perceptimet për diskriminimin shoqëror ndaj një individi apo komuniteti (ose të dyjave) mund të jetë në një kuptim të gjerë nxitës i ekstremizmit të dhunshëm. Ndonëse në Shqipëri diskriminimi shoqëror me motiv fetar nuk evidentohet dukshëm, ngaqë shumica e shqiptarëve janë tolerantë ndaj grupeve të tjera fetare, ka disa faktorë që kërkojnë vëmendjen e aktorëve përkatës. 1 në 4 bëjnë lidhjen e mjekrës së gjatë apo shamisë së mbulimit të kokës me ekstremizmin e dhunshëm, gjë që nxjerr në pah perceptimin e shtrembëruar për fenë. 38.8% e shqiptarëve do të refuzonin një punë të mirë apo përfitim ekonomik që nuk u lejohet nga feja e tyre. Të paktën 12% e shqiptarëve thonë se njerëzit me përkatësi të njëjtë fetare përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik e social për shkak të kësaj përkatësie. 38.1% thonë se komuniteti fetar tek i cili bëjnë pjesë nuk është mjaftueshëm i përfaqësuar në politikë. Ndërkohë, vihet re një rritje e konsiderueshme të grupeve fetare që ofrojnë të mira ekonomike apo materiale për ata që praktikojnë fenë e tyre, krahasuar me vitin 2018.

Nxitësit politikë – Nxitësit politikë lidhen me gjendjen aktuale dhe të perceptuar të demokracisë, qeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor në një vend. Edhe pse kanë kaluar 30 vjet që nga rënia e sistemit komunist, Shqipëria mbetet ende shumë larg sistemit të një demokracie të konsoliduar. Në pesë vitet e fundit, pavarësia, efektiviteti dhe llogaridhënia e pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv nuk janë përmirësuar, gjë që ndikon në besimin e qytetarëve te qeverisja dhe shteti ligjor. Ndonëse disa nxitës shihen si më pak alarmantë se në vitin 2018, si nxitësi “zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët”, për të cilën numri i shqiptarëve që janë plotësisht dakord me këtë pohim ka rënë me 15 p.p., pjesa më e madhe e nxitësve konsiderohen se janë më të rëndësishëm se në 2018. Nxitësit “Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta” dhe “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë”



kanë marrë mbështetje të konsiderueshme tek shqiptarëve.

Disa nxitës që mund të mos jenë probleme të ngutshme sipas shumicës së shqiptarëve mund të jenë të tillë për grupe të caktuara, si njerëzit që banojnë në zona të izoluara, për besimtarët praktikantë, apo për shqiptarët që i përkasin një grupi të caktuar fetar. 44.1% e popullsisë në vend mendojnë se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet të ndryshohet edhe me dhunë nëse është e nevojshme dhe 35.1% thonë se njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore. Po ashtu, njerëzit me nivel të ulët arsimor priren të bien më shumë dakord, gjë që përbën sinjal se ata mund të jenë më të prirur për të përdorur mjete jodemokratike për të mbrojtur vlerat, të drejtat dhe liritë e tyre. 1 në 5 shqiptarë – dhe 1 në 4 myslimanë shqiptarë – mendojnë se institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpër me myslimanët praktikantë. Në një kontekst të tillë, grupet ekstremiste të dhunshme e kanë më të lehtë ta promovojnë veten si alternativë e drejtë përkundër elitave të perceptuara imorale ose të padrejta qeverisëse. Pothuajse 4 në 10 shqiptarë - dhe besimtarët praktikantë edhe më shpesh - shohin tashmë tek feja një mundësi për trajtimin e korrupsionit dhe të pandëshkueshmërisë së elitave me lidhje të forta, duke qenë se besojnë se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuar dhe se në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi nëse me fenë e tyre do të bashkoheshin më shumë njerëz. Besimtarët praktikantë priren më pak të jenë dakord se njerëzit duhet të përdorin dhunën për të arritur këtë ndryshim dhe kanë më shumë gjasa se të tjerët për të thënë se besimtari i vërtetë duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij fetar që shprehin pikëpamje ekstremiste fetare.

Nxitësit kulturorë – Perceptimi i rrezikut të mundshëm për identitetin e njerëzve dhe mënyrën e tyre të jetesës mund të jetë nxitës i rëndësishëm për ekstremizmin e dhunshëm, siç ishte rasti me Shtetin Islamik të Irakut dhe Sirisë. Parakushti më i rëndësishëm që njerëzit të bien pre e kësaj propagande është se ata duhet të jenë një ndjesi më të fortë të përkatësisë ndaj një komuniteti fetar rajonal apo edhe global sesa ndaj një popullate apo kulture vendase. Ndërkohë që shumica e të anketuarve nuk mendojnë se ka qëndrime armiqësore ndaj Islamit, përqindja e shqiptarëve që janë dakord me pohimin “Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame” është rritur në krahasim me sondazhin e vitit 2018. Sipas 39.1% të shqiptarëve, besimtarët myslimanë në Shqipëri po përballen me ndikimet e huaja të Islamit konservator. Besimtarët praktikantë, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare, ishin më shumë të prirur për të rënë dakord se besimtarët myslimanë po përjetojnë ndikimin e huaj. Edhe pse shqiptarët myslimanë ishin më pak të prirur për të rënë dakord me këtë pohim, 1 në 4 vetë mendojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcimin të vazhdueshëm. Vlen të theksohet se interpretimi ekstremist i një besimi nuk implikon domosdoshmërisht praninë e ekstremizmit të dhunshëm.


Për më tepër, është rritur edhe përqindja e atyre që besojnë se është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë islame apo të krishterë: 20% shqiptarë mendojnë se sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame, ndërkohë që 10% thonë të njëjtën gjë për vështirësinë e të qenit besimtar praktikant i krishterë. 12% e shqiptarëve dhe 13% e shqiptarëve myslimanë janë dakord se “Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit” – ku njerëzit me nivel të ulët arsimor prireshin më shumë për të rënë dakord me këtë pohim. Këto gjetje sugjerojnë nevojën për të vazhduar monitorimin e ndikimit të huaj të çështjet e brendshme fetare, ndërkohë që duhet të vazhdohet me dialogun gjithëpërfshirës. Duke u mbështetur te vlerat kombëtare, si toleranca fetare, ky dialog do të bëjë të mundur që qëndrimet jo-standarde të mos tjetërsohen - duke ekuilibruar kështu çdo ndikim të huaj që do të synonte të ndërhynte në identitetin e tij. Në këtë drejtim, autoritetet fetare, në mënyrë të veçantë, mund të luajnë një rol vendimtar.



Prania e ekstremizmit në Shqipëri

Ndonëse në vitet e fundit, ekstremizmi i dhunshëm fetar ka qenë shqetësim kryesor për Shqipërinë, studimi i vitit 2018 “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM, 2018), nxori në pah një potencial në rritje për llojet e tjera të ekstremizmit në vend. Në fakt, ky studim konfirmon se, edhe pse pjesa më e madhe e shqiptarëve janë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar për ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri, ata janë më shumë të shqetësuar për ekstremizmin politik sesa për atë fetar apo nacionalist (shih Figurën 50). Shqiptarët në moshë të madhe janë më të shqetësuar për ekstremizmin, qoftë ai politik, nacionalist, apo fetar, sesa të rinjtë. Besimtarët praktikantë, pavarësisht se cilës fe i përkasin, prireshin më shumë të ishin të shqetësuar apo shumë të shqetësuar për ekstremizmin fetar. Të pyetur për llojet e grupeve ekstremiste fetare që besojnë se veprojnë në Shqipëri, 38% e të anketuarve thanë se ka grupe të mirë organizuara që përhapin interpretimet ekstremiste të fesë islame në Shqipëri, ndërsa rreth 10-20% e shqiptarëve besojnë se ka grupe të tilla të mirë organizuara përhapin interpretimet ekstremiste të fesë ortodokse, katolike, bektashiane, apo ungjillore në Shqipëri.

Figura 50: Shqetësimi dhe prania e perceptuar e ekstremizmit të dhunshëm politik, fetar dhe nacionalist



Kur e krahasojmë këtë me pyetjen nëse të anketuarit vënë re individë apo grupe ekstremiste (të dhunshme) në komunitetin e tyre, shumica dërrmuese e shqiptarëve e mohon praninë e individëve apo grupeve të tilla. Prania e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin politik (27.3%) raportohet më shpesh sesa prania e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin fetar (12.1%) apo atë nacionalist (7.6%). Në Bulqizë, Rrogozhinë dhe Kamzë shumica e njerëzve konfirmojnë praninë e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin politik, ndërsa për ekstremizmin fetar kjo ndodh vetëm në Rrogozhinë dhe më pak në Kamzë, Durrës dhe Pogradec. Po ashtu, prania e individëve radikalë që u bëjnë presion njerëzve për t'u bashkuar me grupet që nxisin ekstremizmin politik është konfirmuar nga 23.6% e të anketuarve, veçanërisht në Bulqizë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Këlcyrë, Libohovë, Pukë dhe Shijak. 7.1% e shqiptarëve konfirmojnë praninë e individëve radikalë që u bëjnë presion njerëzve për t'u bashkuar me grupet që nxisin ekstremizmin fetar, veçanërisht në bashkitë e Cërrik, Kamzë, Kuçovë, Maliq, Pogradec, Rrogozhinë, Shkodër, Tiranë dhe Ura Vajgurore. 6.3% e

shqiptarëve konfirmojnë praninë e njerëzve që u bëjnë presion të tjerëve për t'u bërë pjesë e grupeve ekstremiste nacionaliste. Ndonëse në përgjithësi këto konstatime nxjerrin në pah një kërcënim tjetër për sigurinë që mund të vijë nga grupe ekstremiste të dhunshme me motive politike, dhe jo nga ato me motive fetare, këto duhet të shërbejnë si sinjal për aktorët e P/LKEDH që të angazhohen në bashkitë e lartpërmendura për të luftuar përhapjen e grupe apo individë ekstremistë.

Rehabilitimi dhe riintegrimi i shqiptarëve nga Siria

Në vitet e mëvonshme, Shqipëria u përball me rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve të saj të kthyer nga Siria. Edhe pse me afat të saktë kohor ende të pasigurt, institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar kanë nisur nga përgatitjet për një strategji mbarëshoqërore rehabilitimi dhe riintegrimi. Mbështetja e popullatës në përgjithësi dhe e komuniteteve pritëse në veçanti është e një rëndësie të madhe për risocializimin e qëndrueshëm të të rikthyerve. Ky studim konstaton se pjesa më e madhe e shqiptarëve do ta mbështesnin riintegrimin e shtetasve shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konfliktit jashtë kufijve të vendit, por që nuk kanë kryer krime, dhe gjysma e të anketuarve madje mbështesin riatdhesimin dhe riintegrimin e të gjithë shtetasve shqiptarë të përfshirë në konflikte jashtë kufijve të vendit. Për më tepër, 47% e shqiptarëve thonë nuk do ta kishin problem që familje të tilla të rikthyera të vendosen në komunitetin e tyre. Në mënyrë të veçantë, besimtarët praktikues, myslimanë, meshkujt, personat me diplomë pasuniversitare dhe të anketuarit që jetojnë në zonat urbane janë më të hapur për të pritur familjet e rikthyera nga Siria.

Ndonëse shqiptarët duket se përgjithësisht janë më të hapur ndaj riatdhesimit dhe riintegrimin të shtetasve të rikthyer, ata janë më skeptikë për aftësinë e besimtarëve radikalë fetarë dhe pjesëmarrësve në veprimtari terroriste për t'u shkëputur nga ideologjitë ekstremiste. Është me interes të evidentohet se kur bëhet fjalë për një individ që refuzon një ideologji fetare ekstremiste, shqiptarët nuk sjellin në mend institucionet, por komunitetin dhe rrethin shoqëror si faktorë kryesorë. Marrëdhëniet e ngushta shoqërore, familja dhe ndikimi i komunitetit; arsimit; dhe informimi/edukimi i duhur fetar shihen si faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë ekstremiste fetare. Këto konstatime rikonfirmojnë se për të deradikalizuar dhe risocializuar ish ekstremistët kërkohet një qasje me shumë aktorë, ku të bëjnë pjesë aktorët shtetërorë e jo-shtetërorë dhe anëtarët e komunitetit.

Qeveria qendrore, shkollat, bashkësitë fetare dhe njësitë e qeverisjes vendore shihet se kanë rolin më të rëndësishëm për të luajtur kur bëhet fjalë për rehabilitimin dhe riintegrimin e të rikthyerve nga zonat e konfliktit. Niveli i besimit dhe i mbështetjes për komunitetet fetare në nivelin qendror dhe vendor është i një rëndësie tejet të madhe për vlerësimin e rolit të tyre në riintegrimin e të rikthyerve, por edhe në identifikimin e çdo forme të mundshme të refuzimit ndaj qëndrimeve zyrtare të komuniteteve fetare përkatëse ose të vatrave të nxehta që kundërshtojnë autoritetin. Për këtë qëllim, perceptimet e klerikëve me arsim të dobët mund të minojnë besueshmërinë e këtij komuniteti fetar dhe me shumë mundësi të rrisin pranueshmërinë e komuniteteve fetare jozyrtare. Shumica e shqiptarëve myslimanë ishin dakord se kryetari i komunitetit të tyre fetar gëzon mbështetjen e plotë të besimtarëve në vend, ndërsa gjysma e shqiptarëve thanë se klerikët fetarë në zonën ku ata jetojnë kanë një ndikim të madh tek besimtarët e tyre. Të anketuarit në Devoll, Bulqizë, Mallakastër, Patos, Mat, Sarandë dhe Finiq ishin më pak të prirur të binin dakord me të dy pohimet, që është tregues se niveli i mbështetjes për komunitetet fetare zyrtare dhe i ndikimit të tyre mund të jetë më i vogël në këto bashki.

Duke pasur parasysh se 1 në 4 shqiptarë janë dakord se në komunitetin e tyre fetar ka klerikë pa arsimin/ formimin e duhur fetar, nuk duhet të habitemi se pothuajse gjysma e shqiptarëve besojnë se njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me interpretimet



e bashkësive të tyre fetare zyrtare. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit që shihen si “të cenueshëm” (me nivel të ulët arsimor, që banojnë në zonat rurale) ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me këtë pohim, ndërkohë që besimtarët praktikantë ishin më pak të prirur për ta miratuar atë. Po të marrim në konsideratë ndikimet e huaja në çështjet fetare, nuk është habi që po gjen më shumë përkrahje ndjekja e interpretimeve jorzzyrtare fetare. Megjithatë, kur propaganda nuk mbahet në monitorim nga një autoritet qendror dhe i njohur zyrtarisht, mund të kemi më shumë interpretime radikale dhe jotolerante fetare që përhapen në vend. Prandaj, është me rëndësi që ndërhyrja nga jashtë të jetë e moderuar dhe që komunitetet zyrtare fetare të mbeten tolerantë ndaj interpretimeve të tjera të së njëjtës fe, për të siguruar që të gjithë besimtarët të përfaqësohen në komunitetin e tyre fetar.

Rruga përpara

Në vazhdim të studimit të vitit 2018, gjetjet e këtij sondazhi konfirmojnë edhe një herë se Shqipëria deri tani e ka anashkaluar potencialin e ekstremizmit jofetar në vend teksa fokusohet kryesisht tek ekstremizmi fetar. Edhe pse ka pasur përmirësime në disa nxitës të ekstremizmit të dhunshëm, mungesa e mundësive socio-ekonomike, gjendja e demokracisë dhe funksionimi i shtetit të së drejtës si dhe perceptimet për përjashtimin e perceptuar mund të bëjnë që disa individë të jenë të cenueshëm nga ekstremizmi i dhunshëm. Duke marrë parasysh riatdhesimin e pritshëm të shtetasve shqiptarë nga Siria dhe riintegrimin e tyre në shoqërinë shqiptare, është me rëndësi të vazhdohet me përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke zvogëluar hapësirën e mundshme ku veprojnë grupe të tilla. Edhe pse lista e mëposhtme e rekomandimeve për masa prioritare nuk është shteruese, ajo përfshin nevojat më të ngutshme për ta shndërruar platformën aktuale P/LKEDH të veprimtimit që fokusohet në ekstremizmin e dhunshëm fetar në vend në një kuadër të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe ndërsektorial për qëndresën e komunitetit ndaj formave dhe ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm, qoftë ai politik, fetar, apo nationalist:

1. Nevojitet një strategji e përshtatur për trajtimin e çështjeve që janë specifike për komunitetet e cenueshme në vend të një strategjie që bazohet në ideologji dhe që fokusohet vetëm te feja. Strategjia gjithëpërfshirëse P/LKEDH duhet të trajtojë të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm dhe duhet të orientohet nga parimet e qëndresës së komunitetit dhe dialogut gjithëpërfshirës.
2. Përmirësimi i hapësirës qytetare në Shqipëri është me rëndësi për të nxitur qytetarët që të marrin pjesë në vendimmarrje. Nismat e edukimit qytetar, ndërthurur me amendimet përkatëse ligjore, kanë më shumë gjasa të prodhojnë rezultate pozitive që çojnë në rritjen e llogaridhënies, ndërkohë që u mundësojnë komuniteteve të marginalizuara të angazhohen në një hapësirë më të sigurt, ku ata mund t'i adresojnë pritshmëritë e dështuara dhe pakënaqësinë me situatën aktuale.
3. Për të përmirësuar legjitimitetin e institucioneve qendrore dhe vendore, për forcimin e shtetit ligjor dhe për rritjen e përpjekjeve që synojnë të pengojnë ekonominë informale dhe kriminale dhe korrupsionin galopant, kërkohet një qasje mbarëqeveritare. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes vendore, në veçanti, është nevojë urgjente për të përmirësuar vazhdimisht performancën e tyre në ofrimin e shërbimeve.
4. Edhe pse toleranca fetare është vlerë themelore në shoqërinë shqiptare, aktorët P/LKEDH, institucionet arsimore dhe shoqëria civile duhet të rrisin përpjekjet për trajtimin e shkaqeve themelore dhe efekteve të stereotipeve, paragjykimeve dhe diskriminimit shoqëror me bazë ideologjike. Nevojitet të hartohet një program komunikimi strategjik për të kultivuar respektin ndaj të drejtave të njeriut që i bën të mundur shoqërisë të ofrojë rrjete mbështetëse shoqërore.



5. Rritja e investimeve në ngritjen e kapaciteteve, duke shënjestruar në mënyrë të veçantë të rinjtë, është domosdoshmëri për të zbutur pabarazitë dhe humbjen e shpresës.
6. Fuqizimi i komuniteteve fetare duke i angazhuar ato në strategjitë e parandalimit dhe riintegrimin të zbatuara nga Qendra KEDH dhe ministritë e linjës është me rëndësi të madhe për lehtësimin e riintegrimin të të rikthyerve, duke i përgatitur dhe duke i nxitur klerikët vendorë të marrin përsipër një rol më aktiv si riedukatorë fetarë. Rritja e besueshmërisë që gëzojnë komunitetet fetare, idetë dhe vlerat e tyre kanë nevojë për një vlerësim të sfidave institucionale me të cilat përballen autoritetet fetare, të cilat i pengojnë këto autoritete të luajnë një rol më të madh në përpjekjet parandaluese.



8. Shtojcat

8.1. Shpërndarja e kampionit të sondazhit

Bashkia	Madhësia e kampionit sipas bashkisë		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Berat	38	42	80
Dibër	38	38	76
Durrës	78	78	156
Elbasan	85	83	168
Fier	90	86	176
Gjirokastrë	20	18	38
Korçë	62	62	124
Kukës	23	22	45
Lezhë	38	38	76
Shkodër	62	60	122
Tiranë	214	225	439
Vlorë	53	47	100
Total	801	799	1600



8.2. Pyetësi i sondazhit



PYETËSOR

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Ambasadës së ShBA në Shqipëri është duke zhvilluar një hulumtim mbi komunitetet fetare dhe shoqërinë në Shqipëri, në kuadër të të cilit po zbatohet ky sondazh me qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Qëllimi i sondazhit është të analizojë perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve të anketuar lidhur me besimin fetar, marrëdhëniet brenda dhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare si edhe qëndrimet e shoqërisë dhe institucioneve ndaj tyre.

Ju mund të vendosni të mos merrni pjesë në anketim, ose mund të më bëni me dije që preferoni të mos i përgjigjeni një pyetjeje specifike dhe unë do ta kapërcej atë pyetje. Nëse dëshironi, ju mund ta përfundoni intervistën në çdo kohë dhe kjo nuk do të ndikojë në marrëdhënien tuaj me IDM apo me financuesit e projektit.

Ne garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë plotësimit të këtij pyetësi do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj.

Për çdo pyetje rreth studimit, ose nëse shfaqen probleme, ju mund të kontaktoni IDM në info@idmalbania.org ose tel. 04 24 00 241.

PËR ANKETUESIN: SHËNO TË DHËNAT E INTERVISTËS

Anketues	Intervista nr.	Bashkia	Njësia Administrative	Village



SEKSIONI I: DEMOGRAFIA

1. SHËNO GJININË E TË ANKETUARIT:

Mashkull	<input type="checkbox"/> 1
Femër	<input type="checkbox"/> 2
Tjetër	<input type="checkbox"/> 3

Tjetër _____	<input type="checkbox"/> 5
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

2. Mosha _____ (në vite)

3. Cili është niveli më i lartë i arsimit që keni kryer?

Pa arsim / Më pak se arsimi fillor (8/9 vjeçar)	<input type="checkbox"/> 1
Arsim fillor 8/9 vjeçar	<input type="checkbox"/> 2
Arsim i mesëm	<input type="checkbox"/> 3
Arsim i lartë	<input type="checkbox"/> 4
Arsim pasuniversitar	<input type="checkbox"/> 5
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

6. Cila është përkatësia fetare e familjes suaj të origjinës?

Myslimane	<input type="checkbox"/> 1
Ortodokse	<input type="checkbox"/> 2
Katolike	<input type="checkbox"/> 3
Bektashi	<input type="checkbox"/> 4
Evangjelist	<input type="checkbox"/> 5
E përzier	<input type="checkbox"/> 6
Tjetër _____	<input type="checkbox"/> 7
Nuk e di/ Nuk jam i/e sigurt	<input type="checkbox"/> 88
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

4. Statusi civil

I/E martuar	<input type="checkbox"/> 1
I/E pamartuar por në bashkëjetesë	<input type="checkbox"/> 2
Beqar/e	<input type="checkbox"/> 3
I/E divorcuar	<input type="checkbox"/> 4
I/e ve	<input type="checkbox"/> 5
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

7. Cilët besimi fetar i përkisni?

Mysliman	<input type="checkbox"/> 1
Ortodoks	<input type="checkbox"/> 2
Katolik	<input type="checkbox"/> 3
Bektashi	<input type="checkbox"/> 4
Evangjelist	<input type="checkbox"/> 5
Agnostik	<input type="checkbox"/> 6
Ateist	<input type="checkbox"/> 7
Tjetër _____	<input type="checkbox"/> 8
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

5. Statusi i punësimit

I/E Punësuar	<input type="checkbox"/> 1
I/E Vetëpunësuar	<input type="checkbox"/> 2
I/E Papunë	<input type="checkbox"/> 3
Student/e	<input type="checkbox"/> 4

8. Ju personalisht, a jeni praktikant/e i/e rregullt i/e fesë?

PO – I praktikoj rregullisht ritet dhe rregullat fetare	<input type="checkbox"/> 1
Kryesisht PO – Praktikoj ritet kryesore fetare	<input type="checkbox"/> 2
JO – Jam besimtar por nuk i praktikoj fare rregullat dhe ritet fetare	<input type="checkbox"/> 3
JO, jam ateist KALO TEK SEKSIONI 2	<input type="checkbox"/> 4
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

9. Mund të më thoni se sa shpesh luteni / faleni:

Rregullisht (çdo ditë / javë) (1)	Në festa fetare përgjatë vitit (2)	Vetëm me raste, në ngjarje të veçanta fetare (3)	Vetëm me raste, në kohë të vështira personale/familjare (4)	Asnjëherë (5)	Refuzim (99)

SEKSIONI 2: SHOQËRIA DHE FAKTORËT SOCIAL-EKONOMIKË**10. Duke pasur parasysh komunitetin ku jetoni, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!**

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhunës, veprime vandale, etj.)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

11. Deri në ç'masë jeni të shqetësuar për “.....” në Shqipëri?

Ju lutem, përdorni një shkallë nga 1 (aspak i shqetësuar) deri në 4 (shumë i shqetësuar).

	Aspak i shqetësuar			Shumë i shqetësuar	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Ekstremizmin politik	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Ekstremizmin nacionalist	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Ekstremizmin fetar	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99



12. Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin:”

Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Ekstremizmin politik	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Ekstremizmin nacionalist	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Ekstremizmin fetar (Specifikoni)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

12d. *Nëse zgjidhët (Dakord-3; ose Plotësisht dakord-4) për ekstremizmin fetar, ju lutem specifikoni:

13. Sipas përvojës tuaj, si do t'i vlerësonit pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99



14. Cili është vlerësimi juaj lidhur me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
d. Në zonën ku banoj ka shumë familje ose individë që nuk i plotësojnë dot nevojat bazë të jetesës	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
e. Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
f. Disa punë / përfitime ekonomike të ligjshme që NUK m'i lejon besimi im fetar do t'i refuzoja	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
g. Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe i paligjshëm	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
Ph. asurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99



SEKSIONI 3: FEJA DHE FAKTORËT (NDËR)SHTETËRORE / POLITIKË

15. Deri në ç'masë pohimet e mëposhtme reflektojnë qëndrimet tuaja? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
d. Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

16. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/ saj me çdo mjet dhe çmim	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99


d. Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
e. Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
f. Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
g. Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
h. Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
i. Prezenca e “shtetit” si ligjzbatues dhe ofrues i shërbimeve publike është më e ulët në fshat sesa në qytet	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
j. Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

17. Në zonën ku unë banoj ka individë ose grupime radikale që ushtrojnë trysni mbi të tjerët për t’iu bashkuar grupimeve që promovojnë “.....” Ju lutem, përdorni shkallën 1 (aspak dakord) në 4 (plotësisht dakord).

	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S’ka lidhje	NUK E DI
a. Ekstremizmin politik	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Ekstremizmin nacionalist	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Ekstremizmin fetar (Specifikoni)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

17d. Nëse zgjodhët (Dakord-3; ose Plotësisht dakord-4) për ekstremizmin fetar, ju lutem specifikoni:

.....



18. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku
1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
d. Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
e. SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99




SEKSIONI 4: PRAKTIKIMI I FESË NË SHQIPËRI

19. Deri në ç'masë jeni dakord me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
d. Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
e. Shteti Islamik në Siri ishte përfaqësuesi i vërtetë i Islamit.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

20. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99



b. Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
d. Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
e. Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë islame	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
f. Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë orthodokse	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
g. Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë katolike	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
h. Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë bektashiane	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
i. Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të fesë evangjeliste	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
j. Në Shqipëri ka grupe të mirë-organizuara që përhapin tek besimtarët interpretime ekstremiste të feve të tjera.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
k. (Specifikoni:)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99



SEKSIONI 5. REHABILITIMI, RIINTEGRIMI DHE PARANDALIMI

21. Cili është qëndrimi juaj personal lidhur me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD

POHIMI	Aspak dakord			Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	NUK E DI
a. Është e pamundur që besimtarët e radikalizuar të shkëputen nga ideologjitë radikale fetare	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
b. Është e pamundur që terroristët e dënuar të shkëputen nga ideologjitë ekstremiste	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
c. Organet shtetërore duhet të riatdheshojnë dhe riintegrojnë vetëm shtetasit shqiptarë që kanë jetuar në zonat e konflikteve jashtë vendit por që nuk kanë kryer krime	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
d. Organet shtetërore duhet të angazhohen për të riatdhësuar dhe riintegruar të gjithë shtetasit shqiptarë të përfshirë në konfliktet jashtë vendit.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99
e. Unë nuk do ta kisha problem, nëse familjet e kthyer nga Siria do të bëheshin pjesë e komunitetit ku unë banoj.	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 88	<input type="checkbox"/> 99

22. Sipas mendimit tuaj, në Shqipëri ka kryesisht urrejtje apo harmoni fetare? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku "1 = urrejtje fetare" dhe "4=harmonia fetare"

Urrejtje fetare			Harmoni fetare
<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4



23. Ju personalisht do ta mbështesnit një anëtar të familjes tuaj (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) po të martohej me një person të një besimi tjetër feta

Patjetër që po	<input type="checkbox"/> 1
Do ta pranoja por nuk do ta mbështesja / inkurajoja	<input type="checkbox"/> 2
Do ta kundërshtoja në çdo rast	<input type="checkbox"/> 3
Do ta kundërshtoja n.q.s. personi me të cilin/ën martohet është besimtar praktikant	<input type="checkbox"/> 4
Nuk jam i/e sigurt	<input type="checkbox"/> 5
Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

24. Sipas jush, cilat janë TRE arsyt kryesore që krijojnë ose nxitin radikalizimin fetar tek individët në Shqipëri?

a. Arsyet ekonomike (p.sh. papunësia, varfëria etj.)	<input type="checkbox"/> 1
b. Niveli i ulët arsimor	<input type="checkbox"/> 2
c. Izolimi shoqëror	<input type="checkbox"/> 3
d. E shkuara kriminale (persona me precedent penal)	<input type="checkbox"/> 4
e. Paaftësia e klerit	<input type="checkbox"/> 5
f. Paaftësia e institucioneve shtetërore	<input type="checkbox"/> 6
g. Ndikimi i grupeve të huaja të radikalëve fetarë	<input type="checkbox"/> 7
h. Niveli i ulët i njohurive fetare	<input type="checkbox"/> 8
i. Tjetër (Specifikoni:)	<input type="checkbox"/> 9
j. Nuk e di / Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

25. Sipas jush, cilët janë TRE faktorët kryesorë që i bëjnë individët të refuzojnë ideologjitë fetare ekstremiste?

- a. _____
- b. _____
- c. _____



26. Si e vlerësoni rolin që duhet të kenë aktorët e mëposhtëm në rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga Siria? (1 – nuk duhet të kenë asnjë rol, 5 – një rol të rëndësishëm)


	Asnjë rol				Rol shumë të rëndësishëm
a. Qeveria	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5
b. Pushteti vendor (Bashkia)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5
c. Media	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5
d. Shoqëria civile	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5
e. Komunitetet fetare	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5
f. Shkollat	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5
g. Tjetër (Specifikoni:)	<input type="checkbox"/> 1	<input type="checkbox"/> 2	<input type="checkbox"/> 3	<input type="checkbox"/> 4	<input type="checkbox"/> 5

27. Sipas jush, cilët janë TRE aktorët më të rëndësishëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri?

a. Pushteti vendor (Bashkia)	<input type="checkbox"/> 1
b. Shërbimet e ndihmës sociale	<input type="checkbox"/> 2
c. Klerikët lokalë	<input type="checkbox"/> 3
d. Drejtuesit e lartë të komuniteteve fetare	<input type="checkbox"/> 4
e. Institucionet ligjzbatuese (policia, prokuroria, gjykatat)	<input type="checkbox"/> 5
f. Pushteti Qendror (qeveria, ministritë)	<input type="checkbox"/> 6
g. Media	<input type="checkbox"/> 7
h. Shoqëria civile	<input type="checkbox"/> 8
i. Gratë	<input type="checkbox"/> 9
j. Të rinjtë	<input type="checkbox"/> 10
k. Shkollat	<input type="checkbox"/> 11
l. Besimtarët	<input type="checkbox"/> 12
m. Tjetër (Specifikoni:)	<input type="checkbox"/> 13
n. Nuk e di / Refuzim	<input type="checkbox"/> 99

JU FALEMINDERIT!





**EKSTREMIZMI
I DHUNSHËM**
në Shqipëri 2021